ISSN 1857-6443

Edhe pa firmën e Ivanovit, shqipja do të hyjë në fuqi

Fq.3

APEL I MEMETIT

Kusigerska anoi nga Iliqi, Jovevski të ketë kujdes

Fq.5

Milan dhe Raiola

Të shitet Donaruma

Fq.21

www.koha.mk

Koha



Të ngecur në itinerarin e Ballkanit

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3324 · e premte 23 mars, 2018 · -1°c | 3°c · 15 DEN

EDITORIAL

Përgjegjësia

Pas dorëheqjes së ministrit të Drejtësisë, Bulent Saliu, është hapur rruga e kërkimit të shtigjeve që do ta bënin më të lehtë funksionimin e institucionit të përgjegjësisë, si akt më i lartë jo vetëm etik, por edhe ligjor. Në zingjirin komandues të çdo institucioni, përgjegjësia është sa kolektive, po aq edhe individiuale. Ka shumë raste që kuadrot shqiptare po arsyetohen me faktin se vendimmarrja në institucionet ku ata punojnë është me subordinim, që i bie se ata nuk mund të ndërmarrin asgjë nëse vendimi është i padrejtë nga ana e udhëheqësit të atij institucioni. Mirëpo ata harrojnë një fakt se përgjegjësia nuk...

Fq.2

SPECIALE

Refugjatët e mitur shqiptarë në Gjermani

Fq.12

SPECIALE

Përmendore për Millosheviqin në Serbi?

Fq.13

GJETJE TË REJA PËR MINËN NË SOPOT

DY "ARGATË" SHQIPFOLËS?

Në bashkëpunim me strukturat maqedono-serbe të sigurisë, minën në Sopot dyshohet se e kanë vendosur dy banorë të një fshati në kufi me Serbinë. Burime policore për gazetën KOHA thonë se njëri jeton që atëherë në Francë, ndërsa personi tjetër, që konsiderohet i dyshuari kryesor, është larguar para disa viteve në një vend tjetër evropian. Në këtë drejtim po zhvillohen edhe hetimet e reja

Fq. 4

Brenda xhamisë shëtitën pijanecë e narkomanë

Prilep, 22 mars - Çarshi xhamia e Prilepit të Maqedonisë, e cila pësoi nga konflikti ndëretnik që ndodhi në vitin 2001, është para zhdukjes totale nga dita në ditë për shkak të mungesës së përkujdesjes. Objekti osman në Prilep, qytet ky në pjesën qendrore të vendit, i cili i përket periudhës së Fatih Sulltan Mehmetit, në mes të qytetit pret ditën kur do të rihapet për adhurim. Në muajin gusht të vitit 2001, huliganë maqedonas nga Prilepi u ngritën në këmbë dhe dogjën Çarshi xhaminë në Prilep si kundërpërgjigje ndaj sulmit mbi autokolonën ushtarake që po shkonte në Tetovë në autostradën Shkup-Tetovë, e si pasojë e të cilit humbën jetën dhjetë ushtarë nga Prilepi dhe rrethina. Edhe pse kanë kaluar 17 vite, ende nuk është bërë hapi konkret për riparimin e xhamisë, teksa mbetet enigmë...

Fq.9

EDITORIAL

PËRGJEGJËSIA

Emin AZEMI

Neglizhenca dhe indiferentizmi i kuadrove shqiptare, si në rastin e Sopotit, dhe në raste të tjera, kanë ndikuar që këto raste jo vetëm të marrin pista të gabuara hetimi, por edhe të zvarriten pakuptimësisht

Pas dorëheqjes së ministrit të Drejtësisë, Bulent Saliu, është hapur rruga e kërkimit të shtigjeve që do ta bënin më të lehtë funksionimin e institucionit të përgjegjësisë, si akt më i lartë jo vetëm etik, por edhe ligjor. Në zingjirin komandues të çdo institucioni, përgjegjësia është sa kolektive, po aq edhe individiuale. Ka shumë raste që kuadrot shqiptare po arsyetohen me faktin se vendimmarrja në institucionet ku ata punojnë është me subordinim, që i bie se ata nuk mund të ndërmarrin asgjë nëse vendimi është i padrejtë nga ana e udhëheqësit të atij institucioni.

Mirëpo ata harrojnë një fakt se përgjegjësia nuk është vetëm të pengosh apo jo një vendim të padrejtë. Parasegjitash, përgjegjësia nënkupton legjitimin e atij vendimi me pjesëmarrje në ndonjë institucion. Kështu zatën edhe ka ndodhur në të kaluarën. Kuadrot shqiptare, ose janë mbivotuar (si në rastin e Almir Aliut), ose shpërfillur fare, duke reduktuar prezencën dhe rolin e tyre në trajta qesharake.

A duhet të ndodhë kjo edhe në të ardhmen? Fillimi i procesit të çmontimit të sistemit të drejtësisë, gjegjësisht largimi i të gjithë elementeve antireformues nga gjykatat e prokuroritë, përfshi sidomos ata gjykatës e prokurorë të lustruar dhe me të kalur të dyshimtë, duhet të ndodhë sa më parë. Në disa rapoprte të Komsionit Europian dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë, sistemi i drejtësisë ka qenë një nga pikat më të kritikueshme dhe sa here që është folur për ngecjen e reformave, është aluduar në sistemin e drejtësisë në Maqedoni.

Por, a mjafton ky proces filtrimi, nëse atij nuk i prijnë kuadrot shqiptare, jo vetëm në gjyqësi e prokurori, por edhe në të gjitha institucionet tjera. Ka shumë segmente të shtetit ku kuadrot shqiptare ose janë dekor, ose prezenca e tyre ballafaqohet me absurditete të natyrave të ndryshme. Jo pak raste ka që kuadrot shqiptare ngrejnë zërin për padrejtësi në institucione të caktuara ku ata punojnë, por revanshizmi ndaj tyre është i tmerrshëm. Ka të tjerë që janë palë me kuadro të caktuara maqedonase në bashkëdrejtimin e bizneseve e dallavereve, që asgjë nuk kanë të përbashkët me interesat që ata përfaqësojnë.

Virusi më i dëmshëm i (keq)funksionimit të një institucioni mund të zhvillohet vetëm në qerthujt që prodhojnë neglizhencë, apati, indiferentizëm. A ka patur deri më tani plotë situata ku kuadrot shqiptare kanë treguar mungesë sensi për të reaguar ndaj deformimeve e padrejtësive në institucionet ku ata punojnë? Kush i ka penguar ata të mos reagojnë?

Neglizhenca dhe indiferentizmi i kuadrove shqiptare, si në rastin e Sopotit, dhe në raste të tjera, kanë ndikuar që këto raste jo vetëm të marrin pista të gabuara hetimi, por edhe të zvarriten pakuptimësisht, duke abuzuar rëndë me liritë dhe të drejtat e të akuzuarve shqiptarë. Raste të tilla ka patur edhe më herët, kurse si shembull ilustrativ përmenden ngjarjet e Gostivarit ku në krye të komisionit hetues ishte një kuadër shqiptar, i cili pat nënshkruar raportin gjoja hetues e që nuk dallonte me asgjë nga raporti i policisë.

Përgjegjësia për devijime nëpër institucione, duhet të fillojë nga kuadrot shqiptare. Dorëheqja e ministrit Saliu, është një standard që duhet të merret si model.



KUNDËR KUJT PROTESTOJNË

"Dje isha pjesë e protestës që u zhvillua për të kërkuar Drejtësi për vogëlushin Almir Aliu.
Derisa dëgjoja nënën e Almirit të fliste, një plak që i binte bastunit me fuqitë e fundit që i kanë mbetur, fëmijë që qanin, mendova sa mirë që ndodhesha aty!
Por kur i vërejta përfaqësues të qeverisë nga radhët e BDI-së thashë që këta njerëz nuk e njohin turpin!
Mungonte vetëm Zaevi dhe Ahmeti të protestonin kundër Qeverisë që për çudi e drejtojnë vet!
Ne protestonim ndaj Qeverisë, po këta të BDI-së ndaj kujt?!", shkruan në profilin e tij në Facebook, kryetari i Gostivarit, Arben Taravari.

SURPRIZA E EVROPIANËVE

"Nuk ka asnjë surprizë me deklaratat e zyrtarëve evropianë që thonë se falja e tokës nuk do ta sjellë liberalizimin e vizave.
Surprizë është vetëm aftësia e disave për të qenë legenë gjithnjë e më të mëdhenj, duke mbështetur faljen e tokës pafytyrësisht, kinse për liberalizim të vizave, ose duke mos protestuar sepse "nuk mund të ndalet" (a thua se ndalja është e mundshme para protestës e nuk është protesta ajo që mundëson ndaljen).
Megjithatë, pa dëshpërim, në çdo popull ka njerëz që përfitojnë nga prostituimi dhe skllavërimi i njerëzve apo nga prostituimi dhe skllavërimi i vendit.
Po ashtu, në çdo popull ka legenë që e bëjnë të pranueshëm prostituimin dhe skllavërimin e njerëzve e të vendit. Duke induktuar pasivitet, cinizëm, shpërqendrim.
Mirëpo ja që kemi qëlluar me fat, e kemi shpresën të ndezur, dhe na bën dritë, na tregon rrugën drejt kohës kur numri i qytetarëve aktivë pas një ideje e një plani, të jetë më i madh se ai i pasivëve cinikë e të shpërqendruar.
Atëherë do të ndalet prostituimi i njerëzve dhe i vendit.
Nuk do të jetë parajsa, thjesht do të fillojë puna, do të fillojë drejtësia", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Arbër Zaimi.

MOS U TUTNI, ASKUSH NUK E MERR KOSOVËN

"Propozim për zgjidhjen e problemit me Malin e Zi. Jo veç Qakorrin, por krejt Kosovën duhet me ja dhanë Malit të Zi.
Kjo është zgjidhje për ne. Mos u tutni se malazezët nuk kanë çka na bajnë edhe nëse e marrin Kosovën se ata nuk janë më shumë se 300 a 400.000.
Besoni që nëse ja japim Kosovën Malit të Zi, e zgjidhim problemin tonë përgjithmonë. Bile nuk bahmi kahre tu u shty për 8000 hektarë.
Veç a pe marrin ata se për tjetër sen mos u bani marak. N'çfarë derexhe kemi ardhë kurkush ma nuk na merr veç kanë me naj hangër megjën për ditë", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti nga Londra, Daut Dauti.

MEDIACitate

Vizita e shefit të diplomacisë greke Nikos Koxias në Shkup, me fluturim direkt nga aeroporti i Athinës në aeroportin e Shkupit - është një nga temat kryesore në mediat greke. Në informacionet informative të mëngjesit në televizionet e Greqisë, gazetarë dhe deputetë nga parti të ndryshme politike debatojnë për udhëtimin e Nikos Koxias në Maqedoni, njoftoi korrespodenti i MIA-s nga Athina.
Gazetarët në Greqi, theksin e vënë në faktin se negociatat për emrin hyn në fazë kyçe, me propozimet e dërguara dhe nga të dy palët, po dhe në atë se për herë të parë pas 10 vite Koxias me fluturim direkt, nga Athina do të udhëtojë për në Shkup. "Vizitë historike e Koxias në Shkup", është titulli i tekstit në agjencinë e lajmeve greke ANA-MPA, i publikuar disa orë para udhëtimit të ministrit për të Punëve të Jashtme të Greqisë, në Maqedoni.
"Sot pasdite, ministri i punëve të jashtme Nikos Koxias dhe delegacioni grek, i shoqëruar nga ekipe të gazetarëve, udhëtojnë për në Shkup në një vizitë me rëndësi historike, me fluturimin e parë direkt pas 12 viteve, pas riemërtimit të aeroportit "Aleksandri i Madh" në "Aeroporti ndërkombëtar i Shkupit", shkruan agjencia e lajmeve greke dhe shton se sonte Koxias do të ketë takim pune me homologun e tij nga Maqedonia, ndërsa nesër takime maratone dhe negociata me zyrtarë të lartë dhe me opozitën. "Kocias në IRJM, fluturimi i parë direkt Athinë-Shkup"; "Koxias pasdite në Shkup - nesër negociata kyçe për emrin"; "Kocias sot në Shkup për fillim të ri të negociatave"; "Kocias fluturon në Shkup - shumë pakënaqësi dhe klimë e vështirë në negociata", janë pjesë e titujve në onlajn portalet greke. Gazetarët grek, si në televizion ashtu edhe në mediat elektronike, i përmendin shtatë pikat nga draft marrëveshja greke, pika të cilët vetë Koxias publikisht i ka deklaruar dhe ato janë: emri, përdorimi i emrit, gjuha, identiteti, përdorim komercial, akronimet dhe shkurtesat. Kërkesa greke për ndryshim të Kushtetutës të Maqedonisë, spektri i përdorimit të emrit të ri, por dhe identitetit sipas mediave në Greqi janë pikat për të cilat Shkupi dhe Athina kanë qëndrime të ndryshme.

NËSE NUK E KENI DITUR...

Ç'kuptim ka fjala "Intuitë"?

(lat. Intuitio vështrim i përqendruar) quhet aftësia për të rrokur menjëherë diçka të rëndësishme e thelbësore në një proces njohjeje a zgjidhjeje të një situate. Është produkt i përvojës së gjatë, por edhe i aftësive të lindura të njeriut. Intuita mund të jetë: 1) Empirike, kur ka të bëjë me sende e dukuri të veçanta apo situata konkrete, dhe 2) Racionale, kur rroket shpejt dhe si "pa e vrarë mendjen" lidhja thelbësore midis idesh që mund të duken larg njëra-tjetrës. Ata që e mbrojnë si aftësi, quhen në filozofi "intuitivistë". Ata që e kundërshtojnë thonë që do të gabohej nëse do të absolutizohej si aftësi. Këta besojnë se intuita nuk ka kuptim që të trajtohet si një aftësi njohëse e mbinatyrshme dhe mistike, përderisa prapa aftësive për të gjetur "menjëherë", "në moment" të vërtetën apo zgjidhjen e drejtë të problemit, qëndron përvoja e grumbulluar, qëndrojnë dijet e fituara më parë.

GAZETA ZYRTARE SOT PRITET TA PUBLIKOJË LIGJIN PËR GJUHËT

EDHE PA FIRMËN E IVANOVIT, SHQIPJA DO TË HYJË NË FUQI

Qëndrimet e deputetëve të BDI-së janë në linjë edhe me qëndrime jozyrtare të disa gjykatësve kushtetuese se hyrja në fuqi e Ligjit pas kthimit të dytë nga presidenti, nuk është më në fuqinë e këtij të fundit, por është në fuqinë e vetë Kushtetutës

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 22 mars - Të enjten në ora 24 ka përfunduar afati tetë ditor kur duhej që presidenti Gjorgji Ivanov të nënshkruaj Ligjin për përdorimin e gjuhëve, pas votimit të dytë në Parlament më 14 mars të këtij viti. Nga Qeveria ishin në pritje që megjithë deklarimet në opinion të presidentit se nuk do ta firmos Ligjin, ai do të respektojë Kushtetutën dhe do ta nënshkruaj Ligjin për gjuhët. Në BDI thonë se edhe në rast të mosnënshtrimit nga presidenti Ivanov , Ligji do të hyj në fuqi menjëherë pasi të kalojën tetë ditë nga miratimi i tij, madje duke e quajtur punë të kryer shpalljen e Ligjit në gazetën zyrtare. Ndërkaq, VMRO mban qëndrimin se në rast të publikimit të Ligjit në Gazetë zyrtare pa nënshkrimin e presidentit, drejtori këtij institucioni do të do të kryejë vepër penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit ligjor".

"E nënshkruan apo nuk e nënshkruan presidenti, Ligji do të hyjë në fuqi menjëherë posa të kalojnë tetë ditë nga miratimi tij meqë gazeta zyrtare është e obliguar të shpallë në këtë rast Ligjin që ka kaluar të gjithë filtra juridik dhe afatet ligjore. Nëse Gazeta Zyrtare apo kushdo qoftë institucion tjetër duhet pyetur ata si i kryejnë detyrimet ligjore. Ne nuk mbajmë përgjegjësi për ta. Por ajo që dimë ne është se Ligji bëhet i plotfuqishëm sipas parimit të kushtetutshmërisë pasi të kalojë afati kushtetues dhe ligjor tetë ditë pas miratimit të tij", thonë zyrtarë të lartë të BDI-së. Qëndrimet e deputetëve të BDI-së janë në linjë edhe me qëndrime jozyrtare të disa gjykatësve kushtetuese se hyrja në fuqi e Ligjit pas kthimit të dytë nga presidenti, nuk është më në fuqinë e këtij të fundit, por është në fuqinë e vetë Kushtetutës.

Sipas asaj që janë shprehur gjykatës kushtetues, jozyrtarisht Ligji ka ecurinë e vetë drejt hyrjes në fuqi, sepse për atë ka vendos shumica e deputetëve. Nga Qeveria thonë se presidentin e obligon Kushtetuta ta nënshkruaj Ligjin në fjalë, duke mos mundur të lëshohet në vullnetin e tij që të mos e nënshkruaj si herën e parë. "Ne presim që presidenti ta nënshkruaj Ligjin këtë herë, ngaqë atë e obligon qartë Kushtetuta në nenin 75. Presidenti nuk mund të lëshohet në pushtetin diskrecional si në rastin e parë që ia jep Kushtetuta të mos e nënshkruaj Ligjin", thotë për gazetën KOHA zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski. Po në rast të mos nënshkrimit të Ligjit nga presidenti, Boshnjakovski nuk pranon të thotë asgjë nëse Ligji do të shpallet në gazetën zyrtare.

"Do të shohim meqë presim ta nënshkruajë - në rast të kundër,t nuk mund të them çka do të ndodh më tej", tha Mile Boshnjakosvki. Ndryshe, Neni 75 ë është deciziv sa i përket obligimit të presidentit ta nënshkruaj Ligjin, meqë në të kundërtën - paraqet shkelje të rëndë të Kushtetutës siç kanë theksuar ekspertët dhe më pas mund të kërkohet edhe përgjegjësi në Parlament për veprimin e tij.

"Ligjet shpallen me dekret. Dekretin për shpalljen e ligjeve e nënshkruajnë presidenti i Republikës dhe kryetari i Parlamentit. Presidenti mund të vendosë të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e Ligjit. Parlamenti sërish e shqyrton Ligjin dhe në qoftë se e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, presidenti e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin. Presidenti e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin, në qoftë se sipas Kushtetutës, Ligji nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve", thuhet shprehimisht në nenin 75 të Kushtetutës së Maqedonisë. Orce Gjorgjievski, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të VMRO-DPMNE-së, gjatë një konference për shtyp, tha se nëse drejtori i Gazetës Zyrtare e publikon Ligjin pa nënshkrimin e presidentit, do të përgjigjet për vepër penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizim", sipas nenit 353 të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë. Njëherësh, Gjorgjievski akuzoi LSDM dhe BDI për kapje të shtetit duke e vënë veten mbi Ligjin dhe Kushtetutën. "Për këtë shkelje të demokracisë, LSDM dhe BDI do të bartin përgjegjësi politike, por edhe juridike. Për Talat Xhaferin do të ngritet edhe kallëzim penal për mosrespektimin e Kushtetutës dhe ligjet e Maqedonisë. I vetmi institucion që nuk u mposht nga presionet e LSDM-së dhe BDI-së dhe u vu në mbrojte të Kushtetutës dhe interesave shtetërore, ishte presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov", tha Gjorgjievski. Partia më e madhe në Maqedoni - LSDM, ka reaguar ndaj pres-konferencës të anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të VMRO-DPMNE-së, Orce Gjorgjievski. Nga LSDM thonë se VMRO-DPMNE duhet t'i mbledhë forcat dhe të tejkalojë politikat dyfytyrëshe dhe patriotizmin e rrejshëm, sepse i gjithë opinioni e di se partia opozitare në shpresë se do të formonte qeverinë, veçmë e pati pranuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve. "Ligji për përdorimin e gjuhëve është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Amendamentin 5 të sjellë në vitin 2001 dhe e avancon përdorimin e gjuhëve të të gjitha komuniteteve jo-shumicë që është në përputhje me konceptin e një shoqërie. Ivanovi është i obliguar të veprojë sipas Kushtetutës dhe nenin 75 të Kushtetutës dhe është i obliguar të nënshkruan dekretin për Ligjin për përdorimin e gjuhëve", thuhet në reagimin e LSDM-së.

RËNIE E DEBATIT NË PARLAMENT

Niveli i debatit në Parlament përmes argumenteve ka shënuar rënie krahasuar me periudhën paraprake maj-gusht të vitit 2017. Këtë e konstaton Instituti për Demokraci "Societas Civilis" nëpërmjet projektit "Parlamenti nën thjerrëz". Tema më e diskutuar në Parlament kanë qenë propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve dhe propozim-buxheti i Maqedonisë për vitin 2018. Debat më konstruktiv është bërë në mungesë të opozitës. "Këtë periudhë mund të themi se niveli i debatit sipas hulumtimeve tona ka rënë edhe më shumë. Nëse shihet cilësia e argumenteve, sipas statistikave, kur nuk ka opozite në Kuvend kemi debat më cilësor, por ne e dimë se një debat i tillë është i njëanshëm dhe nuk ka hapësirë të madhe që temat që diskutohen të shihen nga shumë kënde dhe nga vet kjo shihet se debati është i kufizuar. Një Kuvend nuk është i plotësuar nëse nuk funksionon me pjesëmarrjen e opozitës e cila gjithashtu duhet të jetë konstruktive", deklaroi Jane Dimeski, Societas Civilis.

ÇANAK: Presioni rus mbi Maqedoninë, i papranueshëm

"Të një rëndësie jetike janë negociatat për emrin e Maqedonisë që do të ishte i pranueshëm për të gjithë fqinjët", nënvizoi Çanak

Kryetari Ligës Socialdemokrate të Vojvodinës, Nenad Çanak, deklaroi se pas grushtshtetit të dështuar në Mali të Zi, Rusia tani po bën presion në Maqedoni. Çanak ka dënuar kërcënimet e fundit të diplomacisë ruse drejtuar Maqedonisë, njofton B92. Mediat maqedonase raportuan se Rusia, përmes përfaqësuesit të saj diplomatik, ditë më parë ia kanë tërhequr vërejtën Maqedonisë se anëtarësimi i saj në NATO do të ketë pasoja negative në marrëdhëniet bilaterale me Rusinë. Çanak ka shprehur mbështetjen e tij për kryeministrin Zoran Zaev për "përpjekjet e tij në ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe qytetare si dhe në orientimin e politikës së jashtme të qeverisë së re maqedonase, duke synuar paqen me të gjithë fqinjët". Çanak ka folur edhe për kontestin që e ka Maqedonia me Greqinë. "Të një rëndësie jetike janë negociatat për emrin e Maqedonisë që do të ishte i pranueshëm për të gjithë fqinjët", nënvizoi Çanak. Ai shtoi se procesi i përshpejtuar i integrimeve euroatlantike dhe ftesa për anëtarësim në NATO, janë të një rëndësie jetike për stabilizimin e gjendjes në Maqedoni dhe avancimin e Ballkanit demokratik dhe të zhvilluar. "Prandaj, të gjitha presionet e Rusisë ose të ndonjë vendi tjetër, që shpijnë në përkeqësimin e marrëdhënieve ose në destabilizimin e situatëzs në rajon, janë atak i drejtpërdrejt kundër interesave të shoqërisë dhe të çdo individi në Europën Juglindore", ka deklaruar Nenad Çanak, për mediat serbe.

GJETJE TË REJA PËR MINËN NË SOPOT

DY "ARGATË" SHQIPFOLËS?

Në bashkëpunim me strukturat maqedono-serbe të sigurisë, minën në Sopot dyshohet se e kanë vendosur dy banorë të një fshati në kufi me Serbinë. Burime policore për gazetën KOHA thonë se njëri jeton që atëherë në Francë, ndërsa personi tjetër, që konsiderohet i dyshuari kryesor, është larguar para disa viteve në një vend tjetër evropian. Në këtë drejtim po zhvillohen edhe hetimet e reja

Koha Vedat MEMEDALIU

Shkup, 22 mars - Dy persona dyshohet të kenë vendosur mjetin shpërthyes në rrugën Sopot-Sushevë në 4 mars të vitit 2003, ku vdiqën dy ushtarë polak të KFOR-it, si dhe një përkthyes - shtetas i Maqedonisë. Të dyshuarit janë nga Maqedonia, gjegjësisht nga një fshat kufitar i Komunës së Likovës.

Që të dy për momentin jetojnë jashtë Maqedonisë, njëri në Francë, ndërsa tjetri në një vend tjetër të Evropës. Identiteti i tyre është i njohur për redaksinë.

Në drejtim të tyre janë duke u zhvilluar edhe hetimet e reja pas shpalljes së pafajësisë për 10 banorët e Sopotit, të cilët 15 vite me radhë u mbajtën pa të drejtë në burgjet e vendit. Motivi për vendosjen e minës mund të gjendet në afërsinë e personave të dyshuar me strukturat maqedone dhe serbe të sigurimit të asaj kohe. Në mesin e të dyshuarve janë edhe punonjës të DSK-së, të cilët kishin përfunduar hetimet me akuzën, se fajtorë janë banorët e fshatit, ata të cilët pas shpërthimit të minës, të parët ishin ofruar për t'i ndihmuar ushtarët e plagosur.

HETIMET

Pas tërheqjes së Prokurorisë Speciale (PS) nga ndjekja e mëtutjeshme e 10 sopotasve të pafajshëm, u shtrua edhe pyetja se cilët atëherë janë fajtorët e vërtetë për këtë vepër. "Për hetimet e reja nuk mund të jap detaje më të hollësishme, vetëm të potencoj se hetimet e reja bëhen me ndihmën ndërkombëtare juridike, ku pritet të përfshihet një shtet fqinj i joni. Në këtë drejtim i shqyrtojmë mundësitë se si të merret deklarata nga persona të caktuar, që mund të kontribuojnë në zbulimin e autorëve të vërtetë. Rasti i Sopoti tashmë hetohet në bazë të një teori të re", kishte thënë prokurorja Katica Janeva.

Informatat e gazetës KOHA flasin se në hetimet e reja janë përfshirë dy personat, për të cilët ka dyshime se veprën e kanë kryer me porosi të shefave të tyre në organet e sigurisë së Maqedonisë në bashkëpunim me ato serbe. Ditën kritike dy personat kanë shkuar në vendin e ngjarjes në rrugën mes fshatrave Sopot-Sushevë dhe kanë vendosur mjetin shpërthyes. Në atë moment, ka lindur edhe një zënkë mes tyre, pasi njëri ka kundërshtuar lokacionin ku është vendosur mina, duke i kujtuar "kryesorit" në këtë aksion se "këtu mund ta pësojnë edhe banorët e pafajshëm".

Grindja mes tyre ka eskaluar dhe si pasojë "shefi " plagos me armë zjarri ndihmësin e tij, duke i shkaktuar plagë në njërën këmbë. Që të dy largohen nga vendi i ngjarjes dhe më pas, aty kalon automjeti i KFOR-it i cili hidhet në ajër. Ajo që vlen të theksohet është se personi i plagosur, më vonë me një makinë nga njerëz misteriozë është evakuuar nga vendi ku ishte strehuar për një kohë, në një vend fqinj, për të përfunduar që atëherë në Francë, ku jeton i lirë me familjen.

HISTORIA E "SHEFIT"

Për dallim nga ndihmësi, i cili në rrethinën e Likovës ka qenë i njohur si person problematik, shefi i tij që është edhe i dyshuari kryesor, po ashtu nga fshati kufitar i Likovës, ka qenë i akuzuar edhe më herët për disa vepra terroriste që kishin ndodhur në atë kohë në disa shkolla të Kumanovës dhe pjesë të hekurudhës Beograd-Athinë, por jo edhe për minën në Sopot. Një kohë, ai u kishte ikur autoriteteve maqedonase dhe ishte strehuar në Kosovë, ku më vonë u arrestua dhe për disa vite u mbajt në burgun e KFOR-it në Bondstill. Më vonë, me kërkesë të autoriteteve të Maqedonisë, ai u ekstradua në vendin tonë, ku vuajti edhe dënimin për këto vepra. Tani që disa vite ai jeton i lirë në një nga shtetet e Evropës perëndimore. Gjithë këto informata kanë qenë të njohura për disa punëtorë të Sigurimit Shtetëror të Maqedonisë, të cilët tani kanë vendosur ta ndërprejnë heshtjen dhe të bashkëpunojnë me hetuesinë në ndriçimin e plotë të rastit. Gazeta KOHA mëson se lista e personave të Drejtorisë për Sigurim dhe Kundërzbulim (DSK) që mund të jenë përfshirë në montimin e rastit të Sopotit, mund të jetë më e madhe nga ato emra që deri tani dolën në opinion.

Deri tani, sipas informatave që dolën në opinion, rezulton se në këtë rast kanë qenë të përfshirë gjashtë inspektorë të DSK-së. Marjan Nikollovski me prejardhje nga Sopoti dhe Mile Andonovski nga Kumanova, Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Mile Vellkovski dhe Ilija Smilevski - që të katër nga Shkupi. Këta janë inspektorët që para Trupit gjykues, dy javë më parë, kanë pranuar provat e PSP-së se në shtëpitë e të dënuarve të Sopotit - nuk kishin gjetur asnjë mjet shpërthyes apo ndonjë provë tjetër me të cilën mund të konfirmohej vepra "terrorizëm" dhe dënimet me burg. Po ashtu, PSP kishte konstatuar se gjashtë inspektorët e DSK-së, në kundërshtim me Ligjin, kishin arrestuar Ramadan Bajramin, dëshmitarin e vetëm në rastin e Sopotit. Madje, e kishin dërguar në një banesë në Strumicë, e kishin lidhur për kaloriferi, deri sa e kishin keqtrajtuar fizikisht dhe psiqikisht deri kur i njëjti kishte firmosur se 10 banorët e Sopotit janë ata që kanë vënë minën në afërsi të fshatit.

SOPOTI, PJESË E "BOMBËS" MIDIS JANKULLOVSKËS DHE MIJALLKOVIT

Se rasti i Sopotit ka qenë i montuar, për këtë flitet edhe në një përgjim midis ish-ministres së Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovsk dhe shefit të DSK-së në kohën e VMRO-së, Sasho Mijallkov. Në këtë bisedë të publikuar dy vite më parë nga lideri i LSDM-së, Mijallkov thekson se ish-ministri i Drejtësisë, Blerim Bexheti, i kishte kërkuar ndërhyrje në gjykatë për disa lëndë përfshirë edhe Sopotin. KOHA publikon bisedën misi Mijallkovit dhe Jankullovskës:

MIJALLKOV: Blerimi më kërkoi, kërkon intervenim në gjykatë për më shumë lëndë... mes tjerash edhe për Sopotin.

JANKULLOVSKA: Po për Sopotin është formuar Komision anketues në Parlament.

MIJALLKOV: Po edhe Buçko ka thënë: Ndjekim njerëz të pafajshëm... Ne iu dhamë përgjigje, e di për Sopotin se do bëjmë diçka, se pas zgjedhjeve kur do ta bëjmë qeverinë, do të shohim të bëjmë diçka, nuk kemi diçka konkret por...

JANKULLOVSKA: Ato, apo më pas (Ahemti e Gruevski) dolën në ballkon, ne diçka...

MIJALLKOV: Edhe Buçko (Vllado Buckovski) ka thënë: Ndjekim njerëz të pafajshëm...

JANKULLOVSKA: Tek ne realisht në MPB nuk ka asnjëfarë dokumentacioni për atë, krejt është pastër. Dhe në bazë të saj, kanë kërkuar hapjen e serishme të rastit...

MIJALLKOV: Qe sa vjet janë ata në burg...

JANKULLOVSKA: Para se të vijmë, është një kohë e gjatë.

MIJALLKOV: 2003-ta...

KATICA JANEVA

Hetimet e reja bëhen me ndihmën ndërkombëtare juridike, ku pritet të përfshihet një shtet fqinj i joni. Në këtë drejtim i shqyrtojmë mundësitë se si të merret deklarata nga persona të caktuar, që mund të kontribuojnë në zbulimin e autorëve të vërtet. Rasti i Sopoti tashmë hetohet në bazë të një teori të re

DEKLARATA QË BËRI KTHËESËN

Ndryshe, rasti i Sopotit konsiderohet si rasti më monstruoz i montuar nga shërbimi sekret maqedonas me qëllim burgosjen e shqiptarëve, duke i shpallur ata si "armiq" të KFOR-it nga njëra anë, dhe nga ana tjetër duke i larguar forcat ushtarake ndërkombëtare nga vija kufitare Maqedoni-Serbi. Në vitin 2003, vetura e KFOR-it, bie në një minë në afërsi të fshatit Sopot drejt rrugës për në fshatin fqinj Sushevë, ndërsa në vendngjarje humbën jetën dy ushtarë polak dhe përkthyesi nga Maqedoni. Pas bastisjeve dhe keqtrajtimit të banorëve shqiptarë të Sopotit, Gjykata e Kumanovës mori vendim që për këtë rast të fajësohen 13 banorë vendas, vetëm me dëshminë e dhunshme të Ramadan Bajramit, i detyruar ta firmos letrën në të cilën pranohej fajësia. Sopotasit atëkohë u dënuan me 156 vite burg. Dënimin e vuajtën Sulejman Sulejmani, Samet Lutfiu, Hasan Klaiqi, Shaban Limani dhe Zenel Klaiqi, ndërsa gjashtë banorë të tjerë u detyruan ta braktisnin vendlindjen. Njëri nga ata, Samet Lutriu më vonë vdes vdiq duke pritur drejtësinë.

Se me të vërtetë sopotasit e dënuar ishin të pafajshëm, ishte deklarata e Ambasadorit të NATO-s atëkohë në Maqedoni, Nikolas Bigman. Para Komisionit parlamentar, Bigman kishte thënë se të dënuarit janë të pafajshëm. "Banorët e dënuar të Sopotit janë të pafajshëm. Dënimi i tyre me burg mbështetet vetëm në një deklaratë, e cila është tërhequr një ditë më pas. Nuk mund të kërkosh nga dikush të dëshmojë pafajësinë, nëse pala tjetër nuk ka dëshmi se je fajtor", pati thënë Bigman. Ai pati vënë në dilemë edhe motivin e aktakuzës ndaj sopotasve. "Nuk ka asnjë arsye për të besuar se cili ishte motivi i fshatarëve për ta vënë mjetin shpërthyes. Shqiptarët edhe atëherë kanë pasur besim në NATO-n si garancë për stabilitet", u pat shprehur Bigman, duke i sugjeruar organeve kompetente që të fokusohen në gjetjen e fajtorëve të vërtetë. "Është në interesin e Maqedonisë që të zbardhen rastet e dyshimta, sepse ajo pretendon të bëhet anëtare e BE-së dhe NATO-s", pati thënë Bigman.

GJYKIMI NË RASTIN E ALMIRIT ME SHKELJE TË SHUMTA PROCEDURALE

KUSIGERSKA ANOI NGA ILIQI, JOVEVSKI TË KETË KUJDES

"Apeloj deri te kryeprokurori që me seriozitetin më të madh ta shqyrtojë rastin. Nëse ata së paku dyshojnë në lëshimet e ekspertizave, çfarëdo qofshin ato, pse nuk bëhen ekspertizë shtesë. Pse nuk kërkohet edhe njëherë rikonstruimi i ngjarjes, pse nuk bëjnë super ekspertizë. Kësisoj edhe ai lë përshtypje në opinion se anon nga njëra palë", thotë Ixhet Memeti

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 22 mars - Zyra e Avokatit të Popullit me shqetësimin më të madh e ka pranuar informatën se prokurorja Suzana Kusigerska ka kërkuar rikualifikimin e aktakuzës në rastin e Almirit. Ombudsmani Ixhet Memeti, në një prononcim për gazetën KOHA, sqaron se nga janari i këtij viti, me kërkesë të palës mbrojtëse, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, e ka përcjellë nga afër procesin gjyqësor kundër të akuzuarit Boban Iliq. "Nga hetimet paraprake të realizuara në rastin e Almirit, të cilat zyra e Avokati të Populli i kemi ndjekur me vëmendje, është konstatuar se bëhet fjalë për një hetim joprofesional, me lëshime procedurale, të cilat mundet rëndë ta lëndojnë drejtësinë", ka thënë ombusdmani, sipas të cilit, edhe Trupi gjykues me "non shallansë" i ka refuzuar provat dhe dëshmitë e palës mbrojtëse.

"Në seancën e fundit, prokurorja e lëndës për Almirin ka kërkuar rikualifikimin e aktakuzës, nga 'vrasje me paramendim', në veprën penale 'aksident me pasoja vdekje', përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, ka shënuar se si prokurorja me shpejtësi dhe duke mos e arsyetuar propozimin në detaje, nuk ka dhënë sqarime se pse e ndërmerr një hapë të tillë. Prokurorja e rastit shumë herë ka tentuar të arsyetojë se i akuzuari ka qenë i detyruar të mbrohet dhe ka deshtë t'i ikë ngjarjes fatale. Perceptimi i përfaqësuesit tonë, i cili e ka ndjekur nga afër këtë seancë, është se prokurorja Suzana Kusigerska e mbron të akuzuarin Boban Iliq, respektivisht anon ka ana e të akuzuarit", thotë ombudsmani Ixhet Memeti. Qëndrim shtesë i Avokatit të Popullit është se në rastin e Almirit, prokurorja Kusigerska nuk ka arritur ta bind opinionin dhe drejtësinë se ka udhëheq proces të mirëfilltë dhe efektiv. Përsëri, siç thotë Memeti, lihet përshtypja dhe dyshimet se kemi të bëjmë me udhëheqëse joprofesionale të procedurës dhe anime të dukshme. Ky perceptim i opiniont, sipas Shënime zyrtare të zyrës së Ombudsmanit, do t'i shkaktoj shumë dëm jo vetëm procesit gjyqësor, por tërë shoqërisë në përgjithësi. Madje, Memeti ka edhe një apel drejtuar kryeprokurorit Lubomir Jovevski.

"Apeloj deri te kryeprokurori që me seriozitetin më të madh ta shqyrtojë rastin. Nëse ata së paku dyshojnë në lëshimet e ekspertizave, çfarëdo qofshin ato, pse nuk bëhen ekspertizë shtesë. Pse nuk kërkohet edhe njëherë rikonstruimi i ngjarjes, pse nuk bëjnë super ekspertizë. Kësisoj edhe ai lë përshtypje në opinion se anon nga njëra palë. I apeloj kryeprokurorit Jovevski që rastet e këtilla, të cilat mundet shumë lehtë të rrisin kredibilitetin e prokurorisë apo të rrënojnë atë, të ketë kujdes me veprimet e tij dhe vendimet që i miraton", thekson Memeti.

Për zyrën e Ombudsmanit në Maqedoni, me rëndësi të posaçme është që ky rast deri në fund të zbardhet dhe ndëshkimi i kryerësve të veprës të bëhet në pajtim me "procedurën efektive". Nga atje ndiejnë keqardhje se pse Maqedonia, lidhur me çështjen e hetimeve, ka probleme serioze.

Ndryshe, pas zyrtarizmit të aktakuzës së rikualifikuar në rastin e Almirit, nga Prokuroria Republikane, e cila pritet shihet se a do të pranohet në Gjykatën e Kumanovës, në opinion është shtuar revolta. Paralajmërimet për reforma të sistemit të drejtësisë në vend, sipas shumë profesorëve universitar dhe njohësve të procedurave ligjore, nuk mundet të realizohet derisa prokurorët e korruptuar, të njëanshëm dhe joprofesional janë pjesë e sistemit gjyqësor.

HETIMI PËR VRASËSIN BOBAN ILIQ FUTET NË PARLAMENT

Grup pune për rastin e Almirit

Shkup, 22 mars - Deputetët e Grupit parlamentar të Bashkimit Demokratik për Integrim të enjten në Parlament u takuan me familjarët e Almirit Aliut. Në marrëveshje me babin dhe avokatin, deputetet e BDI-së inicuan themelimin e Grupit Parlamentar të Punës, ku do të rishikohet i gjithë rasti për Almirin.

"Grupi parlamentar i Bashkimit Demokratik për Integrim në Parlamentin e Maqedonisë kërkon nga Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, në periudhën më të shkurtër të mundshme (sot ose nesër) të konvokojë mbledhje me qëllim të formimit të Grupi të punës në lidhje me rastin e Almirit", shkruan në kërkesën e deputetëve të BDI-së, ndërsa theksojnë se qëllimi i grupit të punës do të jetë grumbullimi i argumenteve për rastin në interes të së vërtetës.

"Qëllimi i formimit të Grupit të punës është në periudhën e arsyeshme, ky t'i grumbullojë të gjitha argumentet për rastin e Almirit në interes të së vërtetës, drejtësisë dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve, duke mos hyrë në funksionet hetuese apo në funksionet tjera, të cilat do të mund ta prishin pavarësinë e gjyqësisë", thuhet në propozim-vendimin e grupit parlamentar të BDI-së. Anëtarë të Grupit të punës, sipas propozimit të deputetëve të BDI-së, do të ishin përfaqësues të lartë të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Avokatit të Popullit, përfaqësues i familjes Aliu, si dhe deputetë nga të gjitha grupet parlamentare në Parlamentin e Maqedonisë.

"Raporti i Gru-pi të punës që do të shqyrtohet në mbledhjen e Komisionit të përhershëm anketues duhet t'ju ndihmojë anëtarëve të Komisionit në kryerjen e kompetencave të tyre në pajtim më Kushtetutën e Maqedonisë, të merr qëndrim të drejtë për rastin e Almirit dhe miratim të mendimit në lidhje me realizimin e dispozitave kushtetuese, ligjeve dhe rregullave të tjera dhe akteve të rëndësishme për realizimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të involvuar në rastin e Almirit", thhet mes tjerash në propozimin e deputetëve të BDI-së. Ndryshe, avokati i familjes Aliu, Almir Alispahiq, njoftoi se pret që në këtë proces do të zbardhen të gjitha shkeljet procedurale dhe padrejtësitë e bëra nga Prokuroria. Iniciativa për formimin e Grupit Parlamentar të Punës u dorëzua dhe arkivua qysh dje, me të njëjtën formë si Grupi punues për rastin e Sopotit, ndërsa kërkohet mbështetje nga të gjitha partive, me qëllim që ky proces të mos marrë kahje politike, partiake apo etnike. *(O.XH)*

Anëtarë të Grupit të punës, sipas propozimit të deputetëve të BDI-së, do të ishin përfaqësues të lartë të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Avokatit të Popullit, përfaqësues i familjes Aliu, si dhe deputetë nga të gjitha grupet parlamentare në Parlamentin e Maqedonisë

SIPAS TË DHËNAVE TË KRAHASUESHME

SHKOLLAT PRIVATE MË PAK NXËNËS DHE MË SHUMË PROFESORË

Nëse i shohim institucionet e arsimit publik dhe privat në nivelin e arsimit të mesëm, do të konstatojmë se privatët ofrojnë kushte më të mira edhe statistikisht. Te këta është mesatarisht 14 numri i nxënësve në klasë, ndërsa në raport me mësimdhënësit - i bie që ata të mos kenë as 6 nxënës për kokë profesori

Koha Laura PAPRANIKU

Shkup, 22 mars - Shkollat e mesme, sipas të dhënave të krahasueshme, janë ato që në Maqedoni bëjnë diferencën mes shkollimit në institucionet e arsimit publik dhe privat. Shkollat e mesme private, të paktën sipas të dhënave zyrtare për numrin e nxënësve, paraleleve dhe kuadrit mësimor, ofrojnë shumë më tepër komoditet krahasuar me shkollat publike në të njëjtat parametra. Shkollat fillore, publike dhe private megjithëse dallojnë me njëra-tjetrën në favor të këtyre të fundit - nuk i kanë edhe aq të theksuara dallimet e raporteve nxënës/paralele dhe nxënës/mësimdhënës. Të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave tregojnë se dallimin më të madh e bëjnë shkollat e mesme private, në të cilat është thuajse dyfish më i vogël numri i nxënësve në klasë dhe dyfish më i madh numri i profesorëve të angazhuar në procesin mësimor.

Si nga pikëpamja e kushteve që ofrojnë për mësim ashtu dhe në aspektin e të dhënave statistikore, shkollat e mesme private tregojnë performanca më të mira se shkollat publike. Nëse te shkollat private numri i nxënësve është mesatarisht 14 nxënës në klasë, te publiku kjo mesatare është 22 nxënës në klasë. Sipas të dhënave të ESHS-së, shkollat e mesme private e filluan vitin shkollor 2016/2017 me 2033 nxënës të shpërndarë në 146 paralele, ndërsa në shkollat e mesme publike po këtë vit shkollor e nisën me 74.361 nxënës të shpërndarë në 3387 paralele. Sakaq, nëse i krahasojmë numrat e nxënësve dhe mësimdhënësve të angazhuar në shkollat private dhe të mesme, do të shohim se këto raporte janë ende më të thella në favor të privatëve. Nisur nga të dhënat se në shkollat e mesme private ishin të angazhuar 377 profesorë dhe 7043 profesorë në shkollat publike, i bie që ai raport të jetë 5.4 nxënës për një profesor te privati dhe 10.5 te publiku. Pra kemi dallim prej thuajse gjysmë për gjysmë e që do të thotë se te shkollat e mesme private - profesorët kanë dyfish më tepër mundësi tu përkushtohen nxënësve sesa në shkollat publike. Në aspektin didaktik, kjo përkthehet si "profesorët dyfish të ngarkuar më shumë në shkollat publike krahasuar me kolegët e tyre të punësuar në shkolla private". E sikurse e pamë më lartë, kjo ngarkesë reflektohet dhe në formimin e paraleleve, respektivisht numrin e nxënësve në klasë. Konkretisht, paralelet e shkollave të mesme publike kanë mesatarisht nga 8 nxënës më shumë në klasë se paralelet e shkollave të mesme private. Nuk ndodh kështu në nivelin e arsimit fillor. Dallimet në numrin e nxënësve në paralele dhe numrin e mësimdhënësve të angazhuar nuk është kushedi sa i madh. Të dhënat e ESHS-së për vitin shkollor 2016/2017, tregojnë se në shkollat fillore publike kishte mesatarisht 16.9 nxënës në klasë, ndërsa në shkollat fillore private, ky numër ishte 16.6 nxënës në klasë. Për 191.332 nxënësit me të cilët u hap viti 2016/2017, në të gjitha shkollat fillore publike kishte 11.344 paralele, ndërsa për 1.378 nxënësit e shkollave private kishte 83 paralele. Pra i bie që raporti nxënës-paralele të jetë aty-aty, ndërsa e parë në aspektin e mësimdhënësve edhe në nivelin e arsimit fillor shkollat private janë në avantazh.

Me 17.679 mësimdhënës në shkolla publike (për 191.332 nxënës) dhe 208 mësimdhënës në shkollat private (për 1378 nxënës), i bie që te publiku një mësimdhënësi ti takojnë mesatarisht rreth 11 nxënës, kurse te privati mesatarisht më tepër se gjashtë nxënës për një mësimdhënës. Kushtet e shkollave, mjetet e punës, hapësirat që ndajnë nxënësit në klasë janë diçka tjetër. Mirëpo, numerikisht në arsimin e nivelit fillor dallimi mes shkollave publike dhe private janë të vogla dhe jo aq të theksuara sa në nivelin e arsimit të mesëm.

HAPET GJIMNAZI AMERIKAN NË SHKUP

Nga viti shkollor 2018/2019, rrjetit të shkollave të mesme private në Maqedoni do ti shtohet dhe një shkollë e re. Është fjala për Gjimnazin Amerikan, i cili do të hapet në Shkup. Inaugurimi i këtij gjimnazi është paralajmëruar të ndodh të premten, më 23 mars 2018 dhe është vijimësi e investimeve private në sistemin arsimor pas Universitetit "Kolegji Amerikan" në Shkup, i themeluar shumë vite më parë. Mësimi do të zhvillohet në gjuhën angleze, ndërsa profili do të jetë i drejtimit gjimnaz.

CUKERBERG DËSHMON PËR LAJMET E RREME

EDHE FB N'ZOR ME PROFILET E RREJSHME NGA MAQEDONIA

Nju-Jork, 22 mars - Pronari i Fejsbukut, Mark Cukerberg deklaroi për Si-En-En se në vitin 2017 kanë zbuluar një numër të madh të profileve të rrejshme nga Maqedonia, prej ku përhapen lajme të rrejshme, dhe se është i gatshëm të dëshmojë para Kongresit amerikan për shkak të keqpërdorimit të të dhënave të rrejshme të miliona shfrytëzuesve të këtij rrjeti social. "Në vitin 2017, gjatë zgjedhjeve speciale për Senatin në Alabama, kemi përdorur vegla të reja që i zhvilluam me qëllim që të zbulojmë profile të rrejshme të cilat mundohen të përhapin lajme të rrejshme. Gjetëm shumë profile të tilla të rrejshme nga Maqedonia. Na pret punë e mundimshme që t'ua vështirësojmë shteteve si Rusia që të përzihen në zgjedhje, të pengojmë njerëz të tjerë të përhapin lajme të rrejshme", tha Cukerberg. Ai pranoi gabimin dhe shprehu keqardhje për shkak të skandalit. "Me të vërtetë më vjen keq për atë që ka ndodhur", deklaroi Cukerberg në intervistë, së pari pasi u zbulua skandali me kompaninë Kembrixh analitiks, e cila lidhet me fushatën presidenciale të Donald Trampit në vitin 2016. Ato pranuan se kanë pasur qasje deri te 50 milionë shfrytëzues të Fejsbukut pa dijen e tyre dhe kanë ruajtur të dhëna pasi Fejsbuku ka kërkuar fshirje të të dhënave. Sipas tij, kompania ka bërë gabime dhe theksoi se kjo e ndryshon politikën e tyre për privatësi që të mbrohen të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit social. Cukerberg paralajmëroi kufizim të qasjes deri te të dhënat personale të shfrytëzuesve të FB dhe njoftim deri te gjithë shfrytëzuesit të dhënat e të cilëve mund të keqpërdoren pa lejen e tyre. "E qartë është se deri në vitin 2016 nuk e kemi plotësuar mirë detyrën që të përgjigjemi në sfidat si duhet, pa dallim nëse bëhet fjalë për përzierje të Rusisë në zgjedhjet në SHBA ose për lajme të rrejshme. Por, atë që e pamë prej atëherë është se disa muaj më vonë kishte zgjedhje në Francë ku sistemuam disa IT vegla bënë punë të madhe", deklaroi Cukerberg.

Hungari, arrestuar shtetasi i Maqedonisë me 11 kg heroinë

Shkup, 22 mars - Drogë e llojit heroinë me vlerë prej gjysëm milionë eurosh ka sekuestruar policia hungareze në automjetin e një shtetasi të Maqedonisë. Droga ka qenë e paketuar në 15 pako me peshë të përgjithshme prej 11,7 kilogramë. Siç transmetoi RTS në hyrjen e Hungarisë nga Serbia policia gjatë një kontrolli të hollësishëm të një automjeti motorik "BMV X5", që e ka drejtuar një shtetas i Maqedonisë, qeni special policor për zbulim të narkotikëve e ka zbuluar drogën nën karrigen e pasagjerit. Shoferi është arrestuar dhe kundër tij do të ngrihet procedurë për kontrabandë droge.

SIGURIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE

BUJQIT JANË SKEPTIKË

Bujqit ankohen për mënyrën e vlerësimit të dëmeve që kryejnë kompanitë e sigurimeve . Ato kërkojnë nga kompanitë e sigurimeve që deri në muajin nëntor të këtij viti të publikojnë programin , që të mund me kohë të informohen me pakot e ndryshme që ofrojnë kompanitë

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 22 mars - Ndonëse nga viti 2008 shteti mbulon afër gjysmën e sigurimit bujqësor të të mbjellave, fermerët në Maqedoni vazhdojnë të jenë skeptik për përfitimet nga sigurimi bujqësor. Këtë e tregojnë edhe të dhënat zyrtare, sipas të cilave në vitin 2015 janë nënshkruar 5.000 kontrata, ndërsa në vitin 2016 janë shitur vetëm 2000 kontrata për sigurim bujqësor. Edhe në vitet e tjera, shifrat e sigurimit bujqësor nuk janë lakmuese, përkundër asaj se që nga viti 2008, qeveria vendosi masën e ndihmës për sigurimin e prodhimit primar bujqësor , fatkeqësive natyrore dhe kushteve të pavolitshme klimatike me 60 për qind të sigurimit.

Një pjesë e shoqatave bujqësore në Maqedoni vlerësojnë se bujqit janë nuk besojnë se kontratat që do të lidhin me kompanitë e sigurimit do të zbatohen në praktikë.

"Bujqit thjeshtë janë skeptik dhe nuk besojnë se me të vërtetë do të kenë dobi nga sigurimi i të mbjellave bujqësore dhe sa realisht do të fitojnë kompensime të caktuara për dëmet e ndryshme. Frika e tyre buron edhe nga fakti se kompanitë e sigurimeve shpesh premtojnë diçka para nënshkrimit të kontratës, ndërsa më vonë kërkesat e tyre nuk realizohen apo realizohen me shumë vështirësi. Mbetet të shohim si shoqatë se çka propozohet dhe parashikohet në drejtim të mbështetjes më të madhe të sigurimit bujqësor. Pra, ne do të japim vlerësimin tonë për modelin e ri të sigurimit të mbjellave pasi të shohim konkretisht në letër se çka përmbajnë ndryshimet që propozohen nga Ministria e Bujqësisë" ", thotë Mendu Nuhiu, kryetar i Shoqatës së bujqve " Agrokultura", nga Likova.

Nga ana tjetër, bujqit ankohen për mënyrën e vlerësimit të dëmeve që kryejnë kompanitë e sigurimeve . Ato kërkojnë nga kompanitë e sigurimeve që deri në muajin nëntor të këtij viti të publikojnë programin , që të mund me kohë të informohen me pakot e ndryshme që ofrojnë kompanitë.

Në ndërkohë nga Ministria e Bujqësisë thonë se po shqyrtohet modeli i ri i sigurimit në bujqësi për shkak të numrit të ulët të kontratave për sigurimin e të mbjellave. Do të punohet edhe në rritjen e vetëdijes për nevojat dhe përfitimet nga sigurimi tek bujqit.

" Nuk mundemi çdo herë të ndikojmë ndaj ndryshimeve klimatike, por si ministri duhet të punojmë për instrumentet efikase me të cilat do të mbrojmë prodhimtarinë bujqësore , ndërsa bujqit do të mund të mbulojnë humbjet. Gjithashtu bujqit e siguruar kanë qasje ndaj më shumë programe të subvencionimit , ndërsa në aspekt afatgjatë, sigurimi bujqësor do të lehtësojë edhe buxhetin që në pjesën më të madhe harxhohet për pagesën e dëmeve që ju shkaktohen bujqve :, thotë ministri i bujqësisë , Ljupço Nikollovski.

Sipas duhet të gjendet mënyrë dhe model më funksional në suaza afatshkurtra, afat mesme dhe afatgjate , që bujqit të sigurojnë të mbjellat, në vend se të presin dëmshpërblim siç praktikohej në të kaluarën. Në këtë drejtim do të shfrytëzohen edhe përvojat nga Spanja dhe Turqia .

Nga ana tjetër, ofertat e kompanive ofrojnë sigurimin e të gjitha kulturave bujqësore që akoma nuk janë mbledhur apo grumbulluar. Sigurohen edhe rendimentet e pritura vjetore të rrushit, pemëve, drithërave, perimeve dhe kulturave industriale. Ndër rreziqet themelore që mbulon sigurimi janë breshëri, zjarri dhe rrufeja. Rekomandohet që krahas sigurimit themelor, të nënshkruhet edhe sigurim shtesë për të mbrojtur frutat dhe të mbjellat nga vërshimet, ngricat pranverore dhe stuhitë. Gjithashtu mund të sigurohen edhe mbulimi i humbjeve të mollëve, dardhave , pjeshkave dhe kajsive nga humbja e sasisë dhe cilësisë. Sigurimi mbulon vetëm të mbjellat dhe rendimentet në sipërfaqen bujqësore të siguruar në periudhën nga mbjellja deri në grumbullimin e tyre.

Ndryshe, bujqësia në Maqedoni merr pjesë me 10 për qind në krijimin e PBB duke krijuar vlerë financiare prej afër 900 milion euro. Në arritjen e këtyre projeksioneve financiare merr pjesë vetëm afro 20 për qind e popullatës, të cilët merren me bujqësi, si veprimtari primar apo dytësore, por pa harruar faktin se veprimtaria bujqësorë dhe blegtorale paraqet edhe burimin e vetëm të ekzistencës së shumë familjeve, kryesisht në rajone rurale.

Shteti premton zgjidhjen e problemit të personave pa dokumente

Shkup, 22 mars - Të gjithë personat të cilët jetojnë në territorin e Maqedonisë, ndërsa nuk janë të regjistruar në regjistrat amë, gjegjësisht nuk kanë certifikatë, as çfarëdo lloj dokumente personale dhe nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, nga 1 prill e deri më 30 shtator do të mund të paraqiten deri te Drejtoria për Evidencën e Regjistrave Amë të kërkojnë regjistrim shtesë. Për momentin ka informata se rreth 550 persona kanë problem të këtillë, ndërsa pritet që me procesin të përfshihen rreth 3000 persona. Që të realizohet ky proces do të bëhen ndryshime ligjore të cilat do ta lehtësojnë në mënyrë plotësuese regjistrimin, ndërsa qendrat për punë sociale, njësitë rajonale të Drejtorisë, si dhe organizatat joqeveritare do të ndihmojnë që personat e këtillë të evidentohen dhe të dorëzojnë kërkesa. "Në mënyrë të këtillë do të konfirmohet numri i saktë i personave deri tani të paevidentuar të cilët janë në territorin e RM-së, ndërsa me ndryshimet e ligjeve ata do të fitojnë të drejtë të numrit të përkohshëm të amzës ose numër të përkohshëm regjistrues që të mund të realizojnë të drejta sociale, shëndetësore dhe arsimore, që të mos ketë fëmijë dhe persona të shkyçur nga sistemi. Gjithashtu, më vonë do të jepet mundësi që ata ta marrin edhe numrin e tyre të parë të amzës", tha në konferencën për shtyp ministrja e Punës dhe Politikës Sociale Milla Carovska.

KRONIKË

Vidhet vetura 50 mijë euro

40 vjeçari me iniciale A.O nga Tetova, mbrëmë rreth orës 19.50 minuta ka denoncuar se persona të panjohur i kanë vjedhur veturën "Land Rover", me targa të Tetovës, pronë e babait të tij. Sipas policisë, para se ti vidhet vetura, ai është ndalur në një barnatore në rrugën "Bllagoja Toska", në Tetovë, ka dalë dhe kur është kthyer - vetura nuk ka qenë në atë vend ku ka patur edhe dokumente personale. Vetura është përllogaritur në vlerë prej 50 mijë euro. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Konfiskohen 91 kg marihuanë, tre të arrestuar

MPB dje në Kërçovë ka arrestuar tre persona nga Shkupi dhe ka konfiskuar 91 kilogramë marihuanë. Kundër tre të arrestuarve dhe për edhe tre persona të tjerë, dy nga Struga dhe një nga Shkupi, janë parashtruar kallëzime penale për "prodhim të paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekusorëve". Siç informoi sot zëdhënësi i MPB-së, Toni Angelovski, të denoncuarit e kanë marrë marihuanën nga Shqipëria fqinje dhe e kanë deponuar në Strugë, me qëllim që ta transportojnë në Shkup. Dje në orët e hershme të mëngjesit, marihuana është dashur të transportohet në Shkup dhe është vendosur në automobilin "mercedes" me targa të Shkupit, në të cilin ishin dy nga të arrestuarit, ndërsa para tij në rolin e të a.q. pastrues ka lëvizur automobili "BMV" me targa nga Prilepi i drejtuar nga njëri nga tani të arrestuarit. Sipas planit paraprakisht të përgatitur, nga ana e nëpunësve policorë në hyrje të Kërçovës, është ndaluar "mercedesi", ndërsa në të njëjtën kohë në dalje të Kërçovës është ndalur edhe automobili tjetër BMV dhe që të tre personat janë privuar nga liria. Nga kontrolli i kryer në "mercedes" janë gjetur nëntë thasë dhe një çantë udhëtimi me marihuanë. Tre të denoncuare, gjykatësi i procedurës paraprake u caktoi masa të paraburgimit në kohëzgjatje prej nga 30 ditë, një person tani më po e vuan dënim me burg në burgun e Strugës dhe është transferuar në burgun e Shutkës në Shkup, ndërsa pas dy persona policia ende është në kërkim.

Sulmohet tetovari me thikë

32 vjeçari D.Gj nga Tetova, të mërkurën mbrëma rreth orës 22 ka denoncuar se person i panjohur rreth orës 21:30 minuta e ka sulmuar në rrugën "Vidoja Smilevski Bato", pasi që më parë kishte zbritur nga vetura e taksisë me të cilën kishte ardhur. Sipas policisë, personi i panjohur ka tentuar ta sulmojë dhe me thikë e lënduar në kokë. Me këtë rast, tetovari ka rënë në trotuar dhe ka lënduar edhe dorën e majtë, ndërsa sulmuesi me një vajzë tjetër ka ikur nga vendi i ngjarjes. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit. *(U.H)*

Për një javë, 1304 të sëmurë nga gripi

Shkup, 22 mars - Gjatë javës së kaluar (nga 12 marsi e deri më 18 mars), në Republikën e Maqedonisë janë regjistruar 1.304 të sëmurë nga gripi, që është ulje për 31 për qind në krahasim me javën e para të saj, kur janë regjistruar 1,980 të sëmurë nga gripi, theksohet në raportin e publikuar nga Instituti i Shëndetit Publik në faqen e saj të internetit. Në lidhje me javën e 11-të të sezonit të kaluar, i cili ishte karakterizuar me fillim të hershëm dhe aktivitet, këtë sezon numri i rasteve është rritur për 13 herë. Incidenca e regjistruar këtë javë është brenda kufirit javor të aktivitetit të ulët (sezonal) të virusit të gripit. Ashtu si edhe në javët e kaluara, në javën e 11-të numër më të pash të të sëmurëve - 818 janë paraqitur në grupmoshën më të madhe prej 15-64 vjet, dhe incidenca më e lartë prej 97,3 për 100.000 banorë të regjistruar tek më të vogjlit - fëmijë të moshës prej 0 - 4 vjet. Këtë javë numër më të madh të të sëmurëve - 227 janë paraqitur në rajonin e QSHP Shkup, dhe incidencë më të lartë 292,5 për 100.000 banorë është në rajonin e njësisë rajonale Sveti Nikollë. Nga gjithsej 31 njësi raportuese në vend, në një është regjistruar aktivitet i lartë (NJR Sveti Nikollë). Në QSHP/NJR janë regjistruar nga një aktivitet shumë i ulët në nivel të mesëm të virusit të gripit, ndërsa në katër NJR nuk janë regjistruar persona të sëmurë. Deri më tani në sezonin 2017/2018 gjithsej janë paraqitur 22.404 raste të gripit,sëmundje të ngjashme të gripit me incidencë prej 1.082,8 në 100.000. Numri i regjistruar i rasteve është më i vogël për 36 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të sezonit të kaluar (34.725).

Për tre muaj, 11 persona nga fruthi

Shkup, 22 mars - Për tre muaj në Maqedoni janë regjistruar 11 raste të fruthit, tetë nga të sëmurit jetojnë në Shkup, ndërsa nga një në Kumanovë, Tetovë dhe Ohër. Në vitin 2017 janë regjistruar 19 raste prej të cilëve 16 në Qendrën për Shëndet Publik Shkup dhe nga një në qendrat në Strugë, Prilep dhe Tetovë. Sipas të dhënave të Sektorit për parandalim dhe kontroll të sëmundjeve infektive pranë Institutit për Shëndet Publik Shkup, ndërsa sipas datës së sëmundjes, në janar janë regjistruar katër raste dhe shtatë në shkurt. Personi i sëmurë i cili është regjistruar në Ohër ka qenë për qëndrim të përkohshëm tek familjarë, ndërsa me adresë të jetesës në Prizren, Kosovë. Nga të sëmurit me fruth në vitin 2017, 14 persona nuk kanë qenë të vaksinuar, katër kanë qenë të moshës mbi 29 vjet dhe kanë qenë të vaksinuar, me një dozë, ndërsa një person me dy doza. Rasti i indeksit në epideminë ka qenë edhe një fëmijë i pavaksinuar i cili ka pasur kontakt me rast të dyshimtë në Kosovë. Në Klinikën për Sëmundje Infektive dhe Gjendje Febrile në Shkup, janë hospitalizuar shtatë persona, ndërsa te dy raste janë regjistruar komplikime në lloj të pneumonisë.

DONACION

TIKA PAJIS QENDRËN E KONSERVIMIT

Mbi 26 kompjuterë, ploter, printues, e të tjera janë dorëzuar të enjten në QNK do të zëvendësojnë pajisjet e amortizuara dhe jofunksionale kompjuterike të cilat i ka pasur në dispozicion stafi i këtij institucioni

Koha — Evis HALILI

Shkup, 22 mars - Qendra Nacionale e Konservimit përmes donacionit të Agjencisë turke për bashkëpunim dhe zhvillim - TIKA, është kompletuar me pajisje bashkëkohore kompjuterike. Mbi 26 kompjuterë, ploter, printues, e të tjera janë dorëzuar të enjten në QNK do të zëvendësojnë pajisjet e amortizuara dhe jofunksionale kompjuterike të cilat i ka pasur në dispozicion stafi i këtij institucioni. Marrëveshja e donacionit është nënshkruar nga drejtori i QNK Memet Selmani dhe koordinatori i TIKA-s, Ajtekin Ajden në prani të ministrit të Kulturës Robert Allagjozovski, i cili e ka cilësuar këtë donacion si tregues të bashkëpunimit të mirë mes dy vendeve, me theks në mbrojtjen e trashëgimisë.

"Ky donacion është i rëndësishëm për ne, pasi që kemi shumë probleme të trashëguara . në korniza të buxhetit tonë i përcaktuam prioritetet dhe ndonjëherë e kemi të vështirë që të vendosim se pikërisht furnizimi me pajisje të reja bën pjesë tek kërkesat më urgjente", ka thënë ministri. Bashkëpunimi i Tika me QNK ka nisur prej hapjes së zyrës së kësaj organizate në vitin 2005 në Shkup. Kryesisht bashkëpunimi ka përfshirë projekte për konservimin dhe restaurimin e objekteve të rrezikuara të trashëgimisë, kryesisht objekte sakrale, si xhami, tyrbe, e të tjera.

"Tika është partner dhe një prej mbështetësve financiarë të shumë projekteve të rëndësishme në sferën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore të periudhës otomane në të gjithë territorin, por hasëm në një mirëkuptim të plotë nga ana e tyre edhe për një projekt të tillë, të ndryshëm nga të tjerët, rinovimi i pajisjeve kompjuterike të vjetruara dhe në pjesën më të madhe jofunksionale", ka thënë drejtori i QNK, Selmani. Duke folur për projektet e realizuara deri tani dhe kushtet e volitshme nga ana e Ministrisë së Kulturës për zbatimin e tyre, koordinatori i Tika, Ajtekin Ajden, tha se me këtë donacion synojnë të mbështetin procesin e punës së Qendrës dhe zhvillimin e kapaciteteve të tij.

"Deri tani kemi realizuar mbi 850 projekte, ku më prioritet kemi pasur ato në sferat e shëndetësisë, bujqësisë, arsimit. Projekt për mbrojtjen e trashëgimisë janë po ashtu të rëndësishme dhe kemi realizuar një numër të madh, ku qëllimi ynë është që në formën më të mirë kjo trashëgimi t'iu përçohet gjeneratave të reja, por njëkohësisht të shërbejnë për të tërhequr sa më shumë turistë të huaj", ka thënë Ajden. Qendra Nacionale e Konservimit, përveç mungesave në pajisje, ambienteve të amortizuara të zyrave dhe godinës në tërësi përballet me një numër jashtëzakonisht të vogël të ekspertëve, të pamjaftueshëm për të realizuar projektet dhe për vizita ekspenditive në terren. Si shkak i mangësive kadrovike ky institucion ende nuk ka arritur të përpilojë evaluimin e të gjitha monumenteve të trashëgimisë dhe klasifikimin e tyre sipas kategorive që iu përkasin.

SHQIPËRIA KËRKON MË SHUMË FAKTE

Ministria e Kulturës së Shqipërisë ka kërkuar nga Ministria e Kulturës së Maqedonisë më shumë informacione, specifikim dhe fotomateriale që t'i identifikojnë ikonat që Maqedonia i kërkon nga Shqipëria, kumtoi ministri Robert Allagjozovski lidhur me ikonat që organet kompetente shqiptare i kanë sekuestruar në procedurë për parandalimin e tregtisë ilegale me artefakte me vlerë kulturore. "Edhe pse ne dërguam mjaft detaje, ata e kërkojnë atë faktografi shtesë dhe shërbimet tona tashmë veprojnë që t'ua dërgojnë. Nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë mora bindje se ata nuk kanë asgjë kundër që t'i kthejnë mbrapa gjësendet, vetëm duan plotësisht ta respektojnë procedurën dhe të jenë plotësisht të sigurt se ajo që nga ne është kërkuar - përgjigjet dhe është e identifikuar në përmbledhjen e ikonave që e posedojnë në këtë rast", tha Allagjozovski..

PËRMENDORET E SHKUPIT 2014 NË LISTËN E PRITJES

Ministria e Kulturës nuk ka asnjë procedurë aktive për heqjen e ndonjë prej monumenteve të Shkupit 2014. Procedurat për verifikimin e shkeljeve ligjore që po kalojnë në filtrin e më shumë institucioneve kërkojnë kohë që të përfundojnë, ndërsa informacionet për heqjen e tyre, siç ishte rasti i përmendores Kalorësi (Aleksandri i Madh) në sheshin "Maqedonia" ministri i Kulturës Robert Allagjozovski i ka cilësuar si spekulative. Ai ka bërë me dije se elaborati i kësaj përmendoreje, i përgatitur nga grupet punuese për rishikimin e projektit Shkupi 2014 ka më shumë se dy muaj që është depozituar në institucionet kompetente për të verifikuar parregullsitë e tij. "Nuk kemi asnjë procedurë aktive për heqjen e ndonjë prej përmendoreve të Shkupit 2014, përveç asaj që u hoq. Kështu që pohimet që bëhen në publik për heqjen eventuale të ndonjë tjetër përmendoreje janë spekulime... Grupet e punës vazhdojnë të punojnë dhe deri tani kanë përgatitur disa elaborate për të cilat ne jemi në kontakte të vazhdueshme edhe me institucione të tjera përkatëse, verifikojmë se ku janë cenuar ligjet, ku ka shkelje të tjera dhe e gjithë kjo kërkon kohë, por ka edhe raste kur duhet të punohen elaborate shtesë sipas sferës specifike", ka thënë ministri.

ÇARSHI XHAMIA E PRILEPIT ASSESI TË NGRIHET NË KËMBË

BRENDA XHAMISË SHËTITËN PIJANECË, NARKOMANË DHE KAFSHË

Edhe pse kanë kaluar vite të tëra, ende nuk është bërë hapi konkret për riparimin e xhamisë, teksa mbetet enigmë se kur xhamisë do t'i kthehet pamja e dikurshme madhështore

Prilep, 22 mars - Çarshi xhamia e Prilepit të Maqedonisë, e cila pësoi nga konflikti ndëretnik që ndodhi në vitin 2001, është para zhdukjes totale nga dita në ditë për shkak të mungesës së përkujdesjes. Objekti osman në Prilep, qytet ky në pjesën qendrore të vendit, i cili i përket periudhës së Fatih Sulltan Mehmetit, në mes të qytetit pret ditën kur do të rihapet për adhurim. Në muajin gusht të vitit 2001, huliganë maqedonas nga Prilepi u ngritën në këmbë dhe dogjën Çarshi xhaminë në Prilep si kundërpërgjigje ndaj sulmit mbi autokolonën ushtarake që po shkonte në Tetovë në autostradën Shkup-Tetovë, e si pasojë e të cilit humbën jetën dhjetë ushtarë nga Prilepi dhe rrethina. Edhe pse kanë kaluar 17 vite, ende nuk është bërë hapi konkret për riparimin e xhamisë, teksa mbetet enigmë se kur xhamisë do t'i kthehet pamja e dikurshme madhështore. Derisa më parë thuhej se nuk ka vullnet politik për riparimin e xhamisë, tashmë ajo injorohet plotësisht.

Shumë herë xhamia është përballur me rrezikun e zhdukjes së tërësishme ndërsa tani është e shkatërruar. Muret e xhamisë së filmuar nga Anadolu Agency (AA) qëndrojnë pjesërisht në këmbë. Xhamia me minaren e thyer, mbetet pre e shumë sjelljeve të pahijshme për shkak të mungesës së interesimit dhe mosruajtjes së saj. Brenda xhamisë shëtitën pijanecë, narkomanë dhe kafshë.

Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë ka tri marrëveshje me Ministrinë e Kulturës për riparimin e xhamisë, edhe atë në vitin 2006, 2010 dhe 2012, ndërsa autoritetet e larta turke janë njoftuar në lidhje me këtë çështje. Theksohet se në qytet jetojnë rreth 20 mijë muslimanë, ndërsa edhe esnafët e çarshisë janë pro ndërtimit të xhamisë. Me ndërtimin e xhamisë do të kthehet edhe karakteri i qytetit, kurse mosmarrja e hapave në këtë drejtim has në reagimin e qytetarëve. Nga ana tjetër, në Maqedoni si pasojë e përleshjeve në vitin 2001, janë shkatërruar një numër i madh i xhamive dhe kishave.

Muslimanët nuk kanë penguar në asnjë mënyrë kishën Shën Nikolla, ndërtimi i së cilës ka filluar në vitin 1995 dhe ka përfunduar në vitin 2016 dhe kambanën - ndërtimi i së cilës është duke përfunduar, në Shkup-Veri që është e populluar me shumë banorë muslimanë. Vlen gjithashtu të përmendet se vendet e shkatërruara të adhurimit të muslimanëve në vendet ku shumica janë të krishterë qoftë në përleshjet e vitit 2001 si në shembullin e Çarshi Xhamisë së Prilepit qoftë më parë, tërheq vëmendjen mosrestaurimi i tyre dhe vendosja e pengesave dhe vështirësive të ndryshme ndaj tyre.

Gjithashtu xhamia e Ali Pashës në Ohër ishte cak i protestave të maqedonasve në vend me pretendim se minareja e xhamisë në projektin e restaurimit është më e gjatë se ajo në origjinalen, me ç'rast ishin ndaluar punimet e restaurimit. Ministri i Kulturës së Maqedonisë, Robert Alagjozovski, në takimin e tij me drejtorët e institucioneve të kulturës në Ohër në muajin dhjetor të vitit të kaluar, ka theksuar se do të ndalohet restaurimi i xhamisë pesë shekullore pas reagimit të shoqatave në Ohër në lidhje me mënyrën e restaurimit të xhamisë. Procesi lidhur me këtë çështje, me kërkesën e grupit të punës së themeluar nga Ministria e Kulturës, iu prezantua UNESCO-s. Restaurimi i xhamisë Ali Pasha financohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë.

KATET E LARTA TË PABANUESHME

Dëme të mëdha nga zjarri në ndërtesën në Tetovë

Koha — Urim HASIPI

Tetovë, 21 mars - Ndërtesa, e cila të mërkurën pasdite u përfshi nga zjarri në katet më të larta, është i pabanueshëm dhe do të duhet kohë për riparim dhe eliminimin të dëmeve nga zjarri. Mungon rryma elektrike, mure të çara, plasaritje të pllakës kryesore, dhe lagështi janë pamjet që të enjten vërehen si pasojë e zjarrit, i cili gjatë tërë pasdites dhe orëve të vona të së mërkurës kaploi këtë ndërtesë disaktëshe në pjesë qendrore të qytetit të Tetovës. Banorët thonë se disa janë kthyer, por nuk kanë kushte për të qëndruar për shkak të mungesës së rrymës elektrike. Jashtë funksionit është edhe ashensori në këtë ndërtesë. Janë 30 familje që jetojnë në këtë ndërtesë, kurse dëmet janë të mëdha, pohojnë ata. "Nuk ka rrymë në tërë ndërtesën. Më e rëndë është situata në katin më të lartë, ku të pabanueshme janë katër banesa. Ka plasaritje të mureve, lagështi ka gjithandej, inventari është i dëmtuar. Pjesa më e madhe e banorëve janë strehuar tek të afërmit, kurse poashtu presim të vijnë ekspertë që të shohin qëndrueshmërinë e këtyre kateve dhe më pas të vijohet me riparimin", thonë banorët e kësaj ndërtese. Gjatë ditës së enjte kanë vijuar hetimet e organeve të policisë për të vërtetuar arsyet e shpërthimit të zjarrit, kurse në vendngjarje kanë qenë edhe pjesëtarë të Njësisë së zjarrfikësve. Gjatë intervenimit të së mërkurës ka patur edhe disa zjarrfikës të lënduar. Deri në lokalizimin e zjarrit, Njësisë së zjarrfikësve u është dashur që të qëndrojnë deri ora 1 në mesnatë. Uka Aliti, udhëheqës i Brigadës së Njësisë së zjarrfikësve, thotë se kudjestari kanë bërë deri në orët e mëngjesit. "Kemi intervenuar me 17 zjarrfikës dhe disa automjete. Më shumë se tre orë është dashur që të lokalizohet zjarri dhe them me përgjegjësi se kemi patur shumë vështirësi. Diku në mesnatë kemi arritur të shuajmë zjarrin tërësisht, por kemi bërë kujdestari që të mos rindizet zjarri", tha Aliti. Mungesa e shkallëve hidraulike u vërejt gjatë intervenimit të mbrëmshëm pasi zjarrfikësit duhej të intervenonin nga pjesa e brendshme që ka krijuar edhe shumë vështirësi në vënien në kontroll të zjarrit. "Është shumë e vërtetë se mungon një automjet me shkallë hidraulike që do të na nevojiteshin në këto raste. Prioritet ka qenë evakuimi i banorëve dhe më pas kemi filluar me përballjen e zjarrit. Vazhdimisht kërkojmë pajisje më të mira dhe më moderne për të intervenuar në këto raste dhe vazhdojmë që t'i kërkojmë me ngulm, sepse janë më se të nevojshme për punën tonë", deklaroi ai. Përndryshe, të mërkurën rreth orës 16.00 ka shpërthyer zjarr në kulmin e një ndërtesë që gjendet në afërsi të shkollës fillore "Liria" në Tetovë, përballë gjykatës së Tetovës. Zjarri fillimisht kishte shpërthyer në pjesën e nënkulmit dhe ka përfshirë edhe kulmin e kësaj ndërtese. Fatmirësisht nuk ka patur të lënduar njerëz, ndërsa banorët përkohësisht janë strehuar tek të afërmit e tyre. Banorët që jetojnë në këtë pallat shumëkatësh thonë se ndërtesa përbëhet prej 30 banesave, në të cilat jetojnë rreth 30 familje, ndërsa theksojnë se nuk i dinë shkaqet e shpërthimit të këtij zjarri. Përndryshe, makineria e zjarrfikësve të Tetovës ka hasur në shumë vështirësi për të arritur deri në vendngjarje.

Gjatë intervenimit ka patur edhe disa zjarrfikës të lënduar. Deri në lokalizimin e zjarrit, Njësisë së zjarrfikësve u është dashur të qëndrojnë deri ora 1 në mesnatë. Uka Aliti, udhëheqës i Brigadës së Njësisë së zjarrfikësve thotë se kudjestari kanë bërë deri në orët e mëngjesit

Më shumë kujdes për Adem Demaçin

Nga Rexhep Torte

Në Televizionin Publik të Kosovës (RTK), të premten më datë 16.02.2018 afër orës 12 të mesditës, pata rastin ta ndjek një pjesë të intervistës ku si mysafir i këtij televizioni ishte z.Jakup Krasniqi me rastin e 10-vjetorit të Pavarsisë së Republikës së Kosovës. Një nga pyetjet e fundit që gazetari ia bëri z.Jakup Krasniqit ishte që mysafiri ta jep opinionin e tij lidhur me faktin se " z.Adem Demaçi aktualisht sipas gazetarit është në gjendje të ligë shëndetësore dhe se sipas nevojës i jepet ndihma mjekësore në banesën e tij ku jeton. Ndërkaq sipas gazetarit shumë funksionarë kosovarë qoftë edhe për një sëmundje gripi shkojnë për tu mjekuar jashtë shtetit".

Jakup Krasniqi kësaj pyetje të gazetarit iu përgjegj se, "kjo është gjendja në të cilën ndodhet mjekësia në Kosovë, ndërsa udhëheqësit tanë nuk preferojnë të qeverisin por preferojnë të sundojnë".

Me të dëgjuar këto fjalë më kapluan të rënqethura dhe djersë të ftohta. Pasioni im prej gazetari më shtyri që këtë çështje ta sensibilizoj menjëherë, por sëmundja e rëndë e karcinomit që kam në sy ma ngadalësoi këtë dëshirë. Megjithatë falë Zotit të Madhërishëm këtyre ditëve arrita ta realizoj dhe ta dërgoj për ta botuar.

Nuk na ka hije që ndaj z.Adem Demaçit të sillemi me indeferentizëm, të poshtërohemi dhe ta ulim dinjitetin tonë.

NJOHJA IME ME DEMAÇIN

Unë me z.Adem Demaçin jam takuar viteve të kaluara tri herë në Dibër, kur ai kishte ardhur në Banjat e Dibrës për ta shkruar një romanin të tij.

Gjatë këtyre takimeve me z.Adem Demaçin kam bërë tri intervista të gjëra të cilat i kam botuar në të përditshmen "Fakti" kur kjo gazetë dilte rregullisht.

Përshtypja ime si gazetar me një përvojë të gjatë në gazetari është se vështirë të gjendet personalitet dhe intelektual i kalibrit si Adem Demaçi, i cili në pyetjet e gazetarit përgjigjet me një shkathtësi dhe shpejtësi tejet cilësore duke shprehur mendimet dhe filozofinë e tij politike në një nivel të lartë dhe pa gabuar fare.

Këtyre viteve duke e parë margjinalizimin që iu bë z.Adem Demaçit nga klasa politike e Kosovës kam shkruajtur e botuar edhe disa tekste me titull "Adem Demaçi për president".

Adem Demaçin si veprimtar e shkrimtar e kam njohur qysh në vitet e 50-ta të shekullit të 20-të kur ai në revistën "Jeta e Re" botonte tregimet "Gjarpërinjtë e gjakut" dhe kur tërë intelektualët dhe atdhedashësit flisnin për aktivitetet, guximin dhe burgosjet e tij për çështjen shqiptare të Kosovës dhe mbarëkombëtare.

Adem Demaçi me të gjitha mundësitë dhe format që kishte në dispozicion me vigjilencë të fuqishme i kundërvihej rregjimit të ashpër okupues serb, që manifestohej me burgosjen e studentëve dhe të intelektualëve shqiptarë në ish Jugosllavi nëpërmjet aksionit serb për mbledhjen e armëve dhe të detyrimit të shqiptarëve për tu shpërngulur nga trojet e veta stërgjyshërore.

Këto aktivitete bënë që UDB jugosllave në vitin 1958 ta arrestojë dhe dënojë Adem Demaçin me 3 vite burg. Pastaj u burgos sërish dhe vuajti dënimin me burg nga viti 1964-1974. Adem Demaçi për veprimtarinë e tij të vazhdueshme kombëtare shqiptare u burgos sërish dhe vuajti dënimin me burg gjatë viteve 1975-1990.

Duhet theksuar se gjatë proceseve gjyqësore Adem Demaçi dënonte hapur represaljet e pushtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Adem Demaçi është nismëtar i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve ku morrën pjesë bijtë dhe bijat më të mirë atdhetare shqiptare.

IDOL QË NXITI SHUMË GJENERATA

Pas vuajtjes së 29 viteve burg Adem Demaçi iu rikthye krijimtarisë letrare dhe aktivitetit politik duke patur gjithnjë në spikamë dashurinë për kombin shqiptar si pishtar i palodhur për lirinë dhe barazinë e popullit shqiptar.

Adem Demaçi mbeti stoik dhe i palëkundur me idetë e tij duke i qëndruar përkrah dhe sypatrembur edhe UÇK-së duke mos u larguar nga Kosova për asnjë çast edhe gjatë flakëve të luftës. Adem Demaçi për punën e tij pati respekt nga bota demokratike, gjë

> **Perëndia ia fali Kosovës Adem Demaçin kaqë vital e mendjehollë, shkrimtar, patriot e aktivist i shquar, sypatrembur, i palodhshëm, i sinqertë dhe i pakursyer me rrezatim kosovar e mbarëshqiptar. Për fat të keq ne nuk e çmuam dhe respektuam sa e meriton dhe nuk ia dhamë mundësinë e plotë që të kontribuojë sa duhet për Kosovën e shqiptarinë.**

që u dëshmua me marrjen e Çmimit "Saharov" në vitin 1991 për lirinë e mendimit, Çmimin për të drejtat e njeriut në Universitetin e Oslos në vitin 1995 dhe Urdhërin "Hero i Kosovës" në vitin 2010.

Perëndia ia fali Kosovës Adem Demaçin kaqë vital e mendjehollë, shkrimtar, patriot e aktivist i shquar, sypatrembur, i palodhshëm, i sinqertë dhe i pakursyer me rrezatim kosovar e mbarëshqiptar. Për fat të keq ne nuk e çmuam dhe respektuam sa e meriton dhe nuk ia dhamë mundësinë e plotë që të kontribuojë sa duhet për Kosovën e shqiptarinë.

Adem Demaçi gjer më sot shërbeu si idol dhe nxiti shumë gjenerata që të jenë të guximshme në kërkimin e të drejtave të shqiptarëve. Ai do të mbetet gjithnjë shembëlltyrë e ndritur patriotike.

Është mëkatë dhe gabim i madh që Adem Demaçit, këtij heroi të gjallë të Kosovës, të mos i mundësohet një mjekim adekuat dhe cilësor në botën e jashtme.

Besoj se ky tekst do të trokas në ndërgjegjen e lidershipit kosovar që të reflektojë dhe që Adem Demaçi sa më parë të dërgohet për mjekim jashtë shtetit.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 22 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Protestoj kundër "natës së thikave"

Nga
Haki YMERI-Bina

Ubë nami, krisi belaja. Filluan protestat edhe aty ku nuk e kanë vendin, për të shqetësuar njerëzit e pafajshëm edhe nëpër shtëpitë e tyre. Nëse nuk intervenohet me kohë, për ta ndaluar forcën e tyre, situata mund të eskalojë për të arrirë "nata e thikave", ajo që kërkohej natën e numërimit të votave.

Protestoj kundër një veprimi të këtillë johuman. Vallë mund të protëstohet vend e pavend, në mënyrë të paligjshme, pa i informuar organet kompetente, por veprohet vetëm me "aminin" e krerëve të një partie e cila e ka humbur torruon pas humbjes së qeverisë së tyre? Habitem pse me kaq "zehër" në zemër hidhen këta njerëz, pa të drejtë, mbi "kundërshtarë" të tyre partiakë e jo partiakë, me të cilët jetojnë në një shtet, në një qytet, në një lagje, ndoshta edhe në një pallatë të përbashkët? Ku do të na çojë kjo mënyrë e mbrapshtë e bashkëjetësës me njerëz me të cilët duhet ndarë e mira edhe e keqja? Protestat bëhen në vende të caktuara, para institucioneve qeveritare, e jo para shtëpive të qytetarëve. Me çfarë të drejte e bëni këtë, ju or protestues? Çfarë faji kanë fëmijët e tyre, ato krijesa të perëndisë që i frikësoni me britma, më falni, shtazarake? Pse i trishtoni dhe i traumatizoni ata? Lërëni të zhvillohen dhe të rriten rehat e të qetë e, të bëhen qytetarë të edukuar e të arsimuar, të bëhen ndërtues të vyer të një Maqedonie me karakteristika europiane. Po çfarë faji paskan shqiptarët, të cilëve ua kërkoni vdekjen? Si mund t`iu gëzojë e t`iu kënaqë dhembja, mbase edhe ma keq, vdekja e tyre? Çfarë gëzimi e lehtësimi shpirtëror përjetoni duke kërkuar plotësim të dëshirave të këtilla johumane? Këto anatema ua drejtoni të gjithë shqiptarëve, pa dallin se ku janë ata, kohë e pa kohë, e vend e pavend. Paramendoni edhe kur luan ekipi sportiv pa asnjë shqiptarë në ekipin kundërshtar, anatemohen shqiptarët, të cilët i quani indijanë, ashtu siç i quante edhe Ministresha e Brendshme e dikurshme e partisë suaj që ende ju drejton, kujt t`ia kërkoni vdekjen. Po, po ajo, e cila pa dalë në gjyq shqiptarët i bënte vrasës të fëmijëve, për t`i dënuar më vonë me dënim të përjetshëm. Ju lutem lirohuni nga këta njerëz të ligë, lirohuni nga këta shpitkëqinj që e kanë zakon "ta bëjnë kopilin e ta lënë para derës".

SHQIPTARËT, DINJITOZË NË PROTESTA

Shqiptarët, zotëri të nderuar, janë vetëdijësuar. Ata po i mbrojnë të drejtat e tyre, por në mënyrë institucionale, ashtu si ka hije. Jo me dhunë. Në çdo protestë që e kanë bërë, gjithmonë kanë qenë dinjitoz. E duan atë që u është premtuar në vitin 2001 me Marrëveshjen e Ohrit. Më në fund fletojeni pak këtë marrëveshje dhe shikoni se ç`shkruan në të dhe cilët janë nënshkruesit e saj. Me 2001 këtë marrëveshje e nënshkruan dy anëtarë të partisë suaj, në krye me kryetarin e atëhershëm të shtetit, përndryshe anëtar i partisë suaj. Shtatë vjet më vonë, më vitin 2008, parlamenti i Republikës së Maqedonisë, me 75 deputetë, shumicë parlamentare të partisë suaj, votoi "Ligjin për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin më së paku 20% të qytetarëve të Maqedonisë të kenë të drejtë ta përdorin gjuhën e tyre në Parlamentin e R. së Maqedonisë dhe në të gjitha njësitë lokale të vetëqeverisjes". Ndryshime të konsiderueshme, në favor të përparimit të këtij ligji, u bënë edhe në vitin 2011. Këto ndryshime i pranuan edhe i votuan parlamentarët e partisë suaj në pushtet me BDI-në, ndërsa në vitin 2015 u përgatit edhe një dokument i veçantë dhe më gjithëpërfshirës për përdorimin e gjuhëve të popullatës që e flasin gjuhën e tyre më së paku 20% të popullatës së tërë në territorin e R. së Maqedonisë... "Gabimin" , nëse mund të quhet kështu, mos e kërkoni te shqiptarët, por te këta njerëz, nënshkrues të këtyre ligjeve, nëse ata janë fajtorë, bashkë me Kryetarin e shtetit, Gjorgje Ivanov, poashtu pjesëmarës në aprovimin e të gjitha këtyre ligjeve, të cilët partia juaj dhe BDI-ja, në 11 vjetët e qeverisjes së tyre në koalicion, i përgatiti dhe i solli...

MAQEDONASIT KANË NEVOJË TA PERFEKSIONOJNË GJUHËN E TYRE

Shqiptarët e R.së Maqedonisë, duan ta flasin gjuhën e tyre më me rehati, ata duan të komunikojnë pak "më lehtë me shtetin e tyre", për ta ndier veten më të afërt me këtë shtet. Po, ky shqiptar që i takon asaj bashkësie ku janë 20% në numër, do të komunikojë me organet e këtij shteti të tij në gjuhën shqipe, e jo me maqedonin e rëndomtë. Në këtë mënyrë forcohet një dashuri reciproke me shtetin e përbashkët. Unë nuk e kuptoj pse kjo kërkesë e tyre ju frikëson dhe ju tmerron kaq shumë? Nuk e di pse kjo kërkesë e rrezikuaka gjuhën maqedonase? Ju garantoj se gjuha shqipe nuk e dëmton në asnjë mënyrë maqedonishten, e as kjo shqipen. Janë gjuhë të veçanta në këtë truall të Ballkanit që u zhvilluan me shekuj në kontakt, që shihet sheshit në krijimin e më shumë ballkanizmave në këto dy gjuhë sesa në gjuhët e tjera të Ballkanit. Maqedonishtja është gjuhë e përpunuar me qindra vjet nga populli i saj. Gjuha letrare u standardizua pas çlirimit, krahas formimit të shtetësisë maqedonase, me sistem gramatikor shumë më praktik se shumica e gjuhëve të tjera sllave, po edhe se shqipja. Ajo me analitizmin e saj të shprehur në sistemin rasor të emrit dhe konjugacionin e foljes prinë para të gjitha gjuhëve të tjera sllave më të vjetra (me sintetizim më të komplikuar), pavarësisht asaj se këto gjuhë kishin mundësi të përpunohen shumë më tepër në aspekt institucional. Nuk e di se a ju pëlqen kjo që po ua them ju, që anatemonit edhe viganin Bllazhe Koneski, që vuri themelet e standardit të kësaj gjuhe. Ju e përbuznit ate duke e quajtur xhuxhmaxhuxh të Nebregovës. Ju lutem, mos derdhni lot krokodili, sepse ua di dhembjen ku e keni, e jo te mbrojtja e gjuhës maqedonase.

Ju, protestues të partisë së VMRO-së, mos u merrni me shqipen, mos u hidhëroni me ne shqiptarët, ju lutem punoni në perfeksionimin e gjuhës suaj, shqipja nuk e pengon në asnjë mënyrë përparimin e gjuhës maqedonase. Nuk ju detyron askush ta mësoni shqipen, nëse nuk keni nevojë dhe nuk doni ta bëni atë. Ne rregullisht do ta mësojmë maqedonishten sepse për te kemi nevojë. Ali Ahmetit mos ia zini për "kusur", meqenëse zotëriu as shqipen nuk e zotëron si duhet.

ANEKDOTA E OPINGAVE NË XHAMI

Për ta mbështetur ate se vetëm nevoja dhe dëshira e detyron njeriun ta mësojë një gjuhë, do t`ua tregoj një anekdotë të kohës sime si profesor në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe në Fakultetin filologjik "Bllazhe Koneski" në Shkup.

> **Kohën e fundit po ndodh edhe një e papritur. Një palë maqedonas anatemon palën tjetër, duke i quajtur "tradhëtarë". Kështu mendon ky grup patriotësh të rrejshëm, pjesëtarë të partisë së "VMRO-DPMNE" për bashkëkombasit e tyre, pjesëtarë të partisë "SDSM", të cilët në parlamentin e R. së Maqedonisë, në koalicion me grupin parlamentar të BDI-së, votuan "Ligjin për përdorimin e gjuhëve që flitenin më së paku nga 20% të qytetarëve të Maqedonisë...".**

Më angazhuan të mbajë një kurs 60 orësh të gjuhës së sotme shqipe për studentët e katedrave të tjera që kishin shprehur dëshirë ta mësonin shqipen si gjuhë ballkanike, normalisht aq sa mundej dhe preferohej me program. Pranova ta bëj këtë me kënaqësi, edhe pse nuk isha profesionist i gjuhës së sotme shqipe. Unë ushtroja Dialektologjinë dhe Historinë e gjuhës shqipe. U lajmëruan mjaft studentë, por jo edhe aq sa kisha dëshirë t`i kisha në sallë të mësimit. Pasi dëgjuan të tjerët premtimin që u kisha dhënë dëgjuesve të këtij kursi për t`i lëshuar të gjithë në provim, vetëm nëse do të më ishin të rregullt në 60 orë mësimi, ndërsa pjesën tjetër që do të donin të mësojnë, siç ka hije, do ta vlerësoj normalisht, nga nota 7 e gjer më notën 10, në orën e dytë m`u mbush salla edhe me studentë të tjerë. Me këtë gjest arrita atë që doja. Qëllimi im ishte të kem sa më tepër studentë në sallë. Premtimin e mbajta, normalisht, vetëm ndaj studentëve të rregullt. Të parregulltit as që tentuan ta kërkojnë atë që nuk e meritonin. Ndër më të mirët ishin studentët e grupit të anglishtes. Një studente e këtij grupi që u vlerësua me notën 10, e entusiasmuar dhe me gaz në buzë, më pyeti: -Profesor i nderuar, pse vepruat kështu?
– Për t`iu përgjigjur sa më konkretisht pyetjes suaj, do t`ua tregoj ju kolege e nderuar dhe kolegëve të tjerë një anekdotë të kohës së islamizimit të shqiptarëve. Në këtë moment isha i sigurtë se një pjesë e studentëve maqedonas nuk e dinin se shqiptarët e islamizuar para 3-4 shekujve ishin të krishterë, prandaj pasi ua sqarova këtë, vazhdova tua tregoj anekdotën: -Një ditë i angazhuari kryesor i proçesit të islamizimit e pyet njërin prej përgjegjësve të kësaj pune në një fshat, se si shkon puna me islamizimin. Ky, i nënshtruari, duke dashur të arsyetohet, pak si me frikë dhe me faj, përgjigjet: - puna shkon disi, mirëpo fshatarët hezitojnë t`i zbathin opingat për të hyrë në xhami. - I angazhuari kryesor për islamizim, pa menduar mirë, i tha:- Lëshoi le të futen me opinga.- Si po e shihni, kolegë të nderuar, edhe unë, sa për fillim, kam vendosur të bëj kësosh lëshimesh. Një pjesë e madhe e studentëve e kuptoi punën se edhe unë kisha vendosur të bëj lëshime, të një lloji të përafërt me lëshimin e sapo të islamizuarëve në xhami, me një qëllim të vetëm, të kem sa më tepër studentë në sallë të mësimit, duke e ditur mentalitetin dhe paragjykimet e studentit maqedonas ndaj mësimit të shqipes. Të nderuar protestues, e di se duhet mjaft kohë për t`u shëruar nga ky kompleks, qetësohuni dhe hiqni paragjykimet që i keni ndaj shqiptarëve dhe gjuhës së tyre, ju lutem të keni besim më tepër te ne shqiptarët dhe te kryetari i qeverisë Zoran Zaev. Ky i cili rregulloi familjen e tij, rregulloi edhe një qytet të tërë, ky që udhëhoqi një komunë e cila prinë në shtetin tonë dhe më gjerë me punë dhe me jetë të rregullt në të. Vetëm njerëzit punëtorë si ky mund ta rregullojnë edhe nje shtet, nuk do të na gënjejë. Ky është njeriu më i ndershëm dhe më trimi mbi shumë trima në këtë Maqedoni. Ai mund të gabojë, ai mund edhe të dështojë, por dijeni se fajin do ta kemi ne, nëse nuk e përkrahim. Me shkop magjik nuk rregullohet ky shtet. Ky shtet do punëtorë, njerëz të ditur, të vyeshëm dhe të ndershëm, e jo të papunë e hajna.. Të fala Ju bën një mësues i pensionuar që këto ditë mbushi 81 vjet.

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Varfëria, mungesa e perspektivës, gjakmarrja apo dhuna në familje shtyjnë edhe të mitur nga Shqipëria të vijnë për të kërkuar azil në Gjermani

REFUGJATËT E MITUR SHQIPTARË NË GJERMANI

Kur erdhi në Gjermani Endriti nuk dinte çfarë e priste. I ungji e mori me vete, pasi u kthye nga pushimet e verës për në Angli. Në Angli tha ai, janë bërë shumë. 405 minorenë shqiptarë kërkuan vitin 2015 azil në Mbretërinë e Bashkuar. Prandaj më mirë provoje në Gjermani. Një shok i xhaxhait i priti në Berlin dhe i mbajti dy ditë. Ai u tregoi adresën ku e qendrës për grumbullimin e të miturve të braktisur në Berlin. Dorëzoi aty pasaportën dhe certifikatën e lindjes. E morën në pyetje disa herë, herë me përkthyes dhe herë pa përkthyes. Historia që tregoi ishte ajo e dhunës në familjen e tij. Të ardhura të pakta, babai alkoolik, nëna e sëmurë, mungesë perspektive. Historia nuk ishte e stisur, ranë dakord ekspertët. Muajin e parë qëndroi në një kamp, në një dhomë me djem të moshës së tij. Pjesa më e madhe nga vendet arabe. Kishte edhe një nga Shqipëria. U bënë shok, po dikur morën "transferën" siç quhet në zhargon, për të shkuar në vendin për qëndrim afatgjatë, kështu që u ndanë.

Një organizatë që merrej me menaxhimin e minorenëve të pashoqëruar, siç quhet në gjuhën administrative, mori përsipër kujdesin për të. E çuan të bënte kontrollin shëndetësor. Zyra për të Rinjtë pranoi kërkesën për t'i dhënë ndihmë nga "ndihma për të rinjtë". I vendosën një kujdestar për çështjet ligjore dhe çuan në shkollë. Fillimisht në një klasë me të huaj për të ndjekur kurset që ofrohen për fëmijët e huaj që të mësojnë gjuhën gjermane dhe të marrin informacionet e para për jetën në Gjermani. Mbas mbarimit me sukses të klasës, Endritin e futën në një shkollë profesionale për kopshtar. Praktikën e bën në një kopshtari në rrethinat e qytetit. Ndërkohë ka mbushur moshën madhore. Tani mund të bëjë zyrtarisht kërkesë për azil, po shoqatat pro-refugjatëve në Berlin e kanë këshilluar të mos e bëjë. Të gjithë aktorët që u morën me administrimin e jetës së tij në Berlin, e ndihmuan me dëshirë dhe bënë ç'është e mundur për t'i ofruar në perspektivë të ardhmeje këtij të riu nga Shqipëria.

JO TË GJITHA HISTORITË PËRFUNDOJNË ME "HAPPY END"

Zyrat e UNHCR-it dhe kanë mjaft histori të tilla për të treguar. Kështu në vitin 2015 kërkuan strehim në Gjermani 257 minorenë të pashoqëruar shqiptarë. Një vit më vonë numri ra në më pak se gjysmën në 110, dhe në vitin 2017 numri i minorenëve që kërkuan strehim në Gjermani ra në 53. Mes tyre ka pasur të rinj që janë larguar prej gjakmarrjes, dhunës në familje, por edhe varfërisë dhe mungesës së perspektivës. Një pjesë janë larguar me dijeninë e prindërve, të tjerë thjesht kanë ikur nga shtëpia dhe nga vendi.

Jo të gjitha historitë kanë qenë me "happy end". "Sado që u munduam, njëri prej të rinjve përfundoi në burg. Të rriturit kriminelë e përdornin për të kryer punë, deri sa ra

Të ngecur në itinerarin e Ballkanit

Salimi u largua para tetë muajsh nga Alepo. Mijëra kilometra rrugë përmes Turqisë, Greqisë, Shqipërisë, Malit të Zi. Dëshira e tij është të vijë në Gjermani, por tani ai ka ngecur në Bosnje. Një mëngjes bashkë me shokun e tij ata u larguan nga Sarajeva. 40 kilometra në këmbë nëpër malet me borë për të mbërritur në Delijass. "Ishim në një qendër azili, por ata nuk kishin vend, dhe asgjë për të ngrënë". Drejtori i qendrës kishte thënë se ajo ishte e mbushur, rrëfen Salimi. Të dy marrin pastaj rrugën e kthimit pa e ditur, se ku do flenë. Historia e Salimit nuk është rast i veçuar. Në muajt e fundit numri i migrantëve në Bosnje-Hercegovinë është rritur ndjeshëm. Nëse më parë refugjatët kërkonin përmes Maqedonisë dhe Serbisë të arrinin Europën Perëndimore, tani shumë prej tyre përdorin pjesën perëndimore të itinerarit të Ballkanit. Por edhe këtu rruga për në Kroaci është e bllokuar. Shumë prej tyre mbesin pastaj në Bosnje.

Më 18 Mars hyri në fuqi marrëveshja për refugjatët mes BE e Turqisë, që solli mbylljen e itinerarit të Ballkanit. Shumë vetë kanë ngecur në stacionet e tij. Refugjatët kërkojnë të hyjnë tani në Europë nga Bosnja

SITUATA NËN KONTROLL?

Dragan Mektiq, ministri për Sigurinë në Bosnje-Hercegovinë thekson se "situata nuk është alarmuese" dhe se "autoritetet e Bosnje-Hercegovinës e kanë procesin gjithmonë nën kontroll". Megjithatë ka shumë vështirësi në furnizimin e refugjatëve dhe probleme në sigurimin e kufijve. Strukturat e sigurisë kanë nevojë për më shumë personel dhe më shumë mjete financiare. "Vetëm në policinë kufitare çdo i pesti vend pune është bosh. Kemi nevojë për 500 njerëz më shumë për të mbrojtur kufirin", thotë Mektiq. Një plan aksioni, i miratuar në fillim të krizës nuk është zbatuar ende. Sipas të dhënave të policisë kufitare nga 1 Janari deri në 11 Mars janë ndaluar 639 persona "në përpjekje për të kaluar ilegalisht kufirin apo menjëherë pas kësaj". Një rritje e ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar. Shumica e migrantëve janë sirianë, të ndjekur nga pakistanezët, libianët dhe afganët.

MUNGON BASHKËPUNIMI ME FQINJËT

Duke përmendur se policia kufitare e Bosnje-Hercegovniës është përgjegjëse për mbrojtjen e 1000 kilometrave të kufirit të jashtëm me BE, ministri Mektiq kërkon që vendet e Ballkanit t'i zgjidhin bashkë problemet. Ai kritikon faktin, se jo të gjithë e respektojnë marrëveshjen e ripranimit, por "i dërgojnë migrantët thjesht tek fqinjët". Mektiq synon një aktivizim më të madh të policisë kufitare të BE, Frontex në kufijtë e Bosnje-Hercegovinës. Një problem i njohur edhe për Komisarin e Lartë të OKB-së për refugjatët, UNHCR. "Kjo është siguristh një sfidë shumë e madhe për institucionet shtetërore të Bosnje-Hercegovinës", thotë për Deutsche Wellen, Neven Crvenkoviq,

në rrjetin e policisë. Një tjetër nuk ishte në gjendje të vazhdonte shkollën, kështu që kur arriti moshën madhore e kthyen në Shqipëri. Një tjetër, u kthye vetë sepse nuk duronte dot pa rrjetin social familjar. Viti 2015 dhe 2016 ka qenë shumë i vështirë për gjithë punonjësit socialë që janë kujdesur për të huajt", thotë Vilma, një punonjëse e organizatës AWO-s. "Nuk kishim mundësi t'i jepnim kohën e duhur për t'u trajtuar çdo rasti, për shkak të fluksit të madh". Atë vit që Endriti erdhi në Gjemani, azil kërkuan 36 mijë minorenë të pashoqëruar.

SHIFRAT MUNGOJNË

Sa prej minorenëve janë kthyer në Shqipëri dhe sa kanë qëndruar, nuk dihet me saktësi. Zyra e BAMF, Entit Federal Gjerman për Migracionin i tha Deutsche Welles se "ne nuk mbledhim të dhëna duke ndjekur si vazhdon historia e këtyre personave". Lioba Hebauer shpjegon se "për ata që janë kthyer ekzistojnë vetëm shifrat e të dëbuarve, ose të atyre që janë nxitur për t' u larguar. Në vitin 2015 numri i të rinjve që u dëbuan prej autoriteteve ka qenë 45, në vitin 2016 ka qenë 31 dhe në vitin 2017 numri i të kthyerve ka qenë 32". Në këto shifra flitet vetëm për të rinjtë që kanë kërkuar azil me arritjen e moshës madhore, dhe BAMF-i u ka refuzuar kërkesën. Për rastet e tjera, si ajo e Endritit, vendosin zyrat e të huajve të qendrave të banimit, nëse një i ri e merr apo jo lejen e qëndrimit, dhe me çfarë arsye e merr, mbrojtje minorenësh apo ndjekja e arsimit profesional.

zëdhënës i UNHCR-së për Europën Juglindore.

Nixhara Ahmetaseviq, gazetare dhe aktiviste në Sarajevë ka punuar disa vite me organizatën "Are you Syrious". Pa dyshim që Bosnje-Hercegovina është bërë ndërkohë një pjesë e itinerarit të Ballkanit, por në masë më të vogël se Serbia", thotë Ahmetaseviq për DW. "Nga nëntori i kaluar kanë ardhur më shumë vetë në Bosnje-Hercegovinë. Shumica vendosën për rrugën nga BH, sepse policia kroate e kufirit vepron brutalisht kundër migrantëve që duan të hyjnë në BE", thotë Ahmetaseviq. Një ngjarje tragjike ishte vdekja e 6-vjeçares Madine Hussinay që u shtyp nga treni, pas familja e saj u detyrua nga policia kroate të kthehet në Serbi. "Kjo përhapet. Njerëzit e dinë, se nuk mund të kalosh dot më përmes Serbisë dhe Kroacisë dhe itinerari është zhvendosur në Bosnje-Hercegovinë".

NË KËRKIM TË FATIT

Në Bosnje autoritetet presin që fluksi i migrantëve në këtë vend të rritet me përmirësimin e motit. Ministri Dragan Mektiq është i bindur, se shumica nuk duan të qëndrojnë, por të vazhdojnë për në Europën Perëndimore. Kjo është arsyeja që edhe Salimi dhe miku i tij përpiqen të mbijetojnë ditët e ftohta. Sapo të ngrohet koha ata kanë një qëllim – të vazhdojnë drejt veriut të Europës. Ëndrra e Salimit: Të vijë në Gjermani, ku jeton një kushëri i tij dhe të fillojë të punojë si mekatronik. *(DW)*

PËRMENDORE PËR MILLOSHEVIQIN NË SERBI?

Luftëra, sanksione, superinflacion: Këto i kujtojnë shumë serbë kur bie fjala për periudhën kur president ishte Sllobodan Millosheviq. E megjithatë merr jetë një iniciativë për të ngritur një përmendore për autokratin

"Nën hijen e blirit" prehet ai, ish-presidenti i Serbisë, Sllobodan Millosheviq. Në vitin 2006 ai ndërroi jetë në një qeli të Tribunalit të Hagës, ku duhej të përgjigjej për krime të rënda dhe gjenocid në luftërat e Jugosllavisë në vitet 90-të. Varrimi në "shëtitoren e të nderuarve të kombit" në varrezat e Beogradit as nuk shtrohej për diskutim. Kështu arkivoli me kufomën e Millosheviçit u vendos në oborrin e shtëpisë së tij në qytetin e lindjes, Pozharevc, 80 kilometra nga Beogradi. Nën një bli, në një oborr të pasmë. Kritikët e tij thonë, ai nuk ka merituar një varr më të mirë.

Si kreu i Partisë Socialiste të Serbisë, SPS, një parti pasuese e komunistëve, Millosheviqi drejtoi fatin e Jugosllavisë, që në fund përbëhej vetëm nga Serbia dhe Mali i Zi. Deri më sot vitet 90-të në Serbi janë një nocion që përmbledh luftëra, flukse refugjatësh, likuidim të kundërshtarëve politikë e gazetarëve, sanksione, superinflacion dhe varfëri. Ato morën fund në tetor të vitit 2000, kur Millosheviqi u detyrua pas protestave masive të pranonte humbjen në zgjedhje kundër opozitës demokratike. Çfarë duhet të ketë ndodhur pas kësaj në Serbi, që sot vitet 90-të romantizohen dhe ideja për të ngritur në Beograd një përmendore për Millosheviqin si dhe t'i jepet emri i tij një rruge kanë gjetur mjaft përkrahës, madje edhe njerëz të njohur?

"LUFTËTAR PËR SERBIZMIN"

"Millosheviq ka qenë hero i kohës së tij, ai e mbrojti vendin, kur ranë bombat e NATO-s", thotë Jovana Dimitrijeviq duke kujtuar bombardimet e vitit 1999 me qindra viktima në Serbi. E reja drejton shoqatën e qarkut të partisë bashkëqeverisëse, SPS në Pozharevc dhe ka nënshkruar iniciativën për ngritjen e përmendores së Millosheviqit. "Ajo është detyrim moral i qytetarëve kundrejt këtij njeriu të pafajshëm, luftëtarit të serbizmit".

Kërkesa i është drejtuar bashkisë së Beogradit dhe presidentit Vuçiç që e kontrollon me dorë të fortë Serbinë, mediat dhe drejtësinë, por që jashtë vendit paraqet europianin e bindur. Në vitet 90-të Aleksander Vuçiq ishte një skifter nacionalist, ministër i Informacionit nën Millosheviqin. Partnerët e koalicionit të qeverisë serbe janë socialistët, që angazhohen për një përmendore për Millosheviqin.

VËRTET NJË PËRMENDORE PËR MILLOSHEVICIN NË BEOGRAD?

"Çdo përmendore është ndërhyrje në hapësirën publike dhe rrëfen se kush qeveris për momentin", thotë Eric Gordy nga University College në Londër në bisedë me DW. Momenti i zgjedhur tani tregon, se shumë njerëz në Serbi janë të zhgënjyer nga problemet e tranzicionit politik.

NJË VEND NË KRIZË TË VAZHDUESHME

Arsye për këtë ka. Papunësia në vend arrin rreth 30%. Katër të pestat e të punësuarve fitojnë më pak se 400 euro në muaj. Pas rënies së Millosheviçit pritshmëritë ishin shumë më të larta. "Shoqërinë demokratike, progresin ekonomik, integrimin në BE njerëzit nuk e morën. Prandaj në vitet e fundit po bëhet më e dukshme nostalgjia për Millosheviqin", shpjegon Gordy.

Në këtë kontekst nuk të habit që pati premierë "Shou i Sllobodanit", një muzikal me figurën e Millosheviçit si protagonist kryesor. Para tre vitesh gruaja e autokratit, Mirjana Markoviç botoi një libër me titullin "Ka qenë kështu". Një libër plot me "fakte alternative", por që në Serbi pati sukses. Në vitin 2003 Markoviq gjeti strehë në Rusi, sepse në Beograd kërcënohej nga procesi gjyqësor nën akuzën e vrasjes së kundërshtarit politik. Ky zhvillim nxitet edhe nga qeveritarët dhe mediat bulevardeske.

JO PËRBALLJE E VËRTETË ME TË SHKUARËN

Bojan Gjuriq, kryeredaktor i portalit liberal, "Novi pogledi" është i bindur, se nuk do të vijë puna deri tek ngritja e një përmendoreje për Millosheviçin. "Për një pjesë të popullsisë dhe elitën politike Millosheviçi është një paralajmërim. Kështu marrin fund ata që nuk dinë se, kur vjen momenti për të ndalur. Politika e tij nuk mund të rehabilitohet, sepse Serbia sot është një tjetër vend, bota është tjetër."Në Serbi nuk ka pasur ndonjë përballje serioze me krimet dhe traumën e viteve 90-të. Tribunali i Hagës që përfundoi punën në vitin 2017 u pa si një e keqe që duhej pranuar. Ish-të burgosurit e Hagës po rikthehen në jetën publike.

Lidhur me përmendoren e Millosheviqit mbetet ta thotë fjalën presidenti Vuçiq. Ai nuk është prononcuar deri më tani, por pritet që ai ta lërë të zbehet iniciativa. Në fund të fundit presidenti serb tani po përpiqet kaq shumë që të hapë rrugën e Serbisë në BE, përmes normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. Por nëse një ditë do ngrihej një përmendore për Millosheviqin, atëherë komuniteti serb i Twitterit ka shumë ide: Mund të jetë një mal me kafka për shembull apo një bankënotë 500 miliardë dinarëshe, që kujton superinflacionin.

Një person shkruan në Twitter: "Një banjo publike duhet gjithmonë". *(DW)*

KUSHTET PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Jo vetëm demarkacioni

Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka sqaruar të gjitha procedurat dhe afatet për liberalizimin e vizave pas miratimit të Demarkacionit Sipas tij, tash gjithçka është në dorën e Komisionit, Parlamentit dhe Këshillit të BE-së. Në një status të shkruar në FB, Murati ka sqaruar të gjitha procedurat që duhet t'i kalojë Kosova për liberalizim të vizave. "Vizat nuk janë liberalizuar ende. Me ratifikimin e Demarkacionit, Kosova ka përmbushur një nga dy kushtet e mbetura. Mbetet për t'u parë vlerësimi i BE-së rreth progresit që Kosova ka bërë në luftimin e korrupsionit e krimit. Proceduralisht, për liberalizim të vizave, në BE rol luajnë tre akterë kryesorë: Komisioni, Parlamenti dhe Këshilli. Fillimisht, Komisioni e bën vlerësimin se janë plotësuar të gjitha kushtet për liberalizim. Pastaj, Parlamenti Evropian mandatohet nga Komisioni Parlamentar kompetent (LIBE - Komisioni për të drejta civile, drejtësi dhe punë të brendshme). Më pas, Këshilli miraton pozicionin negociues, që i hapë rrugë trialogut mes Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit, ku dakordohet për përmbajtjen e tekstit i cili më pas hidhet në votim. Pas dakordimit të tekstit, propozimi për liberalizim hidhet në votim në seancë plenare në Parlament, ku nevojitet shumica e kualifikuar. Në të njëjtën kohë, edhe Këshilli duhet ta votojë propozimin, me shumicë të kualifikuar (55% e vendeve të BE-së që përfaqësojnë 65% të popullsisë).

E tërë kjo procedurë mund të zgjasë 6 deri në 9 muaj. Nëse vlerësohet se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret, liberalizimi mund të na vijë më së afërmi në vjeshtën e vonë", shkruan Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

LËVIZJET GJYSMË SEKRETE TË HASHIM THAÇIT

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, udhëtim të cilin e ka mbajtur të fshehtë tash e sa ditë. Para pak ditësh u bë e ditur se edhe Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka udhëtuar drejt SHBA-së, pa e njoftuar vizitën

Partitë opozitare në Beograd e kanë akuzuar Vuçiqin se është përfshirë në negociata sekrete me Hashim Thaçin, fillimisht në Paris e më pas edhe në SHBA, shkruan gazeta Expres. Pak ditë më parë gazeta prestigjioze austriake "Der Standard" njoftoi se dy presidentët ishin përfshirë në bisedime për ndarjen e Kosovës, por që ky opsion ishte ndaluar pas intervenimit të Berlinit.

Fillimisht Thaçi kishte udhëtuar drejt Londrës ku kishte promovuar librin e tij të botuar së voni. Më pas kishte udhëtuar drejt Parisit ku po ashtu e kishte promovuar librin dhe kishte dekoruar ish-Presidentin Sarkozy dhe ish-ministrin e Jashtëm Bernard Kouchner. Pas Parisit, Presidenti nuk ka bërë asgjë publike për aktivitetin e tij.

Në Serbi, ish-ministri i Jashtëm, Vuk Jeremiq, ka akuzuar Vuçiqin se ka pasur darkë të fshehtë me Thaçin para se ky i fundit ta takonte Presidentin Macron. Jeremiq më pas ka njoftuar se Vuçiqi ka udhëtuar drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'i vazhduar negociatat sekrete me Thaçin dhe duke e provokuar atë "A jeni në hotelin e njëjtë".

Gazeta Express merr vesh se Thaçi tash e sa ditë është duke qëndruar në SHBA. Mediet serbe duke u thirrur në burime, kanë njoftuar se Presidenti i Serbisë ka pasur takime me zyrtarë të Administratës së SHBA-së duke e quajtur këtë ofensivë diplomatike të tij për çështjen e Kosovës. Por këtu nuk përfundon historia e Thaçit me Vuçiqin.

Ata të premten do të jenë në Bruksel, ku janë ftuar nga Mogherini për bisedime të nivelit të lartë që kanë të bëjnë me definimin e formatit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Gjatë fundjavës gazeta vjeneze „Der Standard", ka shkruar rreth bisedimeve për ndarjen e Kosovës. Sipas kësaj të përditshmeje gjermanët kanë parandaluar ndarjen e Kosovës, të cilën e kanë favorizuar serbët, por edhe pala kosovare për shkak të lodhjes me çështjen e veriut. Kjo, sipas diplomatëve, edhe ka bërë që të ndërhyjë Berlini. Por, një zyrtar, në kushte anonimiteti i ka thënë gazetës austriake, se ka frikë se Thaçi dhe Vuçiqi mund të flasin në kanale tjera rreth ndarjes së Kosovës, transmeton gazeta KOHA.

AKS është maksimumi që Serbia mund të fitojë në Kosovë

SHBA, Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe Serbisë i kanë thënë qartë që të mos mendojë për asnjë pjesë të Kosovës dhe se formalisht ose jo formalisht Beogradi duhet ta njohë pavarësinë e saj. Këtë ofertë, siç shkruan sot "Veçernje Novosti", kryetari i Serbisë Aleksandar Vuçiq, e ka marrë nga diplomatë në Berlin, Paris, Londër e Washington, ndërsa i është konfirmuar këtyre ditëve edhe gjatë qëndrimit në New York në takimet joformale me diplomatë, transmeton Koha.net.

Bashkëbiseduesit e këtyre qendrave që vendosin, pa dorëza diplomatike i kanë thënë Vuçiqit se Asociacioni i komunave serbe është maksimumi që Serbia mund të fitojë në Kosovë.

Zyrtarë perëndimorë i kanë thënë kryetarit serb se Kosova për ta është tregim i përfunduar.

Nga ana tjetër kryetari serb Vuçiq për situatën krijuar ka akuzuar pushtete e kaluar në Serbi dhe sidomos vendimin e Beogradit që shpallja e pavarësisë së Kosovës të shqyrtohet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Kjo Gjykatë në vitin 2011 kishte nxjerrë aktgjykimin në të cilin kishte thënë se shpallja pavarësie nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

LIBERALIZIMI I VIZAVE

Kosova ka ende punë për të bërë

Ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, ka uruar përfaqësuesit institucional të Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, por se sa i përket liberalizimit të vizave ka theksuar se ka ende punë për t'u bërë. Këto komente Heldt i ka bërë me rastin e nënshkrimit të Memorandum Mirëkuptimit në mes të Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive dhe Qeverisë së Gjermanisë, me ç'rast është lansuar "Agrodritarja", që ka për synim mbështetjen e sektorit të agrobiznesit.

ZUCKERBERG KËRKON FALJE PËR SKANDALIN CAMBRIDGE ANALYTICA



Cambridge Analytica ka aksesuar të dhënat e përdoruesve në Facebook për të krijuar profile të votuesve Amerikanë, të dhëna që më pas u përdoren për të ndihmuar Donald Trump të fitonte zgjedhjet

Shefi ekzekutiv i Facebook Mark Zuckerberg kërkoi falje për gabimet e bëra nga kompania e tij dhe mënyrën sesi ka shfrytëzuar të dhënat personal të 50 milion përdoruesve.

Ai premtoi të kufizonte aksesin e zhvilluesve në informacione të tilla. Rrjeti social me numrin më të madh të përdoruesve në botë është përballur me akuza autoritetet Evropiane dhe ato Amerikane pas zbulimit të skandalit Cambridge Analytica. Kjo organizatë ka aksesuar të dhënat e përdoruesve në Facebook për të krijuar profile të votuesve Amerikanë, të dhëna që më pas u përdoren për të ndihmuar Donald Trump të fitonte zgjedhjet. "Kjo ishte një goditje e rëndë për besueshmërinë e kompanisë. Më vjen shumë keq për këtë që ka ndodhur. Ne kemi përgjegjësinë më të lartë të mbrojmë të dhënat e përdoruesve," tha Zuckerberg në një intervistë për CNN.

Ai tha se rrjeti social do të realizojë një hetim për mijëra aplikacione që kanë përdorur platformën e Facebook dhe të kufizojë aksesin e zhvilluesve në këto informacione. Pjesë e planeve të tij nuk ishte reduktimi i aksesit të reklamuesve në këto të dhëna të cilët janë shumë jetikë për kompaninë.Zuckerberg gjithashtu tha se është i hapur për ndërhyrjen e autoriteteve dhe se do të ishte i lumtur të dëshmonte përballë Kongresit Amerikan.

Ndërkohë gazeta The Times, ngre akuza të rënda edhe ndaj firmës mëmë të Cambridge Analytica, SCL, Grupit Strategic Communication Laboratories. Kjo firmë punëson ekspertë, hakera, programues që punojnë në të gjithë botën për ndikim në zgjedhje apo manipulim të tensioneve politike. Kjo firmë ka një sfond ushtarak dhe me gjasë duket të ketë qenë aktive në Kenia, Karaibe, Libi, Pakistan dhe Indi. Të dyja firmat, SCL dhe Cambridge Analytica kanë qenë të angazhuara edhe nga qeveria britanike. Madje është ngritur edhe dyshimi, se ato kanë luajtur rol në fushatën për Brexit.

SUSPENDOHET DREJTORI I CAMBRIDGE ANALYTICA

Këshilli drejtues i kompanisë Cambridge Analytica deklaroi sot se ka suspenduar drejtorin gjeneral të firmës Alexander Nix derisa nuk të përfundojë hetimi i plotë dhe i pavarur për veprimet e tij.

"Komentet e Nix nuk janë as vlera e as operacionet e kompanisë, dhe pezullimi i tij pasqyron seriozitetin me të cilin e shikojmë këtë shkelje," thuhet në deklaratën e kompanisë, raporton Asociated Press. Cambridge Analytica" besohet se i përdori të dhënat e mbi 50 milionë përdoruesve të Facebook-ut për të krijuar njoftime të individualizuara, duke shenjëstruar votuesit amerikanë me mesazhe të caktuara. Të dhënat u analizuan pjesërisht me atë që njihet si "modeli psikologjik i personalitetit" në bazë të 5 tipareve, apo ndryshe "OCEAN V".

REAGON ASHPËR MINISTRJA GJERMANE

Ministrja e Drejtësisë së Gjermanisë reagoi sot mbi mega-skandalin e "Facebook". Ajo tha se kishte kërkuar të bisedonte nga afër me drejtuesit e rrjetit social për të mësuar nëse janë prekur apo jo 30 milionë gjermanë nga skandali i përdorimit të të dhënave personale. Katarina Barley tha se duhet të merret në konsideratë fakti nëse përdoruesit e mediave sociale janë të lumtur që përdoren të dhënat e tyre. "Kërkoj sqarime nëse përdoruesit gjermanë janë prekur, dhe çfarë plani ka 'Facebook' për të parandaluar përsëritjen e një ngjarje të tillë", tha ajo në një konferencë për mediat.

Juncker përfshihet nën hetim për nepotizëm dhe korrupsion

President i Këshillit Europian Jean Claude Juncker, emëroi dhe ngriti në detyrë ndihmësin kryesor të tij Martin Selmayr . Në mëngjes e emëroi zëvëndës sekretar të Përgjithshëm dhe në darkë e emëroi Sekretar të Përgjithshëm. E gjithë kjo ngjarje ka ndodhur brenda një ditë dhe kjo ka qenë arsyeja që janë ngjallur dyshime për nepotizëm dhe korrupsion.
Sipas Ballkanëeb Juncker e ka bërë gfakt të kryer këtë emërim pavarësisht se vetëm dy antarë të Ke-së kanë qenë në djeni të këtij vendimi. Avokati i Popullit të Bashkimit Europian ka nisur hetimet për këtë vendim.
Ky emërim i dyshimtë mund të paralizojë reformat në BE të cilat janë planifikuar të ndërmerren pas daljes së Britanisë nga bl-loku. Por deri më tani thuhet se tentativat për heqjen e Selmayr nga detyra janë të pamundura pasi ky vendim do të bllokohet nga Partia Europiane Popullore.

Daçiç: Beogradi mund të jetë vendtakim i Trumpit dhe Putinit

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç propozoi Beogradin si vendin e duhur për një takim të mundshëm mes presidentit amerikan, Donald Trump dhe homologut të tij rus, Vladimir Putin.
"Beogradi është absolutisht i përgatitur për të organizuar një takim të tillë të një rëndësie planetare", deklaroi Daçiç. "Si një vend ushtarakisht neutral, Serbia ka kapacitetet e politikës së jashtme për të mikpritur presidentët e SHBA-së dhe Rusisë", shtoi ai. Pak muaj më parë, në Beograd u takuan ambasadorët amerikan, Kurt Volker dhe ai rus, Vladislav Surkov, të cilët diskutuan për krizën ukrainase

Sarkozy: Hetimi i financimit nga Gadafi po ma bën jetën "ferr"

Ish-presidenti francez Nikolas Sarkozy thotë se akuzat që ai mori financimim për fushatë nga udhëheqësi libian Muamar Gadafi po e bëjnë jetën e tij "ferr". "Unë jam akuzuar pa asnjë provë fizike", tha Sarkozi para gjyqtarëve pasi ai u vu nën hetim, raporton gazeta franceze "Le Figaro".

Ai po hetohet për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore në vitin 2007, keqpërdorimin e fondeve publike libiane dhe korrupsionin pasiv.

Sarkozi, 63 vjeç, ka mohuar keqbërjen. Politikani i qendrës së djathtë, i cili u lirua të mërkurën pas dy ditësh të marrjes në pyetje, thotë se akuzat e tij libianë po kërkojnë hakmarrje për vendimin e tij për të vendosur fluturimet franceze gjatë kryengritjes që përmbysi Gaddafin në vitin 2011. Një nga ish ministrat e zotit Sarkozy dhe një aleat i ngushtë, Brice Hortefeux, thuhet gjithashtu se u pyetën nga policia të martën.

Të enjten, Le Figaro botoi atë që tha ishte deklarata e plotë e gjykatës e bërë nga Sarkozy tek hetuesit francezë.

Në të, ai thotë se ai është i vetëdijshëm se akuzat kundër tij janë "serioze", por ato përbëjnë "shpifje" dhe e kanë bërë jetën e tij "ferr" që nga 11 marsi 2011, kur kërkesat u bënë së pari nga Gadafi. "Unë kurrë nuk kam kërkuar të shmang detyrimet e mia në marrëdhëniet e mia me miqtë, kolegët dhe të gjithë njerëzit e përmendur në këto procedura," tha Sarkozi, duke shtuar: "Unë kurrë nuk kam kërkuar të ndikoj në deklaratat apo gjykimet e tyre".

Erdogan "më nën kontroll" gazetën Hürriyet

Grupi më i madh mediatik turk Dogan Holding, i cili është kritik ndaj Ankarasë zyrtare, ka shitur gazetën Hürriyet, CNN Turk dhe Kanal D te konglomerati proqeveritar.
Kjo mund të forcojë mbështetjen mediatike për presidentin Recep Tayyip Erdogan, shkruan New York Times. Përfaqësuesi i blerësit, Dmiroren Holding, ka konfirmuar blerjen për agjencinë Reuters, duke mos bërë të ditur shumën e transaksionit.
Themeluesi i Dogan Holding është Ajdin Dogan, pjesëtar i establishmentit sekular në Turqi, kompaninë e të cilit Erdogan disa herë e kishte kritikuar për shkak të sulmeve ndaj Partisë të Drejtësisë dhe Zhvillimit, e cila udhëheq me pushtetin.
/kp/Telegrafi/

PRIJËS I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE TË VITEVE TRIDHJETA TË SHEKULLIT TË KALUAR (1)

FERHAT BEJ DRAGA,

SHEMBULL I NJË PATRIOTI TË MADH

Burimet ushtarake, policore dhe diplomatike jugosllave hedhin dritë për një aktivitet të dendur të Ferhat bej Dragës e të bashkëpunëtorëve të tij midis harkut kohor 1935-1940. Gjithnjë në mbështetje të këtyre burimeve shohim se ky aktivitet ishte përqendruar në dy çështje thelbësore për kohën: e para, ngritja e vetëdijes kombëtare, dhe e dyta, ndërprerja e tërësishme e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi

Nga Qerim LITA

Me shpërbërjen e organizatës "Xhemijet", e cila zyrtarisht njihej si parti politike të "myslimanëve të jugut", shqiptarëve ju ndalua e drejta e përfaqësimit në Parlament nëpërmjet ndonjë partie të veçantë të tyre. Kjo e drejtë atyre u mundësohej vetëm nëpërmjet partive të ndryshme serbe, siç ishin Partia Radikale, Partia Demokratike etj. Si rrjedhojë e politikës diskriminuese ndaj shqiptarëve nga ana e pushtuesit të atëhershëm serbo-madh, një pjesë e parisë shqiptare nën udhëheqjen e Ferhat bej Dragës, në fillim të viteve tridhjeta, të shekullit të kaluar, ndërmorën një sërë aktivitetesh politike dhe organizative, të cilat kishin për qëllim ndërgjegjësimin e shqiptarëve. I tërë aktiviteti zhvillohej përmes Bashkësisë Fetare Islame, përkatësisht, Mexhlisit të Ulemasë së Shkupit, në kuadër të së cilit përfshiheshin tërë territoret shqiptare nën Mbretërinë jugosllave.

Burimet ushtarake, policore dhe diplomatike jugosllave hedhin dritë për një aktivitet të dendur të Ferhat bej Dragës e të bashkëpunëtorëve të tij midis harkut kohor 1935-1940. Gjithnjë në mbështetje të këtyre burimeve shohim se ky aktivitet ishte përqendruar në dy çështje thelbësore për kohën: e para, ngritja e vetëdijes kombëtare, dhe e dyta, ndërprerja e tërësishme e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Aktiviteti i parisë kombëtare e fetare shqiptare erdhi në shprehje veçmas pas Konventës turko-jugosllave, e cila më 11 korrik të vitit 1938 u parafua nga ana e të dy qeverive përkatëse. Kjo marrëveshje erdhi si rrjedhojë e negociatave të gjata midis diplomacisë jugosllave e asaj turke, të cilat zgjatën rreth tre vjet. Autoritetet jugosllave, të frymëzuar nga Ligji për Kolonizim, të cilin Parlamenti turk e solli më 14 korrik të vitit 1934, i cili veç tjerash, parashihte shpërnguljen e të gjithë turqve të Ballkanit për në Turqi, e panë si momentin kyç për shpërnguljen e tërësishme të popullsisë shqiptare e turke nga vatrat e tyre për në Turqi, dhe në tokat e tyre të vendoseshin kolonat sllave. Për këtë qëllim, Qeveria e Stojadinoviqit, në shtator të vitit 1935 themeloi Komitetit Ndërministror, i cili në tetor të atij viti hartoi "Projektin" për siç thuhej "shpërnguljen e elementeve josllave nga Serbia Jugore". Në të veç tjerash thuhej se çështja e shpërnguljes "duhet rregulluar sa më parë përmes konventës speciale" midis Jugosllavisë dhe Turqisë, si dhe midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, ashtu sikurse "kjo çështje është zgjidhur midis Turqisë dhe Rumanisë". Në rast se me Shqipërinë - thuhej në vazhdim - nuk do të mund të arrihet marrëveshje për shpërnguljen e shqiptarëve në Shqipëri, ose nëse shqiptarët nuk dëshirojnë të shpërngulen në Turqi, menjëherë duhet shkuar në dispozitat ligjore ekzistuese për shpërnguljen e këtij elementi nga zonat kufitare në brendi të vendit dhe popullzimin e zonave të njëjta me popullsi të kombësisë jugosllave....". Projekti, për të gjithë ata persona, të cilët "shprehnin dëshirën për shpërngulje", përkatësisht, jepnin deklaratë se tërhiqeshin nga shtetësia jugosllave parashikonte t'u ofrohen këto lehtësime: "a/ t'u jepet falas pashaporti i shpërnguljes, sipas rrethanave të kolektivit; b/ të lirohen nga të gjitha tatimet e vjetëruara /tatim i tokës, nëntatimet, ushtarët etj/; c/ në rast se persona të cilët shpërngulen, kanë borxhe kreditore ose borxhe private /kambiale, obligime dhe shkresa të ngjashme/, ta kryejnë deri më 1 shtator të vitit 1936, që i kanë me huadhënësit /shpenzuesit/ të paguhet nga vlera e llogaritur nga pasuria e tyre e patundshme; ç/ t'u jepet transport falas deri në Selanik dhe...., nëse deklarojnë se tërë pasurinë e tyre të patundshme ia lënë shtetit. Njëlloj kjo u përket edhe të shpërngulurve me gjendje të varfër; d/ t'u jepet lirim prej 75% për transport hekurudhor personave të cilët janë të siguruar materialisht ose të cilët pronën e tyre e kanë shitur më herët; dhe/ të lirohen nga të gjitha të dhënat për bartjen e inventarit lëvizës dhe të hollave; e/ nga momenti i dhënies së deklaratës për shpërngulje të lirohen nga regrutimi, dërgimi në shërbim, kryerja e shërbimit, thirrja për stërvitje dhe marrja në institucion dhe mjeteve transportuese për shkak kryerjes së stërvitjes...". Për një shpërngulje sa më e suksesshme e sa më të shpejtë të popullsisë jo-sllave, përkatësisht, shqiptare e turke, projekti parashikonte edhe marrjen e masave të domosdoshme: "a/ me të gjitha mjetet të thyhet e të pamundësohet çfarëdolloj propagande e cila nga Shqipëria zhvillohet në mesin e mbarë elementeve kundër shpërnguljes; b/ nga popullsia jo-sllave të cilët vijnë parasysh për t'u shpërngulur, të kërkohet plotësimi i të gjitha ligjeve e dispozitave, e sidomos ndaj atyre që u përkasin pagesave fiskale /tatimet, nëntatimet, kambialet etj./; c/ në territorin e Serbisë Jugore, sidomos në rrethet kufitare të ftohen sa më shpesh për stërvitje ushtarake të obliguarit e ushtrisë operative e rezervë me prejardhje jo-sllave, qoftë për stërvitje dhe manovra, qoftë për shkak ndërtimit të rrugëve strategjike ose objekteve fortifikuese; ç/ në parim të mos pranohen në shërbim shtetëror /ose vetëshërbim/ persona të cilët vijnë parasysh për shpërngulje, ndërsa ata të cilët tash më janë në shërbim shtetëror /vetëshërbim/, të sistemohen në krahinat ku jeton popullsia nacionale e jonë; d/ të zbatohet rreptësishtë parimi për shkollimin e obligueshëm të fëmijëve nga të gjitha trevat në shkollat fillore tona; dh/ të zbatohen rreptësishtë të gjitha dispozitat për popullzimin e krahinave jugore në pikëpamjen e organizimit të kompleksit të nevojshëm për popullzim, në radhë të parë në rrethet kufitare; e/ të filloj menjëherë emërtimi i objekteve gjeografike /vendbanimet, lumenjtë, malet etj./ dhe mbiemrat e njerëzve. Kjo u përket edhe mbishkrimeve publike, sipërmarrjeve, reklamave etj.; dhe, ë/ të gjitha masat e shtruara më lartë të implementohen parasëgjithash dhe menjëherë duke filluar nga linja kufitare me Shqipërinë kah brendia e vendit".

Për rrjedhojë, Ministria u Punëve të Jashtme jugosllave, më 11 dhjetor 1935, urdhëronte Legatën e saj në Ankara, që sa më shpejtë që është e mundur, të inicioj arritjen e një Konvente me Qeverinë e Republikës së Turqisë, për "shpërnguljen e popullsisë myslimane nga viset jugore për në Turqi". Kjo çështje, thuhej në urdhëresë "është e një rëndësie të shkallës së parë për vendin tonë", prandaj, kësaj "t'i kushtoni vëmendje sa më të madhe", dhe të bëni çmos që "me Qeverinë turke të arrihet sa më parë marrëveshja e propozuar...". Burimet diplomatike jugosllave, nxjerrin në pah se përkundër përpjekjeve të shumta nga Beogradi zyrtar për ta bindur Ankaranë të nënshkruaj sa më parë një Konventë të tillë edhe me Jugosllavinë, kjo çështje për Qeverinë turke nuk ishte me prioritet, për arsye se sipas tyre numri i popullsisë turke në këtë shtet arrinte shifrën prej rreth 50.000 banorëve, që për dallim nga shtetet tjera ballkanike, si p.sh. në Bullgari, numri i të cilëve ishte 400.000, Greqi 300.000 dhe Rumani 450.000, përbënte një pakicë e parëndësishme. Këto të dhëna edhe pse ishin reale, binin ndesh me planet dhe projektet serbo-madhe, të cilat parashikonin të shpërngulnin rreth 750.000 myslimanë (550.000 i konsideronin për shqiptarë dhe 200.000 turq) nga tokat shqiptare të cilat gjatë vitit 1913 iu aneksuan Serbisë. "Për ne është shumë me rëndësi - i shkruante më 18 tetor 1935, Stojadinoviq përfaqësuesit diplomatik jugosllav në Ankara - që Ligji turk për kolonizim, parasheh emigrimin në Turqi jo vetëm të turqve, por edhe popullsi të kulturës turke", për arsye se siç do të shprehet "në këtë mënyrë për ne ekziston mundësia, që krahas turqve, të cilët do t'i shpërngulim nga vendi ynë për në Turqi, të fusim edhe një numër më të madh të shqiptarëve". Për mosgadishmërinë e Ankarasë rreth arritjes së Konventës me Beogradin, jugosllavët fajësonin parinë e atëhershme shqiptare në krye me Ferhat Dragën, si dhe aktivitetin e shtuar propagandistik të konsullit të Përgjithshëm shqiptar në Shkup, Sheremet Xhuxhuli. I deleguari jugosllav në Tiranë, J. Gjonoviq, më 13 nëntor 1935 njoftonte MPJ-së, se nga biseda e zhvilluar me të deleguarin turk, Jakup Kadri, është informuar se "Shqipëria për përfaqësues të vetin diplomatik në Ankara, e dërgon konsullin e tyre të Përgjithshëm në Shkup, z. Xhuxhulin", i cili njihet si përkrahës i fuqishëm "i popullsisë sonë myslimane të Jugut", dhe se "mesiguri se edhe atje do të veproj që Turqia të mos i pranoj të gjithë këta njerëz...". Dy ditë më vonë, Legata jugosllave në Vjenë, informonte MPJ-në, për një letër të mbretit Zog, dërguar kryetarit të Republikës së Turqisë, Qemal Ataturkut: "Nga një burim i besueshëm - thuhej në shkresë - njoftohemi se para pak kohësh Zogu personalisht i ka dërguar një letër Qemalit, duke e lutur t'i kthej në Shqipëri të gjithë shqiptarët, të cilët janë shpërngulur nga Kosova e Maqedonia".

(vijon në numrin e ardhshëm)

Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Agjencia për të rinj dhe sport

Nr. 12-16/37
21.03.2018.
Agjencia për të rinj dhe sport
Rr. Makedonija nr. 38
Pallati "Panko Brashnarov"
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
Tel. +389 (0) 2 3119-628
+389 (0) 2 3126-270
Faks: +389 (0) 23117-693
Email:

Në bazë të nenit 17 paragrafi 2 i Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/2015, 106/2015, 153/2015, dhe 190/2016), Komisioni për mjete të patundshme i formuar me Vendim të sjellë nga Drejtori i Agjencisë për të rinj dhe sport nr. 12-16/36 të datës 16.03.2018, publikon:

SHPALLJE

Për grumbullimin e ofertave për furnizim/qira të hapësirës afariste për hapje të Zyrës nacionale për bashkëpunim rinor në Shkup – Përfaqësia e Zyrës rajonale për bashkëpunim rinor të Ballkanit Perëndimor

Të dhënat e domosdoshme që duhet t'i përmbajë shpallja:

- Emri dhe selia e organit shtetëror që bën furnizimin: **AGJENCIA PËR TË RINJ DHE SPORT me seli në rr. "Makedonija" nr. 38 Pallati "Panko Brashnarov", 1000 Shkup.**
- Lënda e furnizimit: **Qira e objektit afarist për hapje të Zyrës nacionale për bashkëpunim rinor në Shkup – Përfaqësia e Zyrës rajonale për bashkëpunim rinor të Ballkanit Perëndimor.**
- Shuma e vlerësuar e furnizimit: **1000 euro në kundërvlerë denarë në bazë mujore.**
- Mënyra e pagesës: **rata mujore**.
- Afati për parashtrimin e ofertave: **Afati për parashtrimin e ofertave është 10 (dhjetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes.**
- Mënyra e parashtrimit të ofertave:
- **Ofertuesi parashtron kopjen origjinale të ofertës me tërë dokumentacionin në zarf të mbyllur i cili:**

- është i adresuar me adresë të saktë të organit shtetëror;
- në këndin e epërm të majtë qëndron "Mos hap", që të mos hapet para kohës dhe datës së për hapje publike të ofertave;
- në këndin e epërm të djathtë shënohet lënda e shpalljes për ndarje të marrëveshjes;
- në këndin e poshtëm të djathtë shënohet: Emri Mbiemri dhe adresa ose Titulli dhe Selia e subjektit juridik – Ofertuesit.

- **Nëse zarfi nuk është i mbyllur ose i shënuar siç kërkohet, organi shtetëror nuk ndërmerr përgjegjësi për arritje jo në kohë dhe të pakompletuar të tij në arkiv ose për hapje të parakohshme të ofertës.**
- **Zarfi me ofertën dhe dokumentacionin e shoqëruar dorëzohet përmes postës ose drejtpërdrejtë në arkivin e Agjencisë për të rinj dhe sport.**
- **Pas kalimit të afatit për parashtrim të ofertave, Komisioni në afat prej 3 (tre) ditëve të punës parashtron lajmërim deri te parashtruesit e ofertave për kohën dhe vendin e hapjes publike të ofertave.**
- Adresa ku parashtrohen ofertat: **rr. "Makedonija" nr. 38 Pallati "Panko Brashnarov", 1000 Shkup (arkivi i Agjencisë për të rinj dhe sport).**
- Gjuha në të cilën parashtrohen ofertat: **Gjuha maqedonase**
- Dokumentacioni pronësor për pronën e patundshme lëndë e ofertës: **Ofertuesi së bashku me ofertën patjetër të parashtrojë listë pronësore jo më të vjetër se 1 (një) muaj të dhënë nga Agjencia për kadastër të patundshmërive për pronësinë e patundshmërisë.**
- Oferta përmban: **Emër Mbiemër dhe adresë ose Titull dhe Seli të subjektit juridik – Ofertues, shpjegim të shkurtë për parametrat e ofruara që i përmban patundshmëria ndërsa të cilat kërkohen përmes kësaj shpallje dhe lokacioni ku është e vendosur patundshmëria.**

Hapësira afariste për hapje të Zyrës rajonale për bashkëpunim rinor në Shkup – përfaqësia e Zyrës rajonale për bashkëpunim rinor të Ballkanit perëndimor është e nevojshme të përmbajë parametrat në vijim:

- **Sipërfaqja e hapësirës prej 110 deri në 140 m2;**
- **Hapësira të ketë hapësirë sanitare;**
- **Qasje deri te të gjitha shërbimet komunale (shpenzimet mujore për shërbimet e theksuara të kësaj pike do t'i mbulojë qiramarrësi)**
- **Të gjendet në pjesën qendrore të qytetit ;**
- **Të jetë lehtë i dukshëm dhe i qasshëm;**

Me respekt,
Komisioni për mjetet e patundshme

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

SH P A LL J E

PASQYRË E PJESËVE NË PRONË TË FONDIT QË DO TË OFROHEN PËR SHITJE NË BURSËN E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIN PUBLIK BURSAR NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUAR NGA 11.04.2018

Nr. rendor	Emri i shoqërisë	Vendi	Pjesa kryesore e shoqërisë në valutë	Pjesë për shitje në valutë	Pjesëmarrja e një pjese në pjesën kryesore të shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një pjese në denarë (MKD)
1	MLADOST SHPK	Demir Hisar	191,223 EUR	28,683 EUR	15,00%	441,037 MKD
2	RADIO SHËN NIKOLLË SHPK	Shën Nikollë	337,000 MKD	39,300 MKD	11.66%	9,825 MKD
3	MAKEDONIJAPATENT SHPK	Shkup	231,300 MKD	8,900 MKD	3.85%	2,225 MKD
4	DRIMKOL OGP SHPK	Prilep	8,910,000 MKD	105,090 MKD	1.18%	26,273 MKD

Pjesët do të ofrohen për shitje përmes Bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 11.04.2018. Pagesa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË
www.piom.com.mk

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTİVAR BELEDİYESİ

www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-1751/5-17
21.03.2018 vit
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) të Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ë R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë se për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik **për formimin e parcelës ndërtimore në PK nr. 2487 dhe PK nr. 2491 për KK Banjicë e Epërme/Banjicë e Poshtme me dedikim A1 -** Komuna e Gostivarit, Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e:

PREZANTIMIT PUBLIK
DHE ANKETËS PUBLIKE

Për projektin Arkitektoniko-Urbanistik **(PAU) për formimin e parcelës ndërtimore në PK nr. 2487 dhe PK nr. 2491 për KK Banjicë e Epërme/Banjicë e Poshtme me dedikim A1-**Komuna e Gostivarit me përfshirje projektuese prej **544,62m2** kufizohet me:

- Nga ana veriore me rrugë ekzistuese

- Nga ana jugore me rrugë ekzistuese

- Nga ana lindore me rrugë ekzistuese

- **Në anën perëndimore me PK nr. 2492**

Prezantimi publik do të mbahet në mjediset e Komunës së Gostivarit, respektivisht në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit më datë **27.03.2018 (e martë) në ora 13:00**
Projekti Arkitektoniko-Urbanistik **(PAU** **për formimin e parcelës ndërtimore në PK nr. 2487 dhe PK nr. 2491 për KK Banjicë e Epërme/Banjicë e Poshtme me dedikim A1 -** Komuna e Gostivarit do të ekspozohet në mjediset e Komunës së Gostivarit do të zgjasë 5 ditë pune prej **27.03.2018** deri më **02.04.2018,** çdo ditë pune **prej orës 08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë mund të parashtrojnë vërejtjet me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

Агенција за вработување на Република Македонија

Në bazë të Programit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën – Trajnime të bazuara në shkathtësitë kompjuterike (shkrim-leximi digjital), të financuar nga Banka Botërore, Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datë 23.03. 2018, shpall

THIRRJE PUBLIKE

për evidentim të personave të pa punësuar

Thirren të gjithë personat e regjistruar të papunë në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë të cilët kanë përfunduar minimum arsimin e mesëm dhe që janë të interesuar të përfshihen në masën - Trajnim për aftësi themelore kompjuterike (shkrim-leximi digjital) për të aplikuar për pjesëmarrje në trajnim për përfitimin e një nga aftësive të mëposhtme kompjuterike:

- shkathtësi për përpunim të teksteve (MS Word),
- shkathtësi për punë me tabela dhe përllogaritje (MS Excel),
- shkathtësi për punë me programe për prezantim (MS Power Point),
- shkathtësi për punë me data baza të të dhënave (MS Access) dhe
- shkathtësi për punë në internet dhe postë elektronike (Internet dhe MS Outlook).

Trajnimet do të realizohen në ato qytete në të cilat Agjencia e punësimit do të ketë lidhur një marrëveshje me zbatuesit e trajnimeve. Personat e papunë do të kenë mundësi të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnim deri në plotësimin e plotë të numrit të parashikuar të kandidatëve. Është parashikuar që me trajnimin të përfshihen 300 (treqind) persona.

Trajnimet do të zhvillohen në përputhje me planin programor, mënyrën dhe dinamikën për kryerjen e trajnimeve të propozuara nga zbatuesi i trajnimit. Personat të cilët rregullisht kanë ndjekur trajnimin dhe kanë ndjekur të paktën 70% të orëve të parashikuara do të marrin certifikatë përkatëse dhe mundësi për tu nënshtruar provimit përfundimtar.

Të gjithë kandidatët e përzgjedhur do të lidhin një marrëveshje për pjesëmarrje në trajnim me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve kontraktuese.

Personat e interesuar të papunë mund ta paraqesin pjesëmarrjen e tyre në Qendrën për punësim ku janë të evidentuar si persona të papunë, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 14:00. Informacione të hollësishme mund të merren nga Klubet e Qendrave të Punësimit, në numrin e kontaktit të telefonit 02 / 3111-850, si dhe në faqet e internetit të Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së punës dhe politikës sociale e Republikës së Maqedonisë (www.mtsp.gov.mk).

Agjencia e punësimit e

REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Агенција за вработување на Република Македонија

Në bazë të Programit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën – Trajnime të bazuara në shkathtësitë kompjuterike (shkrim-leximi digjital), të financuar nga Banka Botërore, Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datë 23.03. 2018, shpall

THIRRJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

për zbatues të trajnimeve për shkathtësi themelore kompjuterike (shkrim-lexim digjital)

Thirren zbatuesit e regjistruar të trajnimeve të cilët janë të interesuar për pjesëmarrje në realizimin e masës - Trajnime të bazuara në shkathtësitë kompjuterike të parashtrojnë letër për shprehje të interesimit për realizimin e trajnimeve të cilat i mbulojnë shkathtësitë vijuese kompjuterike:

- shkathtësi për përpunim të teksteve (MS Word),
- shkathtësi për punë me tabela dhe përllogaritje (MS Excel),
- shkathtësi për punë me programe për prezantim (MS Power Point),
- shkathtësi për punë me data baza të të dhënave (MS Access) dhe
- shkathtësi për punë në internet dhe postë elektronike (Internet dhe MS Outlook).

Trajnimet do të realizohen në territorin e të gjithë vendit, në përputhje me interesin në rritje të kategorisë së synuar të personave të regjistruar të papunë. Përfshirja e planifikuar i kandidatëve është 300 (treqind) persona.

Ofruesit e interesuar të trajnimit mund të parashtrojnë letër për të shprehur interes për zbatimin e trajnimeve për aftësitë kompjuterike të theksuara më sipër (MS Word, MS Excel, MS Power Point dhe MS Access, Internet dhe MS Outlook) në një ose më shumë lokacione në Republikën e Maqedonisë.

Zbatuesit e trajnimeve patjetër duhet t'i përmbush kriteret vijuese për përcaktimin e aftësisë:

1. Të ketë punë pozitive financiare në 3 (tre) vitet e kaluara fiskale, të mos jetë në procedurë falimentimi ose likuidimi, të mos ketë tatime, kontribute ose detyrime të tjera publike të papaguara;
2. Të disponon me kapacitete të pajisura në mënyrë adekuate me konfiguracionin hardueri dhe softueri për zbatimin e trajnimeve;
3. Të disponojë me personel të kualifikuar mësimdhënës (ligjërues) për zbatimin e trajnimeve konkrete, me arsim të kryer universitar dhe minimum 3 (tre) vjet përvojë profesionale në mbajtjen e trajnimeve për shkathtësi përkatëse kompjuterike.

Përmbushja e kritereve të deklaruara vërtetohet me parashtrimin e dokumenteve vijuese:

1. Raport për Bilancin e gjendjes dhe të dhëna nga Bilanci i suksesit,Vërtetim se nuk është hapur asnjë procedurë falimentimi të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, Vërtetim se nuk është hapur procedura e likuidimit e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, Vërtetim për tatimet e paguara, kontribute dhe pagesave të tjera publike të lëshuara nga Zyra e të Hyrave Publike të Republikës së Maqedonisë;
2. Deklaratë për disponim me objekte të pajisura në mënyrë të përshtatshme me konfiguracionin harduerik dhe softuerik për realizimin e trajnimeve, për vendet për të cilat paraqitet;
3. Deklaratë për disponim me kuadër të kualifikuar arsimor me shtojca
   - kopje të diplomave ose certifikatave për provimet e përfunduara të personelit mësimor, si dëshmi për nivelin e përfunduar dhe profilin e arsimit;
   - biografi e shkurtër (CV) dhe referenca si dëshmi e përvojës profesionale të stafit mësimdhënës në trajnimet e kryera për shkathtësi përkatëse kompjuterike;
4. Propozim plan arsimor me mënyrë dhe dinamikë për realizimin e trajnimeve për aftësi kompjuterike përkatëse.

Dokumentet e përgatitura nga zbatuesi i trajnimit duhet të jenë në origjinal, të nënshkruara nga personi përgjegjës ose një person i autorizuar prej tij, ndërsa dokumentet e lëshuara nga autoritetet kompetente mund të jenë në origjinal ose në kopje, të njëjta me ato origjinale dhe nuk guxojnë të jenë më të vjetra nga 6 (gjashtë) muaj, llogaritur nga data e përcaktuar si afati i fundit për dërgimin e letrës për shprehje të interesit, e deri në fund.

Trajnimi për aftësinë përkatëse kompjuterike siguron një fond prej 30 (tridhjetë) orësh me kohëzgjatje të një orë prej 45 minutash dhe duhet të realizohet në periudhën nga 2 deri në 4 muaj, por jo më vonë se më 15 gusht 2018.

Kostoja e trajnimit është 6.000,00 MKD (gjashtë mijë denarë) për person dhe i referohet një aftësie kompjuterike.

Të drejtat dhe detyrimet e APRM, MPPS, zbatuesve dhe pjesëmarrësve do të rregullohen me lidhjen e një marrëveshjeje të ndërsjellë.

Zbatuesi i trajnimit detyrimisht i paraqet raport mujor dhe përfundimtar mbi rregullsinë e pjesëmarrësve në trajnim në formë të shtypur dhe elektronike APRM. Personat janë të detyruar të marrin pjesë së paku 70% të mësimeve.

APRM bën monitorim të trajnimeve.

Pas përfundimit të trajnimit, realizuesi i trajnimit duhet t'i dorëzojë APRM një kërkesë për pagesë me një faturë të bashkangjitur, listë e personave që kanë marrë certifikatë për trajnimin e ndjekur dhe një raport narrativ mbi rezultatet e arritura, pengesat në të cilat kanë hasur gjatë trajnimit dhe rekomandimet për parandalimin e tyre . Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, APRM përgatit një kërkesë me shkrim për pagesën e trajnimeve të realizuara në Projektin e MPPS/ ZHKP.

Të gjithë trajnerët e interesuar për pjesëmarrje në këtë thirrje janë të ftuar të paraqesin një letër interesi me dokumentacionin e kërkuar të bashkangjitur. Dokumentet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë (APR;)
rr. Vasil Gjorgov nr. 43, 1000 Shkup

Afati i fundit për shprehjen e interesit është data 10.04.2018 deri në orën 15:30.

Të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur duke iu referuar **Numrit referues 3.4.2** dhe duke shënuar **"Mos hap"** në cepin e sipërm të majtë të zarfit.

Letrat e pa kompletuara, të shënuara në mënyrë jo-përkatëse dhe të pa dërguara në kohë për shprehje të interesit nuk do të merren parasysh.

Agjencia e punësimit e
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Агенција за вработување на Република Македонија

Në bazë të Programit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën – Trajnime për shkathtësi themelore (gjuhë të huaja), të financuar nga Banka Botërore, Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datë 23.03. 2018, shpall

THIRRJE PUBLIKE

për evidentim të personave të pa punësuar

Thirren të gjithë personat e regjistruar të papunë në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë të cilët kanë përfunduar minimum arsimin e mesëm dhe që janë të interesuar të përfshihen në masën - Trajnim për aftësi themelore kompjuterike (gjuhë të huaja) për të aplikuar për pjesëmarrje në trajnim për përfitimin e shkathtësive gjuhësore përmes një nga kurset (shkallë nga A1 deri në C2) të cilat i mbulojnë nivelet e Kornizës Evropiane gjuhësore, për një nga gjuhët më shpesh të përdorura të Unionit Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht).

kandidatët e interesuar për nivelin fillestar (A1.1 shkalla e parë) e kalojnë vetëm përzgjedhjen administrative në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, ndërsa kandidatët e interesuar për nivele më të larta të kornizës gjuhësore do të testohen nga ofruesi i trajnimit për kontrollin dhe verifikimin e nivelin gjuhësor.

Trajnimet do të realizohen në ato qytete në të cilat Agjencia e punësimit do të ketë lidhur një marrëveshje me zbatuesit e trajnimeve. Personat e papunë do të kenë mundësi të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnim deri në plotësimin e plotë të numrit të parashikuar të kandidatëve. Është parashikuar që me trajnimin të përfshihen 300 (treqind) persona.

Trajnimet do të zhvillohen në përputhje me planin programor, mënyrën dhe dinamikën për kryerjen e trajnimeve të propozuara nga zbatuesi i trajnimit. Personat të cilët rregullisht kanë ndjekur trajnimin dhe kanë ndjekur të paktën 70% të orëve të parashikuara do të marrin certifikatë përkatëse dhe mundësi për tu nënshtruar provimit përfundimtar.

Të gjithë kandidatët e përzgjedhur do të lidhin një marrëveshje për pjesëmarrje në trajnim me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve kontraktuese.

Personat e interesuar të papunë mund ta paraqesin pjesëmarrjen e tyre në Qendrën për punësim ku janë të evidentuar si persona të papunë, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 14:00. Informacione të hollësishme mund të merren nga Klubet e Qendrave të Punësimit, në numrin e kontaktit të telefonit 02 / 3111-850, si dhe në faqet e internetit të Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë (www.avrm.gov.mk)dhe të Ministrisë së punës dhe politikës sociale e Republikës së Maqedonisë(www.mtsp.gov.mk).

Agjencia e punësimit e

REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Агенција за вработување на Република Македонија

Në bazë të Programit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën – Trajnime për shkathtësi themelore (gjuhë të huaja), të financuar nga Banka Botërore, Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datë 23.03. 2018, shpall

THIRRJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË INTERESIT
për zbatues të trajnimeve për shkathtësi themelore (gjuhë të huaja)

Thirren zbatuesit e regjistruar të trajnimeve që janë të interesuar të marrin pjesë në zbatimin e masës –Trajnim për shkathtësi bazë (gjuhët e Huaja) të parashtrojnë një letër interesi për kryerjen e trajnimeve për aftësi gjuhësore, përmes kurseve (shkallë prej A1 deri C2) të cilat i mbulojnë nivelet e Kornizës Evropiane të gjuhëve të Këshillit të Evropës, për një nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Trajnimet do të realizohen në territorin e të gjithë vendit, në përputhje me interesin në rritje të kategorisë së synuar të personave të regjistruar të papunë. Përfshirja e planifikuar i kandidatëve është 300 (treqind) persona.

Zbatuesit e interesuar mund të paraqesin një letër për shprehje të interesit në kryerjen e trajnimeve për shkathtësitë gjuhësore për shkallët e lartpërmendura (prej A1 deri C2) në një ose më shumë lokacione në Republikën e Maqedonisë.

Kandidatët e interesuar në nivelet më të larta të kornizës gjuhësore do të testohen nga ofruesi i trajnimit gjuhësor për kontrollimin e nivelit të njohjes së gjuhës.

Zbatuesit e trajnimeve patjetër duhet t'i përmbush kriteret vijuese për përcaktimin e aftësisë:

1. Të ketë punë pozitive financiare në 3 (tre) vitet e kaluara fiskale, të mos jetë në procedurë falimentimi ose likuidimi, të mos ketë tatime, kontribute ose detyrime të tjera publike të papaguara;
2. Të disponojë me objekte të pajisura në mënyrë të përshtatshme me mjete ndihmëse dhe pajisje arsimore-shkencore për realizimin e trajnimeve;
3. Të disponojë me personel të kualifikuar mësimdhënës për zbatimin e trajnimeve konkrete, përkatësisht nga 1 (një) ligjërues për secilën nga gjuhët e specifikuara, me diplomë universitare dhe me minimum 3 (tre) vjet përvojë profesionale në mbajtjen e trajnimit në gjuhën përkatëse - anglisht, frëngjisht ose gjermanisht;

Përmbushja e kritereve të deklaruara vërtetohet me parashtrimin e dokumenteve vijuese:

1. Raport për Bilancin e gjendjes dhe të dhëna nga Bilanci i suksesit,Vërtetim se nuk është hapur asnjë procedurë falimentimi të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, Vërtetim se nuk është hapur procedura e likuidimit e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, Vërtetim për tatimet e paguara, kontribute dhe pagesave të tjera publike të lëshuara nga Zyra e të Hyrave Publike të Republikës së Maqedonisë;
2. Deklaratë për disponim me objekte të pajisura në mënyrë të përshtatshme me pajisje përkatëse arsimore-shkencore , për vendet për të cilat paraqitet;
3. Deklaratë për disponim me kuadër të kualifikuar arsimor me shtojca
   - kopje të diplomave ose certifikatave për provimet e përfunduara të personelit mësimor, si dëshmi për nivelin e përfunduar dhe profilin e arsimit;
   - biografi e shkurtër (CV) dhe referenca si dëshmi e përvojës profesionale të stafit mësimdhënës në trajnimet e kryera për shkathtësi përkatëse për gjuhët;
4. Propozim plan arsimor me mënyrë dhe dinamikë për realizimin e trajnimeve për shkallën përkatëse

Dokumentet e përgatitura nga zbatuesi i trajnimit duhet të jenë në origjinal, të nënshkruara nga personi përgjegjës ose një person i autorizuar prej tij, ndërsa dokumentet e lëshuara nga autoritetet kompetente mund të jenë në origjinal ose në kopje, të njëjta me ato origjinale dhe nuk guxojnë të jenë më të vjetra nga 6 (gjashtë) muaj, llogaritur nga data e përcaktuar si afati i fundit për dërgimin e letrës për shprehje të interesit, prapa.

Trajnimi për shkathtësi gjuhësore parashikon një fond prej 30 (tridhjetë) orësh me kohëzgjatje të një orë prej 90 minutash dhe duhet të realizohet në periudhën nga 2 deri në 4 muaj, por jo më vonë se më 15 gusht 2018.

Kostoja e trajnimit është 6.000,00 MKD (gjashtë mijë denarë) për person dhe i referohet një shkalle gjuhësore.

Të drejtat dhe detyrimet e APRM, MPPS, zbatuesve dhe pjesëmarrësve do të rregullohen me lidhjen e një marrëveshjeje të ndërsjellë.

Zbatuesi i trajnimit detyrimisht i paraqet raport mujor dhe përfundimtar mbi rregullsinë e pjesëmarrësve në trajnim në formë të shtypur dhe elektronike APRM. Personat janë të detyruar të marrin pjesë së paku 70% të mësimeve.

APRM bën monitorim të trajnimeve.

Pas përfundimit të trajnimit, realizuesi i trajnimit duhet t'i dorëzojë APRM një kërkesë për pagesë me një faturë të bashkangjitur, listë e personave që kanë marrë certifikatë për trajnimin e ndjekur dhe një raport narrativ mbi rezultatet e arritura, pengesat në të cilat kanë hasur gjatë trajnimit dhe rekomandimet për parandalimin e tyre . Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, APRM përgatit një kërkesë me shkrim për pagesën e trajnimeve të realizuara në Projektin e MPPS/ ZHKP.

Të gjithë trajnerët e interesuar për pjesëmarrje në këtë thirrje janë të ftuar të paraqesin një letër interesi me dokumentacionin e kërkuar të bashkangjitur. Dokumentet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme
:

Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë (APR;)
rr. Vasil Gjorgov nr. 43, 1000 Shkup

Afati i fundit për shprehjen e interesit është data 10.04.2018 deri në orën 15:30.

Të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur duke iu referuar **Numrit referues 3.4.3** dhe duke shënuar **"Mos hap"** në cepin e sipërm të majtë të zarfit.

Letrat e pa kompletuara, të shënuara në mënyrë jo-përkatëse dhe të pa dërguara në kohë për shprehje të interesit nuk do të merren parasysh.

Agjencia e punësimit e
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

MAQEDONIA NË BELEK TË ANTALIAS PRES FINLANDËN

TË VAZHDOHET SERIA POZITIVE

Kundërshtari i sotëm Finlanda i është borxhli verdhekuqve nga dy përballjet e kaluara në vitin 2005 në kuadër të kualifikimeve për KB 2006. Në të dyja përballjet, mbrojtja e Maqedonisë pranoi tetë gola, pesë si mysafir dhe tre në Shkup, derisa golin e vetëm e shënoi Goran Maznov. Në anën tjetër në vitin 2002 u përballen dy herë në ndeshje miqësore, ku në njërën arritën fitore

Koha — Bujar KURTAJ

Shkup, 22 mars - Përfaqësuesja e Maqedonisë sot (e premte) do të zhvillon njërën nga dy ndeshjet miqësore në Antalia të Turqisë. Në arenën "Gloria" në Belek, verdhekuqtë do të përballen me përfaqësuesen e Finlandës dhe do të tentojë të vazhdojë serinë pozitive, duke marr parasysh se nuk ka pësuar humbje në pesë ndeshje me radhë, kurse përballja me Finlandën dhe më pas me Azerbajxhanin, do të shërbejnë si një përgatitje për Ligën e Kombeve, e cila fillon në muajin shtator. Ndryshe, kundërshtari i sotëm Finlanda i është borxhli verdhekuqve nga dy përballjet e kaluara në vitin 2005 në kuadër të kualifikimeve për KB 2006. Në të dyja përballjet, mbrojtja e Maqedonisë pranoi tetë gola, pesë si mysafir dhe tre në Shkup, derisa golin e vetëm e shënoi Goran Maznov. Në anën tjetër në vitin 2002 u përballen dy herë në ndeshje miqësore, ku në njërën arritën fitore. Ndërkohë, në formë të mirë gjenden edhe futbollistët e Finlandës dhe nuk ka pësuar disfatë në gjashtë ndeshjet e fundit që dëshmon seriozitetin e kundërshtarit të Maqedonisë.

Duelin me Finlandën, seleksionuesi Igor Angellovski e pret me formacionin më të mirë dhe synon të vazhdojë serinë e fitoreve edhe atë pa pranuar gol. Sulmuesi i Palermos, Ilija Nestorovski për faqen e FFM-së tha se beson në fitore të re të Maqedonisë. "Jemi përgatitur maksimalisht, kemi pasur kushte të mira për punë në katër ditët sa ishim në përgatitje. Finlanda është një përfaqësuese kualitative dhe e kemi marr me shumë seriozitet. I kemi analizuar paraqitjet e tyre, anët e mia dhe besoj se me fitore do të përmirësojmë atmosferën e shkëlqyer në radhët tona. Kjo gjithsesi do të na shërbejë si motiv lus për duelin me Azerbajxhanin", deklaroi Nestorovski.

SHPRESAT BESOJNË NË REZULTAT POZITIV

Pos përfaqësueses A të Maqedonisë, sot (e premte) ndeshjen e tyre do ta zhvillojnë edhe shpresat e Maqedonisë deri 21 vjeç. Në qendrën stërvitore "Petar Milloshevski" djemtë e seleksionuesit Bllagoja Milevski në kuar të kualifikimeve do të përballen me përfaqësuesen e Rusisë. Maqedonia deri më tani ka vetëm një fitore, ndërsa Rusia në këto kualifikime ka tre fitore, një barazim dhe një disfatë. "Jemi përgatitur maksimalisht dhe tërë javën kemi stërvitur për ndeshjen me Rusinë dhe pastaj me ndeshjen me Austrinë. Mirëpo tani jemi fiksuar në përballjen me Rusinë dhe besojmë në rezultat pozitiv që të fitojmë këtë ndeshje. I kemi analizuar të gjithë pikët e dobëta të Rusisë dhe besojmë se gjithçka do të shkoje në rregull dhe pikat e tyre të dobëta, do t'i shfrytëzojmë", tha për Alsat M, Nehar Sadiki.

Falënderoj Panuçin, shpresoj të shfrytëzoj shansin

La Kaizerslauternin duke qëndruar për 6 muaj pa ekip, por në merkaton e dimrit iu bashkua Virtus Entellas në Serinë B. Naser Aliji për shumë vite ka qëndruar nën hijen e Ansi Agollit, por me mos grumbullimin e 35-vjeçarit, mundësitë për të fituar vendin e titullarit më kombëtare janë më të mëdha. "Një shans shumë i madh për mua, sepse Ansi nuk është grumbulluar. Shpresoj që të jem pjesë e formacionit jo vetëm për këtë ndeshje, por edhe në vazhdimësi", u shpreh kumanovari, i falënderon Panuçin për ndihmën që ia ka bërë atij. "Seleksionuesi Panuçi më ka ndihmuar shumë dhe dua ta falënderoj. Nuk është normale që të grumbullojë një lojtar pa ekip. Ka qenë një mundësi e mirë për të treguar veten dhe për të gjetur ekipin e ri. Më ka kërkuar të jem i gatshëm dhe të bëj stërvitje çdo ditë për të qenë mirë fizikisht. Nuk doja të rrija pa ekip, tani jam në Serinë B me Virtus Entellan dhe duhet të tregoj veten", shtoi më tej ai. Në fund Aliji ka folur edhe për vendin e titullarit. "Unë jam në formë shumë të mirë dhe në fund vendos trajneri për formacionin. Nuk dua të zëvendësoj Ansin, sepse jemi pak ndryshe. Unë dua të jem Aliji. Ansi ka vite në skuadër dhe është një person shumë pozitiv", përfundoi Naser Aliji, duke thënë se Kombëtarja e Panuçit dhe ajo e De Biasit pothuajse të njëjtin taktik, dhe se kanë ndryshuar gjëra të vogla, por jo shumë.

FFM përmirëson infrastrukturën në stadiumin në Kërçovë

Shkup, 22 mars - Falë fondeve që ndau FFM, stadiumi i qytetit në Kërçovë do të ketë zhveshtore të reja dhe hapësira të tjera nevojshme, të mjaftueshme për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare. Derisa, e gjithë kjo do të përfundojë deri në fund të muajit marsit. "Me rreth 30 mijë euro, fonde që Federata Futbollistike e Maqedonisë i dedikoi për këtë mbërthim, stadiumin e qytetit në Kërçovë do të ketë zhveshtore të reja, si dhe hapësira për referë, delegat, dhoma për doping kontroll, sallë për pres-konferencë, hapësirë për VAR sistem dhe ekonomi. Ky komoditet do të mundësojë që stadiumi jetë nikoqirë i ndeshjeve zyrtare të Maqedonisë U-17 dhe U19. Këto fonde janë nga programi i FFM-së për përmirësimin e infrastrukturës së terreneve dhe stadiumeve të futbollit në gjithë vendin", ka informuar Marjan Ristevski nga LFK e Kërçovës.

VAZHDON DHUNA NDAJ TRAJNERËVE NË SHQIPËRI

Goditet me grushte dhe kërcënohet me thikë trajneri i Tiranës

Trajneri i skuadrës së moshave U-17 të Tiranës, Migen Memelli (ish sulmues i bardhebluve) është goditur me grushte dhe është kërcënuar me thikë nga prindi i një fëmije, pas përfundimit të seancës stërvitore të paradites së kësaj të enjteje, në fushën stërvitore "Skënder Halili". Pasi ka përfunduar stërvitja, prindi i një fëmije me inicialet A.Ç. ka pasur pretendime për aktivizimin e djalit të tij dhe ka goditur menjëherë me grushte trajnerin Memelli. Ai ka nxjerrë edhe një thikë, duke iu drejtuar trajnerit me shprehjen "Do të të pres fytin".

Mësohet se, menjëherë më pas trajneri i Tiranës U17, Migen Memelli ka bërë kallëzimin e tij në Komisariatin Nr. 6 të kryeqytetit, për këtë person. Ky është rasti i dytë brenda pak javësh i dhunës së ushtruar ndaj trajnerëve të futbollit, pas tentativës për sulm me thikë ndaj trajnerit të Vllaznisë, Ernest Gjoka.

Republika e Maqedonisë
Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore

Në bazë të nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/15 – tekst i pastruar dhe 27/16) dhe nenit 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16) Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore, me seli në rr. "Dame Gruev" numër 14, në Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësimin e punëtorëve për kohë të caktuar deri më 31.12.2018 në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore për vendet e punës në vijim

1. **Këshilltar për marrëdhënie me publikun,** në Departamentin për organizim dhe mbështetje të punës së Drejtorit – **1 (një) realizues**, me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:
- Së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit nga sfera e shkencave juridike, shkencave politike ose shkencës së letërsisë
- Njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane)
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Përvojë e punës – së paku tre vjet përvojë pune në profesion
- Orari i punës është i rregulluar me një ndërrim dhe zgjatë 8 orë në ditë
- Orari ditor i punës prej ora 08,00/8.30 deri në ora 16.00/16.30
- Puna gjatë ditëve të punës – prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orari javor i punës është 40 orë
- Pagesa bazë është 33.540,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë:
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,
- Certifikatë të shtetësisë
- Vërtetim/Dëshmi për përvojën e punës
- Vërtetim/Dëshmi për njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane)
- Vërtetim/Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.
Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 31.12.2018.

Afati për paraqitje të kandidatëve është 5 (pesë) ditë pune, nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor. Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 45, 90 ose 120 ditë pas kalimit të afatit për paraqitje, varësisht nga numri i fletëparaqitjeve të arritura.

Personi për kontakt Albana Bajrami.

Kontakt telefoni 02/3118- 044.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për punësim duke parashtruar fletëparaqitjet për punësim me të dhëna për kontakt dhe dokumente/dëshmi për përmbushjen e kushteve për punësim në adresën e Ndërmarrjes publike: NDËRMARRJA PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE rr. "Dame Gruev" nr. 14 , 1000 Shkup ose në sportel të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, me shenjë "për shpallje publike për paraqitje të kandidatëve për punësim në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore".

Procedurën për zgjedhje të kandidatëve do ta realizojë Komisioni i formuar nga ana e u. d Drejtorit të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, për zgjedhjen e realizuar secili kandidat do të informohet me shkrim.

Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore

POSTA e MAQEDONISË

Shoqata aksionare për komunikacione postar
Posta e Maqedonisë në pronësi shtetërore
Bul. Orce Nikolov 46 • 1000 Shkup
Tel +389 2 3105-105 • **Fax** +389 2 3120-212
www.posta.com.mk

Numri arkivit _____
Datë._____2018

Në bazë të nenit 22, paragrafi 4 dhe nenit 23 nga Ligji për marrëdhënie pune, nenit 18 dhe 19 nga Marrëveshja kolektive e SHA "Posta e Maqedonisë" – Shkup – tekst i korrigjuar, Drejtori i përgjithshëm i SHA "Posta e Maqedonisë" – Shkup shpall:

SHPALLJE PUBLIKE
Për plotësimin e 3 (tre) vendeve të punës, në kohë të pacaktuar:

1. *Drejtoria e SHA "Posta e Maqedonisë" - Shkup*, rr. Orce Nikolov, nr. 46, Shkup
1.1 Bashkëpunëtor – programues, Sektori për teknologji informatike - një (1) realizues:
- Arsim sipëror shkalla VII - Fakulteti Elektroteknik apo Fakulteti Natyror Matematikor (drejtimi i informatikës);
- Me ose pa përvojë pune.

Paga mujore bazë: 23.381,00 denarë;
Orët e punës në javë: 40; Orari i punës nga ora 08:00 deri 16:00; Ditët e punës: nga e hëna deri të premten.

2 *Njësia rajonale – QKRP Koçani*, rr. Marshall Tito, pn – Koçani
2.1 Bashkëpunëtor për komunikacion postar ne Koçani – një (1) realizues:
- Arsim sipëror shkalla VII – Fakulteti i Komunikacionit (drejtimi PTT), Ekonomik, Juridik, ose arsim tjetër sipëror;
- Me ose pa përvojë pune.

Paga mujore bazë: 22.465,00 denarë.
Orët e punës në javë: 40; Orari i punës nga ora 08:00 deri 16:00; Ditët e punës: nga e hëna deri të premten

2.2 Nëpunës sporteli – një (1) realizues:
- Arsim i mesëm shkalla IV, Shkollë e mesme PTT, ekonomike, gjimnaz apo shkollë tjetër e mesme;
- Me ose pa përvojë pune.

Paga mujore bazë: 16.969,00 denarë.
Orët e punës në javë: 40; Orari i punës prej 09.00 deri 17.00, respektivisht prej 08.00 deri 15.00 prej ditës së hënë deri të premten dhe prej 08.00 deri 13.00 ditën e shtunë, varësisht nga orari i kohës së punës të Njësisë së rrjetit postar.
Afati i paraqitjes: Pesë (5) ditë pune, duke filluar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit në shtypin ditor.
Afati për zgjedhje:
- deri në 200 kandidatë të paraqitur në afat prej 45 ditëve,
-prej 201 deri 500 kandidatë në afat prej 90 ditëve dhe
-mbi 500 kandidatë në afat prej 120 ditëve, pas skadimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet e nevojshme:
1. Fletëparaqitja (formulari merret në arkivin përkatës ose në www.posta.com.mk);
2. CV/Biografi e shkurtër;
3. Dëshmi për arsimin e kryer;
4. Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e theksuara në shpalljen publike në momentin e aplikimit.
Vendi i dorëzimit:
Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme dorëzohen drejtpërdrejtë:
- Në Arkivin e Drejtorisë për vendet e punës që janë paraparë në Drejtorinë e SHA Posta e Maqedonisë – Shkup;
- Në Arkivin e Njësisë rajonale përkatëse për vendet e punës që janë paraparë për Njësinë rajonale të caktuar; ose
- Përmes postës në adresat e lartpërmendura.

Kandidatët janë të obliguar që Fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe më të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në rregull në shpalljen publike do të intervistohen me qëllim që të kryhet kontrolli i diturive të tyre.
Lajmërimi për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistes dhe lista e kandidatëve të paraqitur në rregull që do të intervistohen në mënyrë shtesë do të publikohen në web faqen zyrtare të SHA Posta e Maqedonisë – Shkup, në www.posta.com.mk.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara jo në kohë, nuk do të shqyrtohen.

Drejtori i përgjithshëm,
Faadis Rexhepi

Агенција за вработување на Република Македонија

Nëse jeni person me vizion për biznesin tuaj, me motiv për „jam i zoti i vetvetes", me energji për t'u ballafaquar me sfidat, atëherë kjo është Shpallja e vërtetë për ju.

Lexoni dhe mësoni më shumë për mundësitë për të fituar asistencë financiare të pakthyeshme prej 5.000 deri 10.000 euro nga buxheti i Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë dhe të themeloni biznesin tuaj.

Për informacione shtesë Ju presim të vini në Qendrën për punësim dhe të kuptoni se për çfarë bëhet fjalë!

Në bazë të Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2018 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për Programin 1.1 Mbështetje për vetëpunësim (Sipërmarrje),e financuar nga Buxheti i Agjencisë për punësim i Republikës së Maqedonisë, në bashkëpunim me UNDP,me datë **23.03.2018,**shpall

NJOFTIM PUBLIK
për
persona të papunësuar

1. Inkurajohen personat e papunësuar me frymë për sipërmarrësi, me vizion për të themeluar biznesin e tyre, të aplikojnë në **Programin për Mbështetje të Vetëpunësimit (Sipërmarrësi).**

2. Ftohen të gjithë personat e papunësuar, persona të papunësuar të rinj deri në moshën 29 vjeç, persona të papunësuar me invaliditet të cilët duan ta zgjidhin çështjen e punësimit të tyre përmes mbështetjes financiare me Programin për Mbështetje të Vetëpunësimit (Sipërmarrësi), të lajmërohen në klubet e punës të APRM-së për të aplikuar për pjesëmarrje në program.

3. Mbështetja financiare përmes **Programit për Mbështetje të Vetëpunësimit (sipërmarrësi)**përfshin:
– **Mbështetje profesionale** në formë të **trajnimit për sipërmarrësi** dhe udhëheqje të biznesit, sistem vauçeri për **hartimin e planit të biznesit** dhe mbështetje gjatë regjistrimit të biznesit deri në shumë prej **17.940,00denarë**;
– Mjete të pakthyeshme (**grant**) në shumë prej **246.000** deri **307.500 denarë** për shfrytëzues ose deri në **615.000 denarë** nëse themelohet subjekt juridik nga ana e dy partnerëve si SHPK–Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga dy persona, me ç 'rast secili nga partnerët ka pjesë të barabartë (50%) në shoqëri.
– **Mundësi për punësim plotësues** të një personi për firmat e reja të hapura të cilat do të fitojnë grant plotësues në formë të pajisjeve dhe/ose materialit për punë në shumë prej **92.000,00 MKD** për person mbi 29 vjeç dhe shumë prej **153.750,00 MKD** për person deri në moshë 29 vjeç;
– Subjektet juridike të themeluara nga ana e personave me invaliditet kanë mundësi për grant plotësues për punësim të 2 (dy) personave,në shumë prej 92.000,00 për punësim personave me moshë mbi 29 vjeç ose 153.750 denarë për punësim të personave deri 29 vjeç, në pajtim me kushtet e cekura në marrëveshje;
– Subjektet juridike të themeluara nga dy partnerë, nuk do të mbështeten me grant për 1 (një) punësim plotësues;
– **Mbështetje këshillëdhënëse/mentorim** për një periudhë kohore 12 mujore nga themelimi i biznesit (gjithsej 120 orë mentorim) vetëm për grupet qëllimore në vijim: persona të rinj deri 29 vjeç; persona me invaliditet; pjesëtarë të komunitetit rom, subjekte juridike të themeluar nga dy partnerë (SHPK) dhe femra nga kategoritë e cenueshme.
4. Personat e interesuar për pjesëmarrje në Program mund të aplikojnë deri në fund të vitit në vijim (31.12.2018), respektivisht deri në plotësimin e numrit të parashikuar të kandidatëve.
5. Në këtë program mund të përfshihen edhe personat e papunësuar të cilët kanë kryer trajnimin për sipërmarrësi dhe/ose kanë hartuar plan për biznes në vitin 2017.
6. Personat të cilët kanë fituar grant për Vetëpunësim gjatë 5 viteve të kaluara **nuk kanë të drejtë aplikimi** për pjesëmarrje në Program.
7. Përmes këtij Programi nuk do të përkrahet themelimi i bizneseve për veprimtaritë në vijim:
– Veprimtari bujqësore, gjegjësisht nga Sektori A/A, Departament 01 – Prodhimtari e bimëve dhe kafshëve, gjueti dhe shërbime të tjera që lidhem me këto veprimtari, me përjashtim të prodhimtarisë organike bujqësore;
– Biznese në veprimtari të klasës 49.32 - Taksi shërbime;
– Prodhimtari dhe shpërndarje të armëve, respektivisht veprimtari të klasës 25.40 – Prodhimtari të armëve dhe municionit;
– Biznese dhe aktivitete financiare dhe sigurimi që përfshijnë lojëra fati, respektivisht veprimtari nga Sektori K/I– Veprimtari financiare dhe veprimtari të sigurimit.

Me përjashtim, personat të papunësuar me invaliditet dhe personat e papunësuar nga komuniteti rom mund të regjistrojnë subjekt juridik me aktivitet bujqësor dhe taksi shërbim.

8. Të drejtat dhe obligimet mes APRM-së, UNDP-së dhe pjesëmarrësve, do të rregullohen në bazë të marrëveshjes së përbashkët.

Fletëparaqitja për pjesëmarrje duhet të dorëzohet në klubet e punës pranë qendrave të punësimit, çdo ditë pune prej 09:00 -14:00. Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata të hollësishme në klubet e punës të 30 Qendrave për punësim të Agjencisë së Punësimit në Republikës së Maqedonisë, kontakt qendra 02-3298-297 dhe ueb faqet www.avrm.gov.mk dhe www.rabotaimoznosti.mk.

AGJENCIA E PUNËSIMIT E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Agjencia e Punësimit
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ(PO) për programe dhe masa aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2018, miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, për masën aktive 3.2 – Trajnim për kualifikime profesionale sipas nevojave të punëdhënësve, financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me UNDP-në, më datë **23.03.2018**, hapet

THIRRJE PUBLIKE
për
punëdhënësit

1. U bëhet thirrje punëdhënësve të cilët kanë nevojë të sigurojnë punëtorë të kualifikuar nëpërmjet trajnimeve, të paraqiten në klubet e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, për të marrë pjesë në këtë aktivitet.

2. Trajnimi do të kryhet nga ana e: qendrave për trajnim profesional dhe/ose shkollave të mesme profesionale, si dhe punëdhënësve në përputhje me programin e verifikuar paraprakisht nga ana e Qendrës së arsimit për të rritur dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Punëdhënësi është i obliguar të punësojë 50% të personave të cilët me sukses kanë kryer trajnimin dhe të mos zvogëlojë numrin total të të punësuarve me orar të plotë pune në periudhë prej 6 muajve, përveç nëse arsyet për ndërprerjen e punësimit janë nga fajësia dhe vullneti i të punësuarit, ushtrimi i të drejtës për pension, vdekje, paaftësi për punë dhe jo si rezultat i arsyeve të biznesit

4. Punëdhënësi i cili do punësojë më shumë se 50% të personave të cilët kanë marrë pjesë në trajnim, për ata persona do të mund t'i shfrytëzojë përfitimet nga Programi 2 - MBËSHTETJE PËR KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS nga PO 2018, në përputhje me kriteret e vendosura

5. Punëdhënësit e interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet mund të aplikojnë deri në fund të këtij viti (31.12.2018), përkatësisht deri në plotësimin e numrit të paraparë.

6. Të drejtat dhe obligimet mes APRM-së, UNDP-së dhe pjesëmarrësve, do të rregullohen në bazë të marrëveshjes së përbashkët.

Fletëparaqitja për pjesëmarrje duhet të dorëzohet në klubet e punës së qendrave për punësim çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00. Formulari për aplikim gjendet në ueb faqen e APRM-së www.avrm.gov.mk.

Informata shtesë mund të merren në klubet e qendrave për punësim ose në kontakt telefonin 02/ 3111-850 lokali 223, si dhe ueb faqen
www.avrm.gov.mkdhewww.rabotaimoznosti.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

MILAN DHE RAIOLA NË NJË MENDJE

TË SHITET DONARUMA

Pa Çampions, Milani do të jetë i detyruar të marrë në konsideratë mundësinë e realizimit të një fitimi kapital nëpërmjet shitjes së portierit. Nevoja për Raiolën është njëlloj si buxheti, sepse synon zgjerimin teknik të klientit të tij: një klub i lartë në Ligën e Kampionëve dhe jo një ekip, që të luajturit në Çampions nuk e ka të sigurt

Verën e kaluar, siç shkruan Alessandra Gozzini dhe Karlo Laudisa në "Gazzetta", ditën e djeshme, Milani kishte idenë e tij: të përqendrohej fuqishëm te Donnarumma. Nga ana tjetër, menaxheri Mino Raiola përqafonte një ide të kundërt. Një "ekstrakt" tjetër duket se del prej kësaj çështjeje tani. Këtë vit, duhet të rishikohen rolet. Motivimet? Ato të klubit lindin nga nevojat e buxhetit. Pa Çampions, Milani do të jetë i detyruar të marrë në konsideratë mundësinë e realizimit të një fitimi kapital nëpërmjet shitjes së portierit. Nevoja për Raiolën është njëlloj si buxheti, sepse synon zgjerimin teknik të klientit të tij: një klub i lartë në Ligën e Kampionëve dhe jo një ekip, që të luajturit në Çampions nuk e ka të sigurt. Mino Raiola ishte, gjithashtu, i qartë në intervistën që dha dy ditë më parë. "Kush do të luajë në portën e Milanit sezonin e ardhshëm midis Donnarumma dhe Reina? Shpresoj Reina". Gjigjio është në mes të "dy zjarreve". Njerëz të afërt me të pohojnë se dëshira e tij e sinqertë është që të mbetet në Milano, por me sinqeritet e shikon nevojën për të luajtur në Çampions. Verën e kaluar, palët po mendonin të futnin një klauzolë prej 70 milionë eurosh (40 milionë, pa Çampions), ndërsa sot çmimi mund të rishikohet për më poshtë. Ndër portierët, Donnarumma është më i vlerësuari. Por, në skenë ka dalë edhe Alisson, portieri 25-vjeçar i Romës, për të cilin kanë treguar tashmë interes Real Madrid dhe PSZH. Të njëjtat skuadra, që kanë në fokus edhe Donnarumma.

Juventusi shpreson

Virusi vazhdon. Emre Xhan, qëllimi i deklaruar i Juventusit për merkaton e transferimeve 2018-2019, i intervistuar nga "Suddeutsche Zeitung", preferon të mos thotë shumë për destinacionin e tij të ardhshëm. "Nuk dua të përjashtoj ndonjë opsion, nuk e di se çfarë do të bëj verën e ardhshme, por jam mjaft i sigurt për veten, duke thënë se cilësitë e mia do të jenë të mjaftueshme për të luajtur në një klub shumë të madh", – zbulon Emre Xhan. Megjithatë, mesfushori gjerman, siç u përmend, nuk përjashton asnjë hipotezë, edhe pse kthimi në Bundesliga duket më larg. "Duhet të pranoj se niveli në kampionatin gjerman ka rënë ndjeshëm në vitet e fundit". Anglia, Spanja, Franca dhe Italia janë të gjitha destinacione shumë të mirëpritura. "Premier Liga ka mundësinë të shpenzojë më shumë para në merkato dhe kjo është shumë e rëndësishme për lojtarët. Por, La Liga është, gjithashtu, shumë tërheqëse, siç është Seria A, që është rritur në vitet e fundit, apo Ligue 1". Ndjesia, me pak fjalë, është se përgjigja e Emre Xhan ndaj Juventusit nuk do të vijë së shpejti, pavarësisht ofertës së pasur, sipas të cilës ai ka gati kontratë 4-vjeçare, prej 5 milionë eurosh në sezon. Për mesfushorin gjerman, i cili do të jetë i lirë nga Liverpuli verën e ardhshme, konkurrenca është bërë gjithnjë e më e fortë, me Bajern Munih, Mançester Siti dhe Real Madridi në vijën e parë.

Reali ofron 150 mln euro dhe Vazkuez për Sallah

Real Madridi është duke shpresuar se një ofertë prej 150 milionë eurosh, plus Lukas Vazkuez, do të jetë e mjaftueshme për ta marrë sulmuesin egjiptian, Mohamed Sallah, raporton "Diario Gol". Gjigantët spanjollë duan të nënshkruajnë me yllin e Liverpulit këtë verë, por mediat iberike deklarojnë se ata nuk janë të gatshëm të paguajnë më shumë se 190 milionë euro për 25-vjeçarin.

"Los Blancos" shpresojnë se mund ta ulin çmimin edhe më shumë, duke përfshirë 26-vjeçarin e Spanjës në ofertën e tyre. Në 41 ndeshjet, që ai ka luajtur këtë sezon, duke numëruar edhe garat e brendshme, edhe Ligën e Kampionëve, egjiptiani ka realizuar 36 gola, ka dhënë 12 asiste. Ai shënon gol mesatarisht për çdo 90 minuta që luan. Shifra të frikshme për një sulmues. Në fakt, Sallah po lufton me Leo Messin dhe Kristiano Ronaldon, ndër të tjera, për "Këpucën e Artë". Dhe sigurisht, me këto shifra, Florentino ka parë te Sallah galaktikun e tij të ri. Një lojtar, i cili, megjithëse jo ende në nivelin mediatik të Harry Kin, ose Njmar, nga sekretariati teknik i të bardhëve shihet si një yll i mundshëm.

Publicitet

Në bazë të nenit 19 të rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme numër 07-9992/3 të datës 05.06.2014, Komisioni për grumbullimin ofertave për realizimin e ekskursioneve pranë SHMK "Kole Nehtenin" Shtip më datë 23.03.2018 publikon:

SHPALLJE PUBLIKE – FTESË

Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursionit përfundimtar për nxënësit gjatë vitit shkollor 2017/2018

SHMK "Kole Nehtenin" Shtip në pajtim me Programin për ekskursion për vitin 2017/2018, organizon ekskursion përfundimtar për nxënësit gjatë periudhës prill-maj 2018, në destinacionet në vijim:

- Shtip – Beograd – Postojnë – Vjenë – Pragë – Drezeden – Budapest – Shtip, në periudhë prej muajit maj – prill 2018, gjithsej 6 ditë dhe 3 bujtje.

Kushtet për pjesëmarrje: Oferta me shkrim duhet të përpilohet dhe parashtrohet në pajtim me kërkesat e theksuara në shpallje dhe kërkesat e definuara në përmbajtjen e aktiviteteve për ekskursionin përfundimtar shkollor në Programin për ekskursione për nxënës. Kopje nga Programi për ekskursionet e nxënësve mund të merret në lokalet e Arkivit të SHMK "Kole Nehtenin" Shtip rr. "Goce Dellçev" nr. 101.

Në ofertën me shkrim duhet të theksohet: çmimi individual për nxënës, kushtet për akomodim dhe transport, mënyra e pagesës, guid, numër të mësimdhënësve dhe mjek, kushte të volitshme për nxënësit të cilët vijnë nga familjet e prekura sociale.

Kushtet minimale të cilat duhet të përmbushë ofertuesi janë:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike
- Të ketë të realizuara së paku 3 ekskursione për nxënës në 3 vitet e fundit
- Të përmbushë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kushtet e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Në pajtim me Rregulloren për ekskursionet e nxënësve, **kriteri për ndarje të marrëveshjes është çmimi më i ulët.**

Në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes ofertuesi më i volitshëm parashtron garanci bankare prej 5% nga vlera e përgjithshme e marrëveshjes.

Afati për parashtrimin e ofertave: 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të Shpalljes prej ora 08.00 deri në ora 14.00.

Mënyra dhe vendi për parashtrim: Në zarf të mbyllur në Arkivin e SHMK "Kole Nehtenin" Shtip rr. "Goce Dellçev" nr. 101 me shenjë "Deri te Komisioni për realizim të procedurës për zgjedhje të ofertuesit për realizim të ekskursionit të nxënësve".

Secila ofertë e arritur pas afatit përfundimtar do të llogaritet si e vonuar dhe nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

SHMK "Kole Nehtenin" Shtip
Komisioni për grumbullimin e ofertave

Shitet lokal afarist në Q.T. Mavrovka me 326 m2.
Çmimi sipas marrëveshjes. **Kontakt telefoni 078/386 386**

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2016), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), pëlqimit me shkrim të MASH, Sektorit për arsim fillor dhe të mesëm nr. 12-1121/1 të datës 30.01.2018, Mendimit pozitiv nga MSHIA 12/6-1618/2 të datës 14.03.2018, SHFK "Dame Gruev" – f. Erxhelia, Sveti Nikole publikon:

SHPALLJE

1. Për plotësimin e vendit të punës në shërbimin ndihmës – teknik:
Mirëmbajtës i higjienës – 1 (një) realizues

Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar të punës
Orari i punës është 5 (pesë) ditë pune në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte në një ndërrim (ndërrimi i parë) prej ora 06:00 deri në ora 14:00. Kandidati i zgjedhur ka të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Marrëveshjen kolektive.
Pagesa fillestare është 12.000,00 denarë.

2. Kandidatët nga pika:
- nga pika 1 duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me ligj (të jetë shtetas i RM, të jetë i moshës së rritur, të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore)
- kandidatët duhet të kenë të mbaruar arsimin fillor

3. Dokumentet e nevojshme (në origjinal ose kopje të vërtetuar anë noter):
- Fletëparaqitje;
- Dëshmi për arsim të mbaruar përkatës;
- Certifikatë të shtetësisë;
4. Shpallja zgjatë (5) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor,
5. Procesi për zgjedhjen e kandidatëve do të realizohet brenda afatit ligjor.
6. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë përzgjedhjes së kandidatëve.
7. Dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri në shkollë SHFK "Dame Gruev" – f. Erxhelia, Sveti Nikole rr. Marshall Tito nr. 31 – për komisionin për konkurs. Tel: 032-459-020

U. D Drejtor,
Aleksandar Ivanovski

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

BOLT "TIFOZ MASIV" I RONALDOS, E KRAHASON VETEN ME MESSIN

Kur u pyet në ndeshjen e miqësisë, të mërkurën, Bolt e përshkroi veten si "një tifoz i madh" i Kristiano Ronaldos, por tha se identifikohet më shumë me Messin, duke sugjeruar se të dy kanë përfituar nga aftësitë natyrore

Sprinteri legjendar xhamajkan, Usain Bolt, e ka krahasuar talentin e tij natyral me atë të yllit të Barcelonës, Lionel Messi. Tetë herë kampioni olimpik, Bolt, 31-vjeçar, u pensionua vitin e kaluar, pas një karriere të jashtëzakonshme, që përfshinte edhe 11 tituj botërorë. Kur u pyet në ndeshjen e miqësisë, të mërkurën, Bolt e përshkroi veten si "një tifoz i madh" i Kristiano Ronaldos, por tha se identifikohet më shumë me Messin, duke sugjeruar se të dy kanë përfituar nga aftësitë natyrore.

"Messi është shumë i talentuar", – tha ai për "Omnisport", duke folur me mirësjellje nga "Hublot". – Nga ajo që kam mësuar dhe dëgjuar gjatë viteve, Kristiano Ronaldo kishte nevojë për të punuar shumë dhe marrë vendin ku është. Unë kam lindur me shpejtësi dhe kam pasur shumë talent, si Messi". Dëshira e Bolt për të luajtur futboll në mënyrë profesionale është dokumentuar mirë dhe ai do të marrë shansin e tij për t'i bërë përshtypje trajnerit të Borussia Dortmund, këtë javë, kur do të niset në Gjermani për një seancë stërvitore. Sidoqoftë, ai është duke kërkuar një hap përpara dhe po e përdor atë si një platformë për të ndihmuar në arritjen e ëndrrës së tij të fundit, duke luajtur për Mançester Junajtedin e tij të dashur: "Unë do të përpiqem me më të mirën time, si gjithmonë. Jam një person shumë i vendosur, kur dua diçka, kështu që do të shkoj atje dhe të bëj më të mirën time. Unë do të doja të luaja për Mançester Junajtedin, por më duhet një sprovë. Pas kësaj, do të kem një bazë për t'i treguar Hoze Murinjos se mund ta bëj këtë, mund ta bëj edhe këtë", përfundoi Bolt.

Bregu i Fildishtë në ankth për Turen

Është zhdukur Jaja Ture! Në përfaqësuesen e Bregut të Fildishtë janë në ankth për mesfushorin e Mançester Sitit, i cili duhet të ishte paraqitur në grumbullim për dy ndeshjet miqësore me Togon dhe Moldavinë, më 24 dhe 27 mars, por nuk ka dhënë asnjë sinjal se ku ndodhet dhe përse është vonuar. "Nëse të gjithë futbollistët që luajnë në Evropë janë paraqitur në Beauvais, nuk ka ndodhur e njëjta gjë me Jaja Ture, – lexohet në adresën zyrtare të federatës së këtij vendi. – Stafi i përfaqësueses së Bregut të Fildishtë nuk ka asnjë informacion për kapitenin e "Elefantëve", fitues të Kupë së Afrikës më 2015-ën". Ture vendosi të tërhiqej nga kombëtarja në 2015-ën, por u kthye në dhjetor të vitit të kaluar pas ftesës së trajnerit Kamara. "Elefantët" po kalojnë një moment të vështirë, pasi nuk kanë mundur të kualifikohen në Botëror.

Buffon me rol drejtues te Italia?

Gjianluigji Buffon do të marrë një rol drejtuesi në Kombëtaren e Italisë kur të dalë në pension në fund të sezonit. Portieri legjendar ende nuk ka konfirmuar se do t'i varë dorezat e tij në fund të sezonit aktual, por kontrata e tij me Juventusin skadon më 30 qershor të këtij viti. Ndërsa Buffon mund të luajë ende nëse Bianconerët fitojnë Ligën e Kampionëve, javët e fundit ka pasur raportime në rritje që ai ka vendosur t'i thotë lamtumirë fushës së lojës. Tani mediumi italian "Gazzetta dello Sport" është duke raportuar se, në vend që të qëndrojë me Juven, Buffon do të marrë një rol në Kombëtare e Italisë. Gazeta pret që 40-vjeçari të bashkohet me klubin kombëtar, një strukturë e krijuar për të menaxhuar aktivitetet e Azzurrëve. Në thelb, Buffon do të bëhet President i ekipit kombëtar. Ka mundësi të tjera, duke përfshirë menaxhimin e ekipit ose duke punuar në konfigurimin e stërvitjeve me qëllim që të bëhet kryetrajner dhe ekipi kombëtar shihet si një rrugë më e mundshme. Buffon tashmë thuhet se ka takuar presidentin e Juves, Andrea Anjeli dhe e ka njoftuar për vendimin e tij, i cili në të ardhmen e afërt mund të bëhet zyrtar.

Situata e Nojer është e pasigurt

Ish-portieri i Gjermanisë, Oliver Kan, ka paralajmëruar se e sheh Manuel Nojer, portierin e Bajern Munih, aktualisht të dëmtuar, të pasigurt për situatën, vetëm tre muajt para Botërorit të Rusisë, ku "Mannschaft" do të tentojë të mbrojë titullin. "Bajern Munih nuk ka pse ngutet me të, por në një moment, trajneri mund ta ketë në konsideratë, sidomos kur arrin faza finale e Çampionsit", – tha Kan në një intervistë me kanalin gjerman "Sport1" . – Për momentin, kjo është një situatë e pasigurt dhe në një moment, do të jetë e vështirë edhe për trajnerin Lov". Nojer ka qenë portieri i padiskutueshëm i Bajern Munihut dhe Gjermanisë për vite të tëra, por nuk ka luajtur që nga shtatori 2017 për shkak të këmbës së thyer. Për momentin është duke u trajnuar ende në nivel individual dhe nuk është e qartë se kur do të kthehet në stërvitje me ekipin bavarez, apo kur do të kthehet në fushë. Portieri, 31 vjeç, udhëtoi për në Dyseldorf, ku Gjermania do të përballet me Spanjën në një miqësore, të premten, mori pjesë edhe në takimin e parë të ekipit, por u kthye në Munih të mërkurën. Më 23 maj, kampioni i botës do të fillojë të përqendrohet dhe, sipas Kahn, "Neuer ka nevojë për disa kohë për të ecur përpara. Për këtë, duhet të luajë ndonjë ndeshje në Bundesliga". Portieri gjerman konsiderohet si një nga më të mirët në botë në rolin e tij, siç është demonstruar para Kupës së Botës në Brazil, në vitin 2014, ku ai edhe u lëndua në fillim, por tregoi se nuk ka nevojë për shumë orë të luajturi, pasi mund të garojë shumë shpejtë edhe në nivel të lartë. "Megjithatë, këtë herë është pak më ndryshe", – përfundoi Kan.

Mjeku i Brazilit "skanon" gjendjen e Nejmarit

Doktori i përfaqësueses braziliane të futbollit ka treguar se Nejmar ka pasur një përmirësim në dëmtimin që pësoi në ndeshjen kundër Olimpik Marsej, muajin e kaluar. 26-vjeçari theu kockën e metatarsalit më 25 shkurt dhe pati nevojë për një ndërhyrje kirurgjikale, si rrjedhojë ka nisur garën me kohën për të qenë i gatshëm për Kupën e Botës 2018. Rodrigo Lasmar pohon brazilianit iu duke sikur iu shemb bota në momentin që mori vesh se sezoni me PSZH është mbyllur, por ai ka shanse të mëdha që të luajë në verën e ardhshme në Rusi. "Nejmar u trishtua jashtëzakonisht shumë kur mësoi se do të kishte nevojë për një operacion që të rikthehej në fushë, – tha Lasmar "L'Equipe". – Në prag të një veprimtarie si është Kupa e Botës 2018, gjithmonë ka frikë në të tilla dëmtime. Momentet e para ishin shumë të vështira, por mendoj se tani Nejmar ka forcën e duhur psikologjike për të përballuar situatën dhe për t'u kthyer sa më shpejt. Aktualisht kemi parashikuar gjashtë javë pushim absolut dhe në fund të prillit do të bëjmë një kontroll tjetër. Teorikisht lojtari do të rifillojë stërvitjen në javën e parë të majit dhe kjo duhet t'i jap mundësinë që të luajë për Brazilin në qershor", deklaroi Lasmar.

DASHI **21. mars - 20. prill**

Euforia juaj e tepruar sot mund të shkaktojë diskutim në familje. Jini të moderuar dhe kushtojini më shumë kohë të dashurit/ës tuaj, dhe madje edhe fjalëve romantike! Beqarët nuk do të luftojnë për të përfituar komplimente. Një histori e re po vjen për ta. Puna e mirë, diskrecioni është gjithmonë shumë i mirëpritur, jini të kujdesshëm në atë që thoni.

DEMI **21. prill - 21. maj**

Është një ditë e pasigurt dhe duhet të mendosh për sjelljen tënde. Venusi mbron sferën sentimentale dhe do t'ju ndihmojë të sqaroni një situatë. Beqarët do të jenë në gjendje për të hartuar disa strategji për të bërë për vete një person të veçantë. Nëse jeni duke kërkuar një profesion ju do të keni mundësi të mira për të gjetur rrugën e duhur.

BINJAKET **22. maj - 21. qershor**

Hëna në shenjën tuaj do t'ju japë shumë emocione, por edhe tensione në familje. Shprehni ndjenjat tuaja në mënyrë të qartë nëse doni të përfshini partnerin/en. Zemrat e vetmuara sot do të jenë në gjendje që me sharmin e tyre të tërheqin miq të rinj. Intuita juaj e fortë do ta bëjë biznesin të fluturojë lartë. Çdo projekt do të shkojë në drejtimin e duhur, kështu që këmbëngulni.

GAFORRJA **22. qershor - 22. korrik**

Në dashuri sot mund të ketë keqkuptime, por përpiquni të mos e ekzagjeroni me iluzione të jashtëzakonshme. Jini pajtues për të marrë pëlqimin e partnerit/es. Beqarët do të bëjnë miq të rinj dhe do të zbulojnë se kanë një ndjenjë të madhe me një person. Mos u hutoni dhe përqendrohuni në përgjegjësitë tuaja në punë!

LUANI **23. korrik - 22. gusht**

Sot ju do të keni mundësi për të bërë zgjedhje që mund të ndikojnë në jetën tuaj të dashurisë. Shikoni brenda vetes për të parë nëse keni atë që dëshironi. Beqarët do të bëjnë më mirë që të mos mashtrohen nga këshilla të papërshtatshme, ndiqni zemrën tuaj. Vazhdoni ngadalë në fazën e punës, por zbatoni objektivat e vendosura me këmbëngulje.

VIRGJERESHA **23. gusht - 23. shtator**

Sot ju do të reflektoni shumë në disa situata lidhur me sjelljen e të tjerëve. Do të keni Hënën në kundërshtim gjatë gjithë ditës dhe do ta bëni partnerin/en tuaj të heshtë. Beqarët do të jenë shumë simpatik dhe do takohen me njerëz të rinj të cilët do të jenë me vlerë. Sektori i punës po kalon ulje dhe ngritje. Nëse jeni të punësuar nga dikush ju me siguri do të jeni favoritë.

PESHORJA **24. shtator - 23. tetor**

Venusi në opozitë do t'ju bëjë të shqetësuar, por nuk do t'ju ndalojë të jetoni me një intensitet të madh. Marrëveshja me të dashurin/ën është e lartë! Beqarët do të jenë më iniciativë dhe do të shoqërohen me një person që pëlqejnë. Situata juaj e punës është pozitive, kështu që nuk duhet të kesh frikë të kërkosh ndryshime.

AKREPI **24. tetor - 22. nëntor**

Jini më të kujdesshëm në dashuri dhe kushtojini vëmendje tensioneve që mund të shkaktohen nga ndonjë keqkuptim. Relaksohuni dhe gjithçka do të funksionojë. Beqarët do të dëshirojnë të shijojnë edhe për pak kohë lirinë e tyre dhe do refuzojnë ftesat për takime. Ju jeni duke i kryer detyrat e ngarkuara me kujdes të madh në punë. Në horizont shihen ndryshime rrënjësore.

SHIGJETARI **23. nëntor - 21. dhjetor**

Venusi do t'ju bëjë të përjetoni pasionin e munguar ndoshta në marrëdhënien tuaj në çift. Kthejeni vëmendjen tek personi i zemrës dhe përjetoni këtë moment romantik me gëzim. Sot beqarët do të jenë më të vendosur se kurrë për t'u përqendruar në dashuri. Mbështetja e disa njerëzve me ndikim do t'i japë rrugë projekteve tuaja.

BRICJAPI **22. dhjetor - 20. janar**

Ju ende do të jeni pak të hutuar dhe mendimet tuaja nuk do të jenë aq të rrjedhshme sa dëshironi. Me Mërkurin kundërshtar do të jetë e vështirë për të shprehur ndjenjat tuaja. Beqarët do të jenë në gjendje të bëjnë programe të reja. Polemikat në vendin e punës do t'ju bëjnë nervozë. Mos u dorëzoni në projektin që po ndiqni dhe shkoni përtej pengesave.

UJORI **21. janar - 19. shkurt**

Dashuria do t'ju japë një ditë tjetër emocionuese, pasioni është në krye dhe ju jeni me të vërtetë shumë të lumtur. Planetët janë padyshim në favorin tuaj dhe asgjë nuk mund ta heqë harmoninë me partnerin/en. Zemrat e vetmuara ende do të enden dhe do të kënaqen me disa flirtime. Ka ndryshime në punë që ju do t'i merrni me entuziazëm të madh.

PESHQIT **20. shkurt - 20. mars**

aturni kundër në shenjën tuaj do të krijojë probleme në çiftet e lëkundshme, ndërsa ata në çift të qëndrueshëm mund të mendojnë të martohen ose të jetojnë së bashku. Do të jeni në gjendje të pushtoni me forcën tuaj atë që dëshironi. Beqarët do të jenë në gjendje të jetojnë histori intriguese. Disa pasiguri në frontin e punës mund të kërcënojnë qetësinë tuaj.

						Mensur Mamuti	REGJISORI JAPONEZ NË FOTO	PESHËNGRITËSI GREK ME ORIGJINË SHQIPTARE	E GARANTON SËRISH	FIGURË E BESYTNIVE, VAMPIRI
						THIRRJE / FILM I REGJISORIT NË FOTO (TË JETOSH)				
						I				
						VEND NË SREM				
						LËNDINË ME BAR NË MES TË PYLLIT, LIRISHTË / KOSË FERRASH, KMESË (SH.)				
						R				
						KIMISTJA POLAKE, MARIA				
						AKTORJA THURMAN / TIRANA				FILM I REGJISORIT NË FOTO "SHTATË ..."
KOHA	KLASIFIKIMET, NDARJET	KËNGËTARI AMERIKAN, POL	E	FILM I REGJISORIT NË FOTO	EKSTAZË / PJESA HYRËSE E NJË FILMI					
FILM I REGJISORIT NË FOTO / JO KONVEKS								TANTALI / LITRI		
K						POLITIKANI AMERIKAN, SEM / AKTORJA AMERIKANE, UEST				
A								NDUE UKAJ / INSTITUCION PËR RUAJTJEN E DOKUMENTEVE		
LLOJ HITHRASH / PËREMËR VETOR			PROTESTA / KRYETARI I TEARCËS, ASANI						RUMANIA / ÇELËS (ANG.)	
FILM I REGJISORIT NË FOTO						KASAFORTA / CEREMONI				
NJË PARASHTESË / TRUPI QIELLOR QË BIE NGA HAPËSIRA QIELLORE NË TOKË				QYTET I LASHTË NË MESOPOTAMI / OLIVER TUISTI			KRASIT / TITANI			
M									Ë / T	
TENTIMET PËR KRYERJE TË NJË VEPRE PENALE										

ZGJIDHJET: APEL, IKIRU, IRIG, ROGA, RADHAT, KIRI, UMA, E, TRANS, SANXHURO, TA, KONKAV, SLOM, ARTANEMA, NU, TI, GREVA, R, IDIOT, ARKA, MOS, UR, KIJ, METEORITI, Ë, TENTATIVAT.

Sudoku

shumë i lehtë

	9	4				8	2	
	3			7			4	
5	8	1				7	9	6
1				3	2			
			8		7			
			5	9				8
3	1	5				9	8	7
	4			8			3	
	6	7				4	5	

mesatar

	4					1		
7		2				9		8
5			1					
				5				
				8			7	5
					4	2		
							9	
1		3	7				8	
		6	4		2			3

Shumë i lehtë: 794156823, 632978145, 581243796, 178432569, 953867214, 426591378, 315624987, 249785631, 867319452. **Mesatar:** 348927156, 712546938, 569138724, 637251849, 421689375, 985374261, 254813697, 193765482, 876492513.

Golfi i ri benzinë shpenzon sa një dizel

Volkswagen pohon se versioni i ri Golf, modeli 1.5 TSI ACT Bluemotion është ekonomik sa i përgjigjet edhe Golfit me motor dizel dhe përveç kësaj, ai kushton edhe më lirë. Automobili është i pajisur me katër cilindra 1.5 litra turbo benzinë me 130 kuaj fuqi, i prezantuar në vitin 2017. Motori është i pajisur me Active Cylinder Technology, e cila mundëson çaktivizimin e dy nga katër cilindrat gjatë vozitjes, me çka zvogëlohen shpenzimet e karburantit. Po ashtu, motori i ri ka opsionin "eco-coasting", i cili mundëson që në mënyrë automatike përkohësisht të lëshohet në vozitje gjatë shpejtësive deri në 130 km në orë. Derisa motori është në funksion, të gjitha sistemet elektrike në automjet vazhdojnë që të funksionojnë në mënyrë normale, duke iu falënderuar baterisë shtesë litium-jon, e cila siguron energjinë për mbushje. Volkswagen pohon se duke iu falënderuar "eco-coasting" mund të kursehen 0,4 l/100 km. Sipas të dhënave të fabrikës, VW Golf 1.5 TSI ACT Bluemotion me ndërrues manual të shpejtësive DSG në regjim të kombinuar mesatarisht shpenzon 4,8 l/100 km, dhe në rrugë të hapur 4,0 l/100 km. Volkswagen këtë lloj motori do ta ketë në disa modele dhe në Evropë do të jetë në variantet hatchback dhe karavan.

Çiklizmi u përmirëson grave jetën seksuale

Gratë të cilat bëjnë sa më shumë milje duke çikluar, aq më të mirë kanë performancën në jetën e tyre seksuale. Kështu thotë një studim i ri, raport i cili thekson se funksioni i tyre i përmirësimit të jetës seksuale vjen me një çmim kaq të vogël ndonëse nuk përjashtohet mundësia e ndonjë infeksioni të fëshikëzës apo ndonjë plage të vogël për shkak të shales, njofton Klan Kosova. Hulumtimet e reja, që përfshijnë më shumë se 3100 gra. Ky studim i realizua nga Universiteti i Kalifornisë, San Francisko, ku u zbulua se gratë që hipnin biçikleta në të vërtetë kishin më shumë funksione seksuale sesa atletët e tjerë të zakonshëm.

Menyja e një darke të rëndësishme

MENU.

Clear Soup.
Thick Mock Turtle.

Salmon, Dutch Sauce.
Cucumber.
Whitebait.

Fillets and Rice.

Saddle of Lamb.
Peas. Potatoes.

Roast Quails.
Salad. Chips.

Strawberries, Sarah Bernhardt.
Wafers.

Cheese Savoury.

Dessert.
Coffee.

The Albanian Committee,
LONDON, 1913-14.

To assist the establishment of Albanian Autonomy; to develop a wider knowledge of the Balkan Problem; and to promote a good understanding between Christian and Mohammedan the world over.

EXECUTIVE COMMITTEE.
The Hon. Aubrey Herbert, M.P., President.
The Rt. Hon. Lord Lamington, Vice-President.
The Hon. Walter Guinness, M.P.
Sir Henry Cook, K.C.B., M.P.
Sir Charles E. Hunter, D., M.P.
Lt.-Gen. Sir Reginald Pole-Carew, M.P.
Philip Morrell, M.P.
Rev. M. Gaster, D.D. Mark H. Judge.
J. C. Figgis C. F. Ryder.

PUBLICATIONS.
Report of the First Meeting of the Committee, at the Whitehall Rooms, December 17th, 1913.
The Fate of Albania, with Maps and Statistical Information about the Population of Albania.
The Albanian Congress at Trieste, March, 1913.—Report of Proceedings from the Report to the Journal de Genève, of Geneva.
The Future of Albania.—A Reply of the Albanian Delegates to the Greek Claims. By H. E. Ismail Kemal Bey and the Committee.
Albania for the Albanians.—A Letter to the Press, by C. F. Ryder.

All who require the objects of the Albanian Committee are invited to communicate with Mr. J. C. Figgis, Hon. Sec., at 4, Kingsley Road, S.W. Communications relative to the Dinner to be sent to Mr. Mark H. Judge, 1, Pall Mall, S.W.

Kjo është menyja e një darke që është mbajtur në ambientet prestigjioze të 'White Hall Rooms' me 23 qershor 1913 në Londër. Nikoqire te darkës kanë qenë Lady Lamington (gruaja e Lord Lamingtonit) dhe Lady Herbert (gruaja e Sir Aubrey Herbertit). Darka ka patur karakter bamirës dhe është organizuar nga "Albanian Committee" për të mbledhur ndihma humanitare për Shkodrën dhe rrethinën që e kishin shkatërruar malazezët. Në darkë kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i aristokracisë britanike që e përkrahnin Shqipërinë për të cilën po merrej vendimi gjatë kësaj kohe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Këtë njerëz, por edhe të tjerë, përbënin grupin e britanikëve që lobonin në Qeverinë britanike dhe në Konferencën e Ambasadorëve për një vendim sa më të favorshëm për Shqipërinë. Siç shihet, pos menysë, "Albanian Committee" gjatë darkës ka organizuar edhe fjalime. Motoja e darkës dhe fjalimeve e kishte këtë qëllim: "Të ndihmohet themelimi i autonomisë së Shqipërisë; të zhvillohet një njohuri e gjerë për problemin e Ballkanit; dhe të promovohet mirëkuptim në mes të krishterëve dhe myslimanëve në tërë botën". *(Daut Dauti, Londër)*

Profesori i Parisit, gjithë trupin me tatuazhe

Ai është një mësues në shkollën fillore në Paris dhe gjithashtu një model i cili e ka të mbuluar trupin e tij me vepra arti nga koka deri tek këmbët. Siguristh që Sylvain kishte filluar punën si mësues përpara se të fillonte udhëtimin e tij me tatuazhet. "Unë gjithmonë frymëzohesha nga Britanikët të cilët mbushnin trupin e tyre me tattoo dhe ndiheshin shumë mirë me këtë", është shprehur mësuesi për një revistë në Francë. "Ndoshta ata janë një pengesë për të gjetur një vend pune, por të gjithë janë të lirë të duken siç ata kanë dëshirë". Ai gjithashtu është shprehur se njerëzit ndihen ndonjëherë të frikësuar nga tatuazhet e tij. Sylvain thotë që: "Njerëzit janë më të hapur seç e prisni, edhe pse ka prej atyre që flasin pas shpine. Ndërsa fëmijët më pranojnë kështu siç jam pa asnjë problem".

KALENDARI HISTORIK 23 MARS

1026 - Koenraad II shpall veten mbret të Italisë.

1657 - Franca dhe Anglia formojnë aleancë kundër Spanjës.

1808 - Vëllai i Napoleonit, Jozefi merr fronin e Spanjës.

1821 - Beteja dhe rënia e qytetit të Kallamatës. Lufta për pavarësinë e Greqisë.

1918 - Lituania shpall pavarësinë.

1919 - Benito Mussolini formon Lëvizjen fashiste në Milano të Italisë.

1929 - Instalohet telefoni i parë në Shtëpinë e Bardhë.

1936 - Italia, Austria dhe Hungaria nënshkruajnë Paktin e Romës.

1950 - Themelohet Organizata Botërore Meteorologjike pranë OKB.

1956 - Sudani shpall pavarësinë.

2001 - Stacioni rus në gjithësi MIR hiqet nga përdorimi dhe shkatërrohet në atmosferë para se të bije në pjesën jugore të Oqeanit Paqësor afër Fixhit.

A E DINI SE...

Një tabletë kontraceptive për meshkuj është një hap tutje drejt zhvillimit. Tableta do të përdoret çdo ditë, sikurse kontraceptivët tek gratë, dhe ndalon tosteteronin dhe hormonet që shkaktojnë prodhimin e spermës. Një gjë e tillë do të sillte sasinë e spermës në një nivel të ulët, që do të pamundësonte shtatzëninë. Studiuesit që kanë administruar këtë tabletë tek disa meshkuj kane thënë se nuk ka shkaktuar dëmtime në mëlçi, diçka që kishin treguar studimet paraprake. Përpjekjet e hulumtuesve më parë janë fokusuar në injeksione ose gjel, mirëpo ekspertët kanë thënë se meshkujt e kanë më të lehtë që të përdorin tableta.

BARSOLETA

MAJMUNËT

Hyp djali në dru dhe po hante banane. Vijnë shokët e i thonë:
- Zbrit ore, majmunët kaherë kanë zbritur nga druri!
- Po e shoh! - ia kthen djali.

THËNIA E DITËS

Është e kotë që të programosh jetën deri në detajin më të vogël, fati është ai që do e thotë gjithmonë fjalën e fundit!
(PITAGORA)